
Funded
by the European Union
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe

**Program i përbashkët i Bashkimi Evropian dhe Këshillit të Evropës
"Rritja e qasjes në arsim dhe mirëkuptimit ndërkulturor:
BE /KiE Mbështetje në fushën e arsimit për të kthyerit me forcë dhe të
komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë*"**

Kurrikula për trajnimin e mësimeve në shërbim:

**„Shkolla gjithpërfshirëse që mbështetë arsimimin e
komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian dhe fëmijët e
kthyer”**

Projekti: "Mbështetja e qasjes në arsim dhe mirëkuptimi ndërkulturor: Përkrahja në fushën e arsimit për të rikthyerit dhe për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë *"

Kurrikula për trajnimin e mësimeve në shërbim: Shkolla gjithëpërfshirëse që mbështetë arsimimin e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian dhe të fëmijët e kthyer

Përmbajtja

Kurrikula për trajnimin e mësimeve në shërbim:	1
„Shkolla gjithëpërfshirëse që mbështetë arsimimin e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian dhe fëmijët e kthyer”	1
Kurrikula për trajnimin e mësimeve në shërbim: Shkolla gjithëpërfshirëse që mbështetë arsimimin e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian dhe të fëmijët e kthyer	2
Qëllimi dhe objektivat e Kurrikulës	6
Grupi i synuar.....	6
Parakushtet (kërkesat)	6
Metodologjia	7
Vlerësimi	7
Kohëzgjatja.....	8
Struktura e programit të trajnimit	9
PËRMBAJTJA E TRAJNIMIT PËR PJESËN I.....	10
Agjenda e trajnimit të parë në kuadër të programit të nxitjes së përfshirjes sociale	10
1. Hapja, prezantimet, objektivat, rregullat, pritshmëritë, programi.....	11
2. Pabarazia sociale, rrënjët e saj dhe pasojat tek fëmijët.....	13
1. Roli i shkollave dhe mësimeve në riprodhimin e pabarazisë	16
2. Racizmi: Diskriminimi direkt, indirekt dhe diskriminimi strukturor.....	18
3. Qasja e gjithë shkollës për një shkollë gjithëpërfshirëse dhe ndërkulturore	19
4. Krijimi i një klase gjithëpërfshirëse dhe ndërkulturore	22
5. Shembuj të metodave, aktiviteteve dhe masave	24
6. Të nxëniet e bazuar në projekte	25
7. Planifikimi i zhvillimit të shkollës. Puna ekipore.....	26
8. Detyrat e shtëpisë: Detyrat deri në Pjesën e dytë të trajnimit. Vlerësimi	29
PËRMBAJTJA E TRAJNIMIT PËR PJESËN II	31
Agjenda e trajnimit të dytë në kuadër të programit të nxitjes së përfshirjes sociale	31
11. Hapja e pjesës së dytë të trajnimit dhe rishikimi i Planeve të Zhvillimit të Shkollës ...	32

12. Rishikimi i rasteve studimore për fëmijët e sapoardhur në klasë.....	34
13. Nxitja e gjithpërfshirjes së fëmijëve të riatdhesuar romë, ashkalinj dhe egjiptianë.....	35
14. Ushtrime për të nxënit bashkëpunues gjatë punës me fëmijët e kthyer	37
15. Ndërgjegjësimi kulturor, ndërgjegjësimi gjuhësor dhe edukimi ndërkulturor	39
16. Mentorimi dhe ndërmjetësimi nga bashkëmoshatarët (në mes të nxënësve).....	41
17. Bashkëpunimi me prindërit. Roli i ndërmjetësuesve arsimorë në shkollorë.....	43
18. Bashkëpunimi me ndërmjetësuesit dhe qendrat mësimore	44
Mbyllja e seancës 2: Detyrat e shtëpisë dhe vlerësimi.....	44
PËRMBAJTJA E TRAJNIMIT PËR PJESËN III	45
Agjenda e trajnimit të trete në kuadër të programit të nxitjes së përfshirjes sociale	45
19. Hapja dhe shqyrtimi i planeve për zhvillim të shkollës dhe aktivitetet në klasë	46
20. Puna e përbashkët: "Shtëpia e ëndrrave të mia"	48
21. Adresimi i çështjeve të evidentuara nga analiza e aktiviteteve shkollore dhe vizitave nëpër shkolla: Planet mësimore.....	49
22. Partneriteti online si mjet për arsimim ndërkulturor dhe gjithpërfshirje shoqërore.....	51
23. Vlerësimi i aktiviteteve arsimore	52
24. Si mundet që një vlerësim me pjesëmarrje participuese të mbështesë zhvillimin e shkollës.....	53
25. Vlerësimi i trajnimit dhe konkluzionet	54
BURIME PËR MËSIMDHËNËS	55
Hyrje.....	55
Procesi i zhvillimit të shkollës	56
Shkalla e zhvillimit të shkollës:	57
Planifikimi shkollor, për një shkollë gjithpërfshirëse dhe ndërkulturore.....	58
Informacion	58
Rishikimi/vlerësimi i shkollës	58
Planifikimi i veprimeve	58
Zbatimi i planit të veprimit.....	59
Monitorimi dhe vlerësimi i realizimit të planit të veprimit të shkollës	59
Instrumente për rishikimin e shkollës.....	60
Të dhëna për shkollën tonë.....	60
Planifikimi i shkollës për gjithpërfshirje sociale dhe edukim ndërkulturor.....	62
Principet e gjithpërfshirjes sociale në arsimim	66
Deklaratat mbi përfshirjen sociale	67
Dhjetë udhëzime për gjithpërfshirjen sociale dhe edukimin ndërkulturor.....	67
Listëkontroll: Çfarë informacioni duhet të merret për një fëmijë të sapoardhur në shkollë? ..	68
Fletë vëzhgimi për mësimdhënësit/et : Vëzhgimi nga afër i fëmijës së sapoardhur.....	68
1. Shkolla përsëritë pabarazitë sociale.....	69

2. Ndikimi i pavullnetshëm i mësimdhënësve	69
2.1. Shpërndarja e vëmendjes.....	69
2.2. Pritshmëritë ndikojnë te arritjet: efekti Pigmalion dhe Golem	69
2.3. Pasojat e kategorizimit dhe etiketimit	70
2.4. Kërcënimi i stereotipisë.....	70
2.5. Çfarë mund të bëhet?.....	70
Racizmi dhe “magjupizmi” si target për racizëm dhe diskriminimi.....	72
Askush nuk është racist, por racizmi ekziston	72
Racizmi ndaj “Magjupëve”	72
Diskriminimi i drejtpërdrejtë, i tërthortë dhe i strukturuar.....	73
Të mësuarit e bazuar në projekte	74
Strategjitë e zhvillimit të shkollës për gjithpërfshirjen sociale	77
Raste studimore të fëmijëve dhe familjeve të kthyer	79
<i>Familja Mujolli</i>	79
Përfshirja sociale dhe arsimimi i fëmijëve të riadhesuar	81
Kuptimi i situatës dhe nevojave të fëmijëve të sapoardhur	82
Ofrimi i një mjedisi mirëpritës në shkollë	83
Koncepti i përballimit nga këndvështrimi arsimor	84
Fëmijët e cënueshëm: të kuptuarit e simptomave të dëshpërimit	86
Bashkëpunimi mes shkollës dhe prindërve për të ofruar mbështetje.....	89
Të nxënit bashkëpunues.....	89
Promovimi i vetëdijes për gjuhën dhe diversitetin kulturor.....	93
Fëmijët e riadhesuar dhe nevojat e tyre gjuhësore.....	93
Edukimi ndërkulturor i shtrirë në të gjithë kurrikulën	94
Mentorimi nga bashkënxënësit	95
Ndërmjetësimi nga bashkënxënësit.....	96
Të punuarit së bashku: shkolla, prindërit, komuniteti.....	98
Përfshirja e prindërve.....	98
Temat kryesore rreth prindërve nga minoritetet etnike (përfshirë të kthyerit)	99
Ndërtimi i lidhjeve të forta me komunitetin:	100
Shembuj nga praktika ndërkombëtare	101
Roli i ndërmjetësuesit shkollor	102
Partneritetet online - vështrim i përgjithshëm.....	103
Monitorimi dhe vlerësimi i procesit të zhvillimit të shkollës	105
Pikat kryesore për monitorim dhe vlerësim: të mësuarit aktiv, përfshirja e prindërve dhe mbështetja e komunitetit.....	105
Udhëzime për monitorimin dhe vlerësimi	106

Veprimtari praktike	112
1. Prezantimi me pesë gishta	112
2. Ky/kjo jam unë	113
3. Njihuni (Të gjitha grupmoshat)	114
4. Historia e emrit tënd (të gjitha grupmoshat).....	116
6. Poezi autobiografike (grupmosha 11 vjeç e lart).....	118
7. Çanta e shpinës për t'u kthyer në shkollë (të gjitha grupmoshat)	119
8. Rrugëtim përmes shkollës (10 vjeç e lart)	120
9. Le të formojmë grupe (të gjitha grupmoshat).....	121
10. Rreshtimi sipas alfabetit (të gjitha grupmoshat).....	122
11. Intervista në çift (mosha 10+).....	123
Puna qarkore si strategji për përmirësim të komunikimit dhe ndërveprimit.....	123
12. Puna në rreth (klasa e parë dhe e dytë).....	124
10. Të punosh së bashku për të sjellë ndryshim	126
11. Kultura e shtëpisë	127
12. Gjuha fotografike (klasa e 3-të-6-të)	128
13. Këngë ndërkombëtare - Frère Jacques (ciklit të ultë).....	128
14. Tregim / përrallë	130
Veprimtari edukative për adoleshentë dhe të rritur.....	131
“Bëj një hap përpara”	131
“Tre vullnetarë”	134
”Shtëpia e ëndrrave të mia”	135
Analiza e planeve mësimore	139
Modeli i 1-rë: Mësimi i gjuhës angleze	139
Modeli i 2-të: Mësimi i kimisë.....	139
Modeli i 3-të: Mësimi i gjuhës shqipe	140
Shembulli i 1-rë: Mësimi i gjuhës shqipe	141
Shembulli i 2-të: Mësimi në anglisht	142
Shembulli i 3-të: Mësimi i matematikës	143
Shembulli i 4-të: Mësimi i historisë.....	143
Aktivitete vlerësuese	144
Barometri.....	144
Letër vetvetes.....	144
Mirë se vini në Utopi.....	145
Ndryshimet në klasën time	146
Duke shkuar në shtëpi.....	147
Befasoj, kujtoj, mendoj më shumë	148

Zhvillimi personal.....	148
Vlerësimi i tërë punëtorisë.....	149
Pyetjet e vlerësimit	150

Elemente të Kurrikulës së Përgjithshme

Qëllimi dhe objektivat e Kurrikulës

Trajnimi synon zhvillimin e kapaciteteve të shkollave të Kosovës për të ofruar mjedis gjithpërfshirës dhe ndërkulturor që lehtëson dhe mbështet integrimin efektiv të fëmijëve romë, ashkali, egjiptianë dhe të kthyer (riatdhesuarve), duke rritur mundësitë e suksesit në shkollë të të gjithë fëmijëve.

Objektivat kryesore të kurrikulës së trajnimit janë:

- Rritja e ndërgjegjësimit të mësimitdhënësve për rolin dhe përgjegjësitë e tyre në zhvillimin e nxënësve të tyre, si edhe për rëndësinë e adresimit të çështjeve si diskriminimi, racizmi, përfshirja sociale dhe të kuptuarit ndërkulturor,
- Ofrimi i metodologjive dhe burimeve me një sfond teorik të qëndrueshëm duke u mbështetur në përvojën e Këshillit të Evropës në këtë fushë, të cilat mund të kenë përdorim praktik në aktivitetet që mund të organizohen në nivel shkolle, bazuar në një qasje që përfshin gjithë shkollën,
- Krijimi i mundësive për përfshirje aktive të mësimitdhënësve në një reflektim kritik në lidhje me praktikën e tyre, në shkëmbimin e përvojave me kolegët dhe në gjenerimin e procesit të qëndrueshëm, demokratik dhe pjesëmarrës të zhvillimit të shkollës së tyre.

Grupi i synuar

Trajnimi është përgatitur për mësimitdhënësit/et e të gjitha niveleve të arsimit parauniversitar. Ekipet e mësimitdhënësve nga e njëjta shkollë pritet që të marrin pjesë dhe të bashkëpunojnë për realizimin e detyrave të marra pas çdo pjese të trajnimit. Pjesëmarrja e tyre duhet të jetë në pajtimin dhe me mbështetje nga drejtori i shkollës dhe këshilli i shkollës (Këshilli Drejtues i Shkollës). Sugjerohet që çdo ekip të përbëhet nga 3 mësimitdhënës të shkollës fillores dhe 3 mësimitdhënës të shkollës së mesme të ultë, si dhe të përfshijë si mësimitdhënës me përvoja të ndryshme (mësimitdhënës me përvojë dhe mësimitdhënës me më pak përvojë).

Parakushtet (kërkesat)

Mësimitdhënësit/et pjesëmarrës duhet:

- Të jenë të gatshëm të marrin pjesë në 3 cikle trajnimi;
- Të jenë të motivuar dhe të angazhohen për të eksperimentuar metoda të reja të mësimdhënies dhe të zhvillojnë aktivitete të bazuar në përvojat e trajnimit;
- Të jenë të gatshëm që të punojnë si ekip si dhe të përcjellin informacionin dhe përvojën tek kolegët e tjerë.

Metodologjia

Trajnimi është strukturuar në tri pjesë (seanca) që do të ofrohen gjatë fundjavave gjatë vitit akademik dhe përfundon me një vlerësim në fund të viti shkollor. Pas çdo pjese, pjesëmarrësit marrin detyra specifike për t'i zbatuar në shkollat e tyre, në mënyrë individuale ose së bashku me pjesëmarrës të tjerë nga e njëjta shkollë. Detyrat janë hartuar në atë mënyrë që mundësojnë realizimin e tyre gjatë orëve të punës së mësimdhënësve, si dhe sjellin përmirësime konkrete në nivel shkolle dhe në praktikën e mësimdhënies.

Metodologjia e zbatuar gjatë trajnimit është një kombinim i :

- Ligjerimeve dhe prezantimeve;
- Ushtrimeve interaktive, të cilat, në pjesën më të madhe mund të përsëriten ose të përshtaten për përdorim me nxënësit;
- Punës grupore;
- Punës individuale.

Në trajnim u ipet prioritet zbatimit të metodat interaktive dhe aktivitetet që stimulojnë reflektimin, bashkëpunimin dhe kreativitetin. Në seancat e fundit të trajnimit jepet hapësirë për t'ju përgjigjur nevojave shtesë specifike të pjesëmarrësve me qëllim të adresimit të temave të tjera të ndërlidhura ose thellimin e atyre temave që janë adresuar/trajtuar tashmë në seancat e mëparshme.

Vlerësimi

Çdo pjesë do të mbyllet me një seancë (aktivitet) vlerësimi. Pjesët 2 dhe 3 do të fillojnë me një rishikim të detyrave që u janë kërkuar pjesëmarrësve që të realizojnë në shkollat a tyre në periudhën ndërmjet trajnimeve. Kjo mundëson një vlerësim formativ dhe për të përshtatur përgjigjet e trajnerëve gjatë pjesës së dytë dhe të tretë. Vlerësimi përfundimtar do të zhvillohet në fund të programit të trajnimit, bazuar në dy metoda: portofolio individuale që reflekton zbatimin elementeve të trajnimit në praktikë dhe një kollokvium¹ i fokusuar në rishikimin e koncepteve kyçe dhe aktiviteteve të zhvilluara në nivel shkolle.

¹ Kollokvium: një konferencë në të cilën studiues apo specialistë të tjerë të pranishëm prezantojnë, analizojnë dhe diskutojnë për një temë të veçantë (orig: colloquium conference at which scholars or other experts present papers on, analyze, and discuss a specific topic . <http://dictionary.reference.com/browse/colloquium>, datë: 19.09.2015)

Kohëzgjatja

Trajnimi përfshin 6 ditë e gjysmë trajnim me pjesëmarrje (prezencë në seancat e trajnimit) të ndarë në tri pjesë (2.5 ditë + 2 ditë + 2 ditë) dhe veprimtari praktike të realizuara në nivele shkolle dhe të raportuara në fillim të seancës së trajnimit të radhës.

Struktura e programit të trajnimit

Pjesa1- Seancat			Pjesa 2 - Seancat		Pjesa 3 – Seancat	
Dita1	Dita2	Dita 3	Dita 1	Dita 2	Dita 1	Dita 2
Aritja dhe rregjistrimi	3. Roli i shkollave dhe mësimdhënësve në riprodhimin e pabarazive	7. Shembuj të metodave, aktiviteteve, dhe masave	11. Rishikimi i Planeve zhvillimore të shkollës.	15. Ndërgjegjësimi kulturor, ndërgjegjësimi gjuhësor dhe edukimi ndërkulturor	19. Shqyrtimi dhe analiza e aktiviteteve të zbatuara në shkolla	21.Partneriteti online si mjet për edukimin ndërkulturor dhe përfshirjen sociale
	4. Racizmi. Diskriminimi direkt, indirekt dhe i strukturuar	8. Të nxënit e bazuar në projekte	12. Shqyrtimi i rasteve studimore. Çfarë mund të bëhet? Përshtatja e planit	16. Mentorimi në mes të moshatarëve dhe ndërmjetësimi në mes moshatarëve (Peer mentoring)		22.Kompetencat kryesore të KiE për mësimdhënie në lidhje me diversitetin socio-kulturor
1.Hapja, njoftimi, rishikimi i programit dhe rregullat	5. Qasja e gjithëshkollës: Shkolla gjithpërfshirëse dhe ndërkulturore	9.Planifikimi i zhvillimit të shkollës. Puna ekipore	13. Ushtrime bashkëpunuese për raste specifike të të rikthyerve	17. Bashkëpunimi me prindërit. Roli i ndërmjetësuesve (mediatorëve) arsimorë.	20. Adresimi i çështjeve të dala nga analiza e aktiviteteve shkollore dhe vizitave në shkolla/ planifikimeve	23. Si mund vlerësimi me pjesëmarrje të mbështet zhvillimin e shkollës?
2. Pabarazitë sociale, rrënjët dhe pasojat e tyre për fëmijët	6. Klasë përfshirëse dhe ndërkulturore	10. Detyra të shtëpisë: -Hartimi i një Plani zhvillimor të shkollës - Analizë e një rasti individual	14. Përdorimi i teknikave bashkëpunuese të të mësuarit në klasat heterogjene	18.Bashkëpunimi me qendrat mësimore dhe strukturat tjera mbështetëse lokale. Detyrat e shtëpisë		24. Planifikimi i vlerësimit të aktiviteteve shkollore Vlerësimi i trajnimit dhe konkluzionet

PËRMBAJTJA E TRAJNIMIT PËR PJESËN I

Agjenda e trajnimit të parë në kuadër të programit të nxitjes së përfshirjes sociale

DITA 1

- 14:30 Fillimi i trajnimit, fjalët përshëndetëse
- 14:45 Sesioni 1. Hapja, hyrja, plani i përgjithshëm, rregullat
- 16:15 Pauza e kafes
- 16:30 Sesioni 2. Pabarazitë sociale, rrënjët e tyre dhe pasojat tek fëmijët

DITA 2

- 09:00 Sesioni 3. Roli i shkollave dhe mësimeve në riprodhimin e pabarazive
- 10:30 Pauza e kafes
- 10:10 Sesioni 4. Racizmi i drejtpërdrejtë, jo-i drejtpërdrejtë dhe diskriminimi strukturor
- 12:30 Dreka
- 14:00 Sesioni 5. Qasja holistike e shkollës. Shkolla gjithpërfshirëse dhe ndërkulturore
- 15:30 Pauza e kafes
- 16:00 Sesioni 6. Klasa gjithpërfshirëse dhe ndërkulturore

DITA 3

- 09:00 Sesioni 7. Shembuj të metodave, aktiviteteve dhe masave
- 10:30 Pauza e kafes
- 10:45 Sesion 8. Të nxënit bazuar në projekt
- 12:15 Dreka
- 13:30 Sesioni 9. Planifikimi i zhvillimit të shkollës. Punë ekipore
- 15:00 Pauza e kafes
- 15:15 Sesion 10. Detyrë shtëpie: Hartoni një plan zhvillimor të shkollës dhe një studim rasti individual
- 16:30 Përfundimi i trajnimit të parë

1. Hapja, prezantimet, objektivat, rregullat, pritshmëritë, programi

Kohëzgjatja dhe vendi i realizimit të programit: 1 orë e 30 min, dita 1. seanca 1. (pasdite).

Objektivat:

- Vendosja e programit të trajnimit në kornizat e programit dhe në kontekstin e punës së më parshme të KiE;
- Të kuptuarit e elementëve bazë të qasjes dhe përmbajtjes së trajnimit: objektivat, struktura, ndërlidhja ndërmjet trajnimit dhe praktikës;
- Shprehja e pritshmërive në lidhje me programin e trajnimit;
- Qartësimi i elementëve kyçe në lidhje me marrëdhëniet dhe procedurat e komunikimit gjatë trajnimit

Burimet që nevojiten:

- Kompjuter, projektor, ekran;
- Prezantim në Power Point për Hapie;
- Fletë-shënime (Flipqar) dhe vendi për t'i ngjitur/prezantuar ato.

Prezantimi i modulit:

Kjo seancë ka tri pjesë të ndara që mund të moderohen nga trajner të ndryshëm.

Pjesa e parë përfshin fjalët e hapjes, prezantimin e trajnerve dhe të pjesëmarrësve. Nëse marrin pjesë të ftuar, atyre do t'u jepet fjala që tu drejtohen pjesëmarrësve.

- Prezantim i shkurtër i vetëvetes në plenar (rreth 1 min/pers)

Çdo pjesëmarrës do të prezantojë/flasë për:

- Emrin, emrin e shkollës;
- Vitet e përvojës në mësimdhënie;
- Fushat e preferuara të mësimdhënies (për nivelin fillor) ose lëndët (për nivelin e mesëm të ulët);
- Pjesëmarrje në trajnime të njëjta/ të ngjashme ose projekte që lidhen me temat e trajnimit (edukimi gjithpërfshirës dhe ndërkulturor, edukimi për drejtësi shoqërore për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian dhe për të riatdhesuarit).
- Trajtimi i temës në grupe të vogla pune me 6 pjesëmarrës nga secila shkollë (20 min)

Diskutim në grup të vogël dhe marrëveshje për disa preferenca dhe përvoja të përbashkëta:

- Çfarë ju pëlqen lidhur me punën që bëni?
- Çfarë ju pëlqen lidhur me shkollën tuaj?
- Ciltat janë përvojat e juaja me fëmijët romë, ashkali, egjiptianë ose me të kthyerit?

Prezantimi i grupit: gjetjet kryesore për gjërat e përbashkëta dhe përvojat prezantohen në plenar.

Pjesa e dytë përfshin prezantimin e programit të përgjithshëm dhe objektivave të trajnimit, si edhe disa elemente kryesore për qasjen në trajnim. Pas një vështrimi të përgjithshëm të strukturës së përgjithshme të trajnimit, jepen detaje për pjesën e parë të trajnimit, duke përdorur diapozitivët/sllajdet e prezantimit. Fokusi i veçantë i kushtohet informimit për disa aktiviteteve praktike që pritet të realizohen nga ana e pjesëmarrësve pas trajnimit, kjo do të rrisë vëmendjen në përmbajtjet e trajnimit, si dhe do të inkurajojë lidhjen e kësaj përmbajtje me punën e përditshme dhe me kontekstin specifik lokal të çdo pjesëmarrësi.

Pjesa e tretë fokusohet në çështje më shumë praktike, përfshirë këtu ambientet e trajnimit, shpërndarjen e materialeve mbështetëse të trajnimit, procedurat e vlerësimit, procedurat e komunikimit (“kutia postare” dhe “tabela e mesazheve”), kohën e ushqimit, ndarjen sipas grupeve, seancën e konsultimit, rregullat në lidhje me përdorimin e telefonave celularë ose pirjen e duhanit, etj. Pjesëmarrësve do tu kërkohet që të shkruajnë në fletë shënimi pritshmëritë e tyre kryesore për trajnimin dhe shqetësimet që mund të kenë. Këto fletë shënimi vendosen në një vend ku mund të shihen dhe lexohen nga pjesëmarrësit gjatë pushimeve dhe do të kontrollohen në fund të seancave të trajnimit.

2. Pabarazia sociale, rrënjët e saj dhe pasojat tek fëmijët

Kohëzgjatja dhe vendi në program: 1orë e 30 min, dita 1, seanca 2. (pasdite).

Objektivat:

- Ngritja e vetëdijes për përpikat fillestare jo të barabarta të individëve;
- Promovimi i të kuptuarit (empatisë) të të tjerëve që janë ndryshe dhe që përballen me paragjykim dhe diskriminim;
- Ndërgjegjësimi për diskriminimin dhe për mundësitë jo të barabarta në shoqëri;
- Nxitja e të kuptuarit të pasojave të mundshme personale të dikujt që i përket pakicave apo grupeve të caktuara kulturore;
- Reflektimi për proceset sociale të përfshirjes, përjashtimit dhe marxhinalizimit;
- Të kuptuarit e nevojës për masa edukative mbështetëse dhe mbrojtëse.

Burimet që nevojiten:

- 2 hapësira për të vendosur 12 pjesëmarrës për të qëndruar në rresht dhe të ecin 12 hapa;
- Fletët me role;
- Lista e pyetjeve kryesore;
- Lista e deklaratave
- Lista e pyetjeve sqaruese

Përshkrimi i modulit:

Ky sesion bazohet në aktivitetin **Ec një hap përpara** nga COMPASS (Manuali i Edukimit për të Drejtat e Njeriut për të Rinjtë, Këshilli i Evropës).

Procesi i punës:

- Aktivitet interaktiv (60 min)

1.Pjesëmarrësit ndahen në grupe me nga 12 persona. Secili grup do ta bëjë aktivitetin ndaras me një trajner.

Çdo pjesëmarrës tërheq një kartë me role në mënyrë rastësore. Pjesëmarrëse u kërkohet që të mos ia tregojnë askujt rolin . Në mënyrë që ta kuptojnë sa më mirë rolin që u ka qëlluar në letrën që e kanë tërhequr, trajneri/fasilituesi lexon pyetjet vijuese duke u dhënë kohë të mjaftueshme pjesëmarrësve që të reflektojnë për rolin:

- Si ka qenë fëmijëria juaj? Në ç'shtëpi jetonit? Çfarë lojërash luanit? Çfarë pune bënin prindërit tuaj?
- Si është jeta juaj e përditshme sot? Ku rrini me shoqëri? Çfarë bëni në mëngjes, pasdite dhe mbrëmje?

- Si është mënyra/stili juaj i jetesës? Ku jetoni? Sa para fitoni në çdo muaj? Çfarë bëni në kohën e lirë? Çfarë bëni për pushime?
- Çfarë ju entuziazmon dhe nga se keni frikë?

2. Më pas, pjesëmarrësve u kërkohet të vendosen pranë njëri-tjetrit (sikur të ishin në vijën e nisjes) dhe trajneri/fasilituesi u shpjegon se kur ai do të lexojë deklaratën përkatëse, pjesëmarrësit duhet të bëjnë vetëm një hap përpara nëse përgjigjja është “po”. Në të kundërt, ata duhet të rrinë në vend, pa lëvizur.

3. Deklaratat lexohen një nga një me zë të lartë dhe pjesëmarrësve u lihet kohë që të lëvizin. Në fund, pjesëmarrësit ftohen të shohin pozicionin e tyre përfundimtar dhe u jepen disa minuta që të dalin nga roli, para sesa të kthehen dhe të diskutojnë/reflektojnë në seancë plenare.

4. Diskutimi/reflektimi:

Pjesëmarrësit pyeten mbi atë se çfarë ndodhi dhe se si ndihen ata në lidhje me aktivitetin dhe pastaj diskutohet për çështjet e ngritura dhe për atë se çka kanë mësuar nga kjo.

- Si u ndien ata që bënë një hap përpara?
- Për ata që bënë më shpesh përpara, nëç’pikë filluan të vërenin që të tjerët nuk po lëviznin aq shpejt sa ata?
- A u ndie ndonjeri se kishte momente kur të drejtat e tyre themelore njerëzore po injoroheshin?
- A mund ta gjejnë rolin e njëri-tjetrit? (Ata mund t’i zbulojnë rolet e tyre në këtë pjesë të diskutimit)
- Sa e lehtë apo e vështirë ishte të luaje rol tjetër? Si e imagjinoni personin, rolin e të cilit po e luanit?
- A e pasqyron ushtrimi shoqërinë në një farë mënyre? Si?
- Cilat ishin të drejtat e njeriut që u rrezikuan në secilin rol? A mundet ndokush të thotë se nuk iu respektuan të drejtat e tij njerëzore apo që nuk pati qasje në to?
- Çfarë hapa të parë do të mund të merreshin për adresimin e pabarazive në shoqëri?

Çështjet kryesore që duhen adresuar gjatë diskutimit: Si mund arsimimi të kundërshtojë jobarazitë strukturore? Çka mund të bëhet për të përkrahur fëmijët e disavantazhuar?

- Në fund, çdo pjesëmarrës ftohet të formulojë dhe postojë një sugjerim personal për përmirësimet në shkollën e tij/saj.
- Të gjitha deklaratat e postuara do të organizohen sipas temave kryesore (10 min)

5. Konkluzionet dhe përfundimet (20 min)

Çfarë mund të bëjmë në shkollat tona për të luftuar përjashtimin dhe për të kompensuar disavantazhet?

Letrat me role

Jeni një nënë e pamartuar dhe e papunë	Jeni një 10-vjeçar i kthyer nga Suedia
Jeni vajza e drejtorit të një banke në Prishtinë. Studioni në universitet për ekonomi	Jeni djali i një pronari të restorantit italian që sapo është zhvendosur në Kosovë
Jeni një femër juriste në Kosovë.	Jeni vajza e ambasadorit amerikan në Prishtinë
Jeni një vajzë që jetoni me prindërit, të cilët janë muslimanë të përkushtuar	Jeni një vajzë rome 14-vjeçare e kthyer nga Berlioni
Jeni një vajzë 17-vjeçare rome, që nuk e ka përfunduar shkollën fillore	Jeni mësimdhënës/e e shkollës fillore dhe grua e divorcuar, nënë e tre fëmijëve
Jeni një femër ashklike e pamartuar dhe jeni shtatzënë	Jeni drejtues/e i/e një organizate rome
Jeni një mësimdhënës/e i/e papunë	Jeni futbollist nga një familje egjiptiane e Kosovës
Jeni një burrë kosovar në moshë të mesme, që ka punuar në ndërtim dhe jeni pushuar së fundmi nga puna	Jeni një grua e re me aftësi të kufizuara mendore dhe jetoni në një pavijon të veçantë
Jeni një grua e re ashklike me diplomë të shkollës së mesme	Jeni një Rom 27 vjeçar që nuk ka ku të jetojë
Jeni djali i një profesori në Universitetin e Prishtinës	Jeni djali 19-vjeçar i një fermeri kosovar në një fshat të izoluar malor
Jeni një 18-vjeçar me aftësi të kufizuara dhe në karrocë	Jeni mësimdhënës/e serb në Kosovë

Deklaratat

- Ju nuk keni hasur me asnjë vështirësi serioze financiare.
- Keni një shtëpi/strehim të mirë me linjë telefonike dhe televizor.
- Ju duket se gjuha, besimi fetar dhe kultura juaj respektohen në shoqërinë ku jetoni.
- Ju duket se mendimi juaj mbi çështjet sociale e politike qojnë peshë dhe pikëpamjet tuaja dëgjohen gjithashtu.
- Të tjerët konsultohen me juve për çështje të ndryshme.
- Keni mundësinë të vazhdoni të arsimoheni, në rast se doni.
- Ju keni mbrojtje të mjaftueshme sociale dhe mjekësore për nevojat tuaja.
- Ju duket se roli juaj në shoqëri nuk është inferior ndaj të tjerëve.
- Nuk e keni ndier kurrë diskriminimin për shkak të origjinës suaj.
- Mund të shkoni me pushime njëherë në vit.
- Ju keni një jetë interesante dhe ndiheni pozitiv për të ardhmen tuaj.
- Ju mendoni se mund të studioni e të vazhdoni profesionin e zgjedhur.
- Ju nuk keni frikë se ngacmoheni apo sulmoheni në rrugë ose në media.
- Ju mund të votoni në zgjedhjet e përgjithshme dhe vendore.
- Ju ndiheni se ju janë dhënë të njëjtat mundësi si të tjerëve.
- Ju mund të gjeni punë me lehtësi, në rast se doni.
- Ju nuk trembeni për të ardhmen e fëmijëve tuaj.
- Ju mund të blini veshje të reja, të paktën çdo tre muaj.
- Ju mund të bini në dashuri me personin e zgjedhjes suaj.
- Ju ndiheni se kompetenca juaj vlerësohet dhe respektohet në shoqërinë ku jetoni.

1. Roli i shkollave dhe mësimeve në riprodhimin e pabarazisë

Kohëzgjatja dhe vendi në program: 1orë e 30 min, dita 2, seanca 1. (paradite).

Objektivat:

- Rritja e ndërgjegjësimit për nevojën që shkolla të shmangë kontributin për riprodhimin e pabarazive sociale;
- Rritja e ndërgjegjësimit për sjelljen dhe qëndrimin e mundshëm të dëmshëm dhe të padëshirueshëm të mësimeve,
- Stimulimi i reflektimit se si mund të rritet vetëvlerësimi te nxënësit e pafavorizuar dhe dhënia e mesazheve mbështetëse dhe pozitive te të gjithë nxënësit.

Burimet që nevojiten:

- Kompjuter, projektor, ekran
- Prezantim në Power Point - Roli i Shkollave dhe mësimeve
- Flipqarë, markera, letër

Përshkrimi i modulit:

Pjesa 1 (20 min): Duke pasur parasysh seancën e mëparshme, trajneri fillon me pyetje drejtuar pjesëmarrësve se si mendojnë ata, cili është ndikimi i shkollës në pabarazitë në mes personave dhe grupeve në shoqëri. Përgjigjet mund të kategorizohen në:

e

- Ul pabarazinë
- Keqëson pabarazinë
- Pasqyron ose riprodhon pabarazinë

Trajneri paraqet disa elemente kyçe të kërkimit sociologjik, psiko-sociologjik dhe psikologjik që tregojnë se jo qëllimisht, shkolla dhe mësimeve/et mund të kenë ndikim negativ në arritjet e nxënësve në shkollë, në vetë perceptimin e tyre dhe në vendin që ata i atribuojnë vetes në shoqëri në të ardhmen.

Pjesa 2 (15 min): Bazuar në kornizën teorik të prezantuar, në 6 grupe të vogla (grupe të përziera, mësimeve nga shkolla të ndryshme) pjesëmarrësit diskutojnë për situatat në shkollat e tyre, ku sjelljet dhe qëndrimet e mësimeve mund të kenë ndikuar në mënyrë negative te nxënësit. Çdo grup duhet të zgjedhë një situatë që ta ndajë në mbledhjen e përgjithshme (grupin e madh), duke u siguruar që të hiqen ose modifikohen të gjitha elementet që do të mundësonin identifikimin e protagonistëve.

Pjesa 3 (20 min): Prezantimi nga 6 grupet dhe diskutim.

Pjesa 4 (15 min): Pjesëmarrësit ndahen në 4 grupe të përziera:

- Dy grupe kanë për detyrë të propozojnë strategji për uljen e rrezikut për sjellje dhe qëndrime të mësimdhënësve që mund të kenë ndikim negativ te nxënësit;
- Dy grupet e tjera propozojnë strategji që mbështesin krijimin e imazhit pozitiv te nxënësit që i përkasin grupeve më të pa favorizuara dhe të rrisin vetëvlerësimin e tyre.

Pjesa 5 (20 min): Prezantimi i rezultateve të grupeve dhe diskutimi përmbyllës.

Trajneri paraqet dy sllajdet e fundit me veprime të sygjera dhe i krahason ato me propozime e dhëna nga mësimdhënësit/et .

2. Racizmi: Diskriminimi direkt, indirekt dhe diskriminimi strukturor

Kohëzgjatja dhe vendi në [program](#): 1orë e 30 min, dita 2, seanca2. (paradite).

Objektivat:

- Nxitja e reflektimit kritik ndaj racizmit dhe marrëdhënia e tij me stereotipet dhe diskriminimin;
- Rritja e ndërgjegjësimit se racizmi kundër popullit rom, ashkali dhe egjiptian është një lloj racizmi specifik dhe shumë i dëmshëm, i cili ekziston me shekuj në mbarë Evropën;
- Të kuptuarit e llojeve të ndryshme të diskriminimit dhe mënyrat e shfaqjes së tij në mjedisin shkollor.

Burimet që nevojiten:

- Kompjuter, projektor, ekran, zmadhues zëri;
- Video *“Tripes and onions”* (Paçe dhe qepë) (gjendet edhe në Youtube);
- Prezantim në Power Point - Racizmi dhe diskriminimi;
- Tabelë, markera, letër.

Përshkrimi i modulit:

Pjesa 1 (20 min): Shfaqja e videos *“Tripes and onions”* (7 min) dhe videoja ndalohet përpara pjesës finale. Pjesëmarrësve u kërkohet që të përshkruajnë atë që ata panë në video dhe çfarë do të bënin ata po të ishin në vendin e personave të përfshirë në video. Insistohet në pyetje të hapura, pa treguar ndonjë qëndrim gjykues ndaj komenteve që bëhen. Pastaj shfaqet pjesa përfundimtare e videos dhe pjesëmarrësve u kërkohet të thonë se çfarë mendojnë tani.

Kthehuni në fillim të videos për të treguar që kishte shumë elementë që mund të zbulonin pjesën përfundimtare, por ne jemi të prirur që të perceptojmë vetëm ato elemente të realitetit që konfirmojnë pritshmëritë tona, bazuar në stereotipin që kemi për grupe të ndryshme sociale. Diskutoni rolin e stereotipit dhe paragjytimeve dhe mbylleni këtë pjesë me sllajdet për këtë temë.

Pjesa 2 (30 min): Kjo pjesë fokusohet në *“Magjup”* si një shënjestër e racizmit, ekuivalenti lokal i anti-gjipsizmit. Trajneri fillon me një ilustrim të shkurtër të situatës në historinë europiane kur grupe rome dhe anëtarë të grupeve të tilla, ose grupe që popullata shumicë i percepton të lidhur me romët, kanë qenë në shënjestër të racizmit. Pjesëmarrësve u kërkohet që të reflektojnë në grupe të vogla për situata që kanë përjetuar, ose për të cilat janë vënë në dijeni kur romët, ashkalinjtë ose egjiptianët kanë qenë shënjestër e racizmit në Kosovë (në të tashmen ose në të shkuarën). Moderoni një diskutim të përgjithshëm për rreziqet e pranimit (nga të dyja anët) si diçka normale të pozitës inferiore në shoqëri të romëve, ashkalinjëve dhe egjiptianëve.

Pjesa 3 (20 min): Prezantim i shkurtër (10 min) i tre llojeve të ndryshme të diskriminimit, i ndjekur nga puna në grupe të vogla, për të identifikuar situata të diskriminimit të tërthortë në shkolla (10 min). Për çdo situatë të identifikuar, pjesëmarrësve u kërkohet që të propozojnë një zgjidhje për të shmangur diskriminimin.

Pjesa 4 (20 min): Prezantimi i rezultateve të grupit dhe diskutim i përgjithshëm.

3. Qasja e gjithë shkollës për një shkollë gjithpërfshirëse dhe ndërkulturore

Kohëzgjatja dhe vendi në [program](#): 1 orë e 30 min, dita 2, seanca 3. (pasdite).

Shënime paraprake

Seancat 5, 6 dhe 7 trajtojnë proceset e zhvillimit të shkollës dhe klasës dhe duhet të ndërtohen mbi njëra-tjetrën. Këto seanca plotësojnë njëra-tjetrën duke lëvizur nga perspektiva e zhvillimit organizativ te gjithpërfshirja në mjedise konkret në klasa dhe në sygjerime praktike për strategji gjithpërfshirëse, metodologji dhe përmbajtje kurrikulare.

Në modulën 5, pjesëmarrësit do të punojnë për plane konkrete të shkollës për një shkollë ndërkulturore dhe gjithpërfshirëse, duke përdorur rezultatet e listave të kontrollit, të përgatitura për trajnimin. Hyrje shtesë do të jepet përdorimi i objekteve që përshkruajnë elementet kryesore të gjithpërfshirjes sociale dhe edukimit ndërkulturor. Me anë të organizimit dhe vendosjes së përparësive për elementet e duhura të një mjedisi shkollor gjithpërfshirës, pjesëmarrësit do të lëvizin nga procesi i rishikimit të shkollës në një plan konkret për shkollën.

Objektivat:

- Informimi dhe reflektimi mbi konceptin e qasjes tërëshkollë dhe përfitimet e tij;
- Kontekstualizimi dhe përshtatja e konceptit të përgjithshëm të zhvillimit të shkollës me realitetin e shkollës;
- Integrimi i një perspektive gjithpërfshirëse dhe ndërkulturore në planet e zhvillimit të shkollës

Burimet që nevojiten:

- Kompjuter, projektor, ekran;
- Karta;
- Prezantim në Power Point- *'Qasja tërëshkollë'*
- Materiale të shtypura: *'Shkallëzimi ciklik'* dhe *'Zhvillimi i shkollës'*

Procesi i punës

Pas prezantimit të shkurtër të qasjen gjithpërfshirëse të shkollës, pjesëmarrësit bëjnë vetëvlerësimin, duke përdorur fletët e punës me Shkallëzimin ciklik dhe Zhvillimin e shkollës.

Pas vlerësimit të situatës në shkollat e tyre, pjesëmarrësit do të shohin në të ardhmen dhe do të punojnë në dimensionin qendror të një shkolle gjithpërfshirëse.

Pjesa 1: Vlerësimi dhe diskutimi i procesit të zhvillimit të shkollës sonë (30min)

- a) Puna në grupe të vogla me nga 4-6 pjesëmarrës, bazuar në fletët e punës.

Pyetjet kyçe:

- Ku jemi?

- Cilat janë pikat tona të forta?
- Cilat janë sfidat tona?

b) Prezantim i shkurtër i rezultateve.

Pjesa 2: Identifikimi i elementeve qendrore të një shkolle gjithpërfshirëse (60 min)

Procesi i punës

Faza 1:

Punë individuale:

- Ju lutemi, lexoni pa zë deklaratat në letra;
- Pyetje lidhur me përmbajtjen;
- Veçoni më tej pesë letrat që ju duken më të rëndësishme;
- Pjesa e mbetur e letrave me deklaratat e tyre mund të jenë alternativa;

Punë në grup:

- Organizohuni në grupe të vogla (5-7 pjesëmarrës);
- Diskutoni zgjedhjet tuaja dhe bini dakord, si grup, për pesë letra gjithsej;
- Radhitni në një fletë (Flipqar), ashtu që dy letrat më të rëndësishme (dy deklaratat më të rëndësishme) të jenë në qendër, ndërdsa tri të tjerat mund t'i vendosni diku tjetër (përreth) në fletë.

Seanca plenare:

- Prezantoni posterin e grupit tuaj dhe shënoni (potenconi) dyja pohimet kryesore në tabelë.
- Secili pjesëmarrës do të marrë dy letra ngjitëse dhe do të etiketojë (votojë) pohimet më të rëndësishme që keni zgjedhur.

Faza 2: Inventari

Në grupet e vogla vlerësohen **kushtet e shkollës** duke përdorur tabelën e dhënë më poshtë. Tabela duhet të shfaqet si gazetë muri ose në një projektor – në këtë fazë, në ekran duhet paraqitur vetëm dy kolonat e para.

Pikat ku përqendrohemi/përparësitë:

1.Çfarë bëhet tashmë në shkollat tona:	2. Përvojat që kemi pasur me këtë:	3. Objektivat që duam të arrijmë:	4. Hapat tonë të mëtejshme:	5. Bashkëpunimi i mundshëm me partnerët:
Shkolla	Partnerë kontakti....			

Faza 3: Prezantimi i vlerësimit

Prezantimi në seancë plenare i rezultateve të punës në grup për kolonën 1 dhe 2 në tabelë.

Faza 4: Rezultate

Pas analizës së kolonës 1 dhe 2, vijohet me plotësimin e kolonave 3, 4 dhe 5, gjegjësisht me formulimin e objektivave, hapave konkret dhe personave bartës për aktivitetet e planifikuara.

Faza 5: Shtysa të mundshme

- Kush bën çfarë, kur dhe me kë?
- Kur do të bëhet raporti për punën në grup (mbledhje biznesi, konferenca të përgjithshme dhe mbrëmje me prindërit)?
- Si do të vazhdohet më tutje dhe çfarë duam të arrijmë?
- Për çfarë përkrahje kemi nevojë (p.sh. trajnim avancues)

4. Krijimi i një klase gjithpërfshirëse dhe ndërkulturore

Kohëzgjatja dhe vendi në [program](#): 1orë e 30 min, dita 2, seanca 4 (pasdite).

Objektivat:

- Aktivitete eksperimentale për mekanizmat e përfshirjes dhe përjashtimit;
- Eksplorimi i dinamikës bazë sociale-psikologjike në kontaktin në grup, kominikimi ndërmjet grupit dhe predispozitat për bashkëpunim;
- Analiza e parametreave të klasës dhe planifikimi i kontakteve përfshirëse në kuadër të grupit.

Burimet që nevojiten:

- Kompjuter, projektor, ekran;
- Prezantim në Power Point - Kontaktet brenda grupit

Përshkrimi i modulit:

Moduli i dytë fokusohet në diversitetin në klasa dhe sfidat për gjithpërfshirje sociale dhe bashkëpunim. Pas përvojës me veprimtarinë dinamike të grupit në lidhje me mekanizmat e përfshirjes dhe përjashtimit, pjesëmarrësit do të ftohen që të analizojnë situata konkrete në klasë dhe të identifikojnë mundësitë për të promovuar kontakte ndërmjet fëmijëve të popullatës shumicë dhe nxënësve që i përkasin pakicave.

Seanca do të mbyllet me një prezantim të shkurtër të gjetjeve kryesore që lidhen me kontaktet brenda grupit dhe përmirësimin e marrëdhënieve ndërmjet grupeve të ndryshme sociale.

Procesi i punës:

Pjesa 1:“Tre vullnetarët” (45 min)

Aktiviteti: (20min)

Ekipi drejtues kërkon që tre pjesëmarrës vullnetarë të largohen nga dhoma. Ata nuk marrin asnjë informacion të mëtejshëm. Pjesëmarrësit tjerë marrin materiale, me të cilat krijojnë një simbol, me të cilin ata definojnë si grup. Ekipi drejtues kërkon që të vendosin elemente të tjera që grupi mund t'i ndajë, për shembull, gjeste të veçanta ose fjalë të koduara. Grupi ulet në karrige, të vendosura në rreth dhe fillon të diskutojë për temën e caktuar. Ata përdorin gjuhën e tyre të koduar. Ekipi drejtues i fton tre vullnetarët të kthehen në sallë dhe u kërkon atyre që të integrohen me pjesën tjetër të grupit. Ushtrimi përfundon pas rreth 20 minutash dhe fillon diskutimi.

Udhëzime për përmbledhjeje (25min):

1. Trajneri do të ftojë 3 vullnetarë për të shprehur ndjenjat dhe përvoja kur ata hyjnë në sallë dhe vëzhgojnë grupin.

2. Pastaj pjesëmarrësit e grupit shumicë do të ftohen për të folur për procesin dhe ndjenjat e tyre si shumicë.
3. Është e rëndësishme që të pyten për ofertat apo iniciativat për të integruar të ardhurit dhe të përqëndrohen në llojin e marrëdhënieve ndërgrupore që kanë zhvilluar.
4. Kodi sekret duhet të trajtohet nga dy këndvështrime: A e kuptuan të sapo ardhurit atë? Si u ndien me faktin se grupi shumicë kishte një gjuhë të përbashkët? Si u ndien me faktin se nuk e kuptuan gjuhën dhe shenjat e shumicës?
5. Është e rëndësishme të shqyrtohet ndërveprimi midis tre vullnetarët: a bashkëpunuan ata? Çfarë bënë ata për të mbështetur njëri-tjetrin? Çfarë mund të kanë bërë ndryshe?
6. Është gjithashtu e rëndësishme që të shikoni për alternativa brenda shumicës: kush mendoi për ofertat për mbështetje, për dhënien e shpjegimeve, ose edhe për hapjen e rrethit? Çfarë do të kishte ndryshuar nëse kjo do të kishte ndodhur?

Pjesa 2: Shtrirja dhe transferimi (25min): A ekzistojnë këto mekanizma edhe në shkollat dhe klasat tona?

a) Punë në grup (15min)

Shtysa për reflektim:

- A shihni situata dhe procese të ngjashme në shkollat tuaja?
Përpiquni të gjeni shembuj konkretë nga shkolla juaj.
- Përpiquni të gjeni alternativa?
- Çfarë mund të ndryshohet lehtësisht?

b) Prezantimi i rezultateve kryesore (10min)

Pjesa 3: Gjetjet e studimit për marrëdhëniet brenda grupit dhe dinamika e tyre (20min)

Prezantim i shkurtër nga trajneri bazuar në prezantimin Power Point.

5. Shembuj të metodave, aktiviteteve dhe masave

Kohëzgjatja dhe vendi në [program](#): 1 orë e 30 min, dita 3, seanca 1 (paradite).

Objektivat:

- Ofrimi i një vështrimi të përgjithshëm për qasjet, kurrikulat dhe metodologjitë për zhvillimin e klasës;
- Informim lidhur me strategjitë e të nxënit (inter-) aktiv dhe të nxënit bashkëpunues, si dhe diskutimi i zbatueshmërisë;
- Përmirësimi i aftësive praktike të pjesëmarrësve për menaxhimin e diversitetit në nivel klase.

Burimet që nevojiten:

- Fletë pune, ushtrime praktike

Përshkrimi i modulit:

Ky modul synon të ofrojë aftësi praktike për menaxhimin gjithpërfshirës të klasës. Pjesëmarrësit do të marrin informacion të detajuar për strategjitë kyçe dhe shembujt e praktikës së mirë si edhe trajnim për metodat aktive dhe bashkëpunuese. Në këtë seancë, theksi do të vihet në nxënien eksperimentale dhe në planifikimin për zbatim praktik. Do të punohet me raste studimore dhe do të përgatitet një kurrikulum i përgjithshëm për të nxitur gjithpërfshirjen sociale dhe nxënien ndërkulturore.

Gjatë kësaj seance do të trajtohen nevojat e fëmijëve të kthyer (riatdhesuar), dhe pjesëmarrësit do të ftohen që të identifikojnë strategjitë gjithpërfshirëse, të cilat mund të mbështesin riatdhesimin e tyre.

Procesi i punës:

- Aktivitet ngrohës : *“Historia e emrit tim”* (shihni shtojcën);
- Prezantim i ushtrimeve praktike;
- Punë individuale: realizimi i veprimtarive për kohën/takimin e grupit, fillimin e vitit shkollor, ngjarjeve shoqërore, mësimet.

Shënim: është e rëndësishme që të fokusohen sfidat për integrimin e fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptianë si edhe fëmijët e kthyer (riatdhesuar). Në këtë seksion, duhet të diskutohen pengesat për gjithpërfshirje.

6. Të nxënit e bazuar në projekte

Kohëzgjatja dhe vendi në program: 1 orë e 30 min, dita 3, seanca 2 (paradite).

Objektivat:

- Qartësimi i parimeve, hapat dhe kërkesat e të nxënit e bazuar në projekte;
- Të kuptuarit e përfitimeve të mundshme të të nxënit bazuar në projekte lidhur me objektivat e një shkolle gjithpërfshirëse dhe përputhshmëria e saj me Kornizën e re Kurrikulare.

Burimet e nevojshme:

- Kompjuter, projektor, ekran;
- Prezantim në Power Point - Të mësuarit e bazuar në projekte;
- Tabelë, markera, letër;
- Materiali Kompetencat kyçe në Kornizën Re të e Kurrikulës;
- Materiali Elementët kyçe të të mësuarit e bazuar në projekte.

Përshkrim i modulit:

Pjesa 1 (30 min): Trajneri paraqet elementet kyçq të të nxënit të bazuar në projekte dhe jep dy shembuj. Në grupe të vogla, pjesëmarrësit krahasojnë këto elemente me parimet e Kornizës së Re të Kurrikulës dhe kompetencat kyçe që parashikon. Duke përdorur metodën “pop-corn” [metodë përmes së cilës u jepet mundësia të gjithë pjesëmarrësve që shkurtimisht të shprehin mendimin e tyre], pjesëmarrësit e grupeve të ndryshme tregojnë arsyet pse këto të dyja shkojnë së bashku.

Pjesa 2 (20 min): Në grupe të vogla (të krijuara sipas moshës së nxënësve me të cilat punojnë), pjesëmarrësit dizajnojnë aktivitet të nxënies të bazuar në projekt, e cila mund të realizohet me nxënësit e tyre, marrë në konsideratë kontekstin lokal dhe preferencat e tyre.

Pjesa 3 (40 min): Çdo aktivitet i propozuar diskutohet dhe analizohet. Informata kthyesë (Feedback) dhe sugjerime jepen nga kolegët dhe trajnertët.

7. Planifikimi i zhvillimit të shkollës. Puna ekipore

Kohëzgjatja dhe vendi në program: 1 orë 30 min, dita 3, seanca 3 (pasdite).

Objektivat:

- Konsolidimi i të kuptuarit të procesit të zhvillimit të shkollës me qëllim të integritit të një qasjeje gjithpërfshirëse;
- Inicimi i planifikimit të një procesi pjesëmarrës në nivel shkolle që çon në planin e zhvillimit të shkollës, për t'u prezantuar në fillim të Pjesës së dytë të trajnimit;
- Rritja e ndërgjegjësimit për rëndësinë e bashkëpunimit të mirë ekipor në suksesin e procesit të planifikimit dhe në zbatimin e tij.

Burimet e nevojshme:

- Tabelë, letër, markera;
- Material et e shtypura Rolet në grup
- Materialet e shtypura Detyrat e grupit

Përshkrimi i modulit:

Pjesa 1 (10 min): Trajneri sjell në kujtesë elementet kryesore të prezantuara në seancat e mëparshme, duke theksuar se tani, pas prezantimit të disa shembujve të aktiviteteve, të metodologjisë së të mësuarit e bazuar në projekte dhe duke konsideruar përvojën e mëparshme të pjesëmarrësve dhe specifikat e kontekstit të tyre lokal, ata mund të kuptojnë më mirë llojet e masave dhe aktivitetet që mund të përfshihen në një plan zhvillimi të shkollës së tyre, me synim që ta bëjnë atë më gjithpërfshirëse dhe më të suksesshme për të gjithë fëmijët.

Pjesa 2 (40 min): Në grupe të vogla, pjesëmarrësit kryejnë detyrat e mëposhtme:

a). Caktojnë role (moderatori, personi përgjegjës për të mbikëqyrur komunikimin dhe punën e ekipit, personi që do të kujdeset afatet kohore, raportuesi, shkruesi dhe oponenti kritik). Kjo bëhet bazuar në materialet që shpërndahen (Rolet në grupu). Trajneri kontrollon nëse janë kuptuar udhëzimet dhe bën qartësime shtesë nëse është e nevojshme.

b). Bëjnë një draft plan se si mund të organizohet procesi në nivel shkolle, duke pasur parasysh pyetjet e mëposhtme:

- Kush do të përfshihet?
- Si do të komunikohet?
- Ku dhe kur duhet të bëhet planifikimi?
- Çfarë është e nevojshme për përgatitjen e procesit?
- Cilat elementet që duhet të merren parasysh gjatë procesit?
- Cilat janë rreziqet që duhet të shmangen?
- Përgatisin dhe bien dakord për prezantimin e planit para kolegëve të shkollave të tjera.

Pjesa 3 (40 min): Diskutim për punën e ekipit: si të krijoni atmosferë të mirë të ekipit dhe produktivitet të ekipit. Çdo person përgjegjës për mbikëqyrjen e komunikimit dhe punëve të ekipit do të ndajë me të gjithë pjesëmarrësit vëzhgimet e tij dhe do të bëjë komente. Pjesëmarrësve u kërkohet që të komentojnë nga këndvështrimi i tyre. Trajneri shkruan disa përfundime kryesore lidhur me faktorët që lehtësojnë dhe që pengojnë punën e ekipit.

Rolet në grup:

Të gjithë pjesëmarrësit në grup kanë mundësinë që të diskutojnë për rolin dhe çështje lidhur me detyrën në grup dhe të performojnë role specifike në grup. Rolet specifike janë si më poshtë:

➤ Moderatori

Roli juaj është të moderoni diskutimin, duke u siguruar që të gjithë të kenë mundësi që të flasin, të diskutohen dhe analizohen të gjitha mendimet, që vendimet të merren në mënyrë demokratike dhe që të eliminohen shmangiet nga detyrat. Për të siguruar pjesëmarrje të ekuilibruar, mund të duhet t'u drejtoni disa pyetje shtesë disa pjesëmarrësve dhe të ndërprisni të tjerët dhe të kërkoni që ndërhyrjet e tyre të jenë më të shkurtra. Në fund të seancës në grup, duhet t'i kërkoni raportuesit që të përmbledhë të gjitha çështjet kyçe, të cilat do tu prezantohen kolegëve të tjerë dhe të marrë informata kthyesë nga anëtarët e grupit.

➤ Personi përgjegjës për të mbikëqyrur komunikimin dhe punën e ekipit

Roli juaj është të mbikëqyrni se si anëtarët e grupit komunikojnë dhe punojnë si ekip. A po e kryen moderatori me sukses rolin që i është caktuar? A është i ekuilibruar procesi i komunikimit apo dikush flet më shumë sesa të tjerët? A merren parasysh të gjitha mendimet? Nëse ka mosmarrëveshje, si menaxhohen ato? A mbështesin anëtarët e grupit njëri-tjetrin në kryerjen e detyrave?

➤ Oponenti kritik (reflektuesi kritik)

Roli juaj është të mendoni për propozime të formuluar dhe të identifikoni rreziqet që lidhen me zbatimin e tyre. Për shembull, duhet të reflektoni për mënyrën se si drejtori i një shkolle, përfaqësuesi i një drejtorie arsimore, apo drejtuesi i një këshilli prindëror do të reagoje lidhur me propozimet. Duhet të mendoni në mënyrë konstruktive për mënyrën se si do t'i shmangni ose kufizoni rreziqet e identifikuar.

➤ Matësi i kohës

Roli juaj është të ndihmoni ekipin që të zbatojë afatet kohore të caktuara. Duke pasur parasysh pyetjet që do të bëhen, duhet të njoftoni ekipin nëse po ec shumë ngadalë apo nëse ka kohë që të trajtojë me detaje disa çështje.

➤ **Raportuesi**

Roli juaj është që të prezantoni konkluzionet kyçe në mbledhjen e përgjithshme. Për këtë duhet të mbani shënime gjatë gjithë diskutimit dhe të bini dakord me anëtarët e grupit për atë që do të prezantohet.

➤ **Shkruesi**

Roli juaj është të shkruani në një tabelë (Flipqar) idetë kyçe që dalin nga ndërhyrjet (propozimet) e anëtarëve të grupit, kur ato janë të formuluar. Kjo do t'ju ndihmojë që të mbani shënim ato që diskutohen, të shmangni përsëritjet e kota dhe të ecni përpara me realizimin e detyrave.

Detyrat e grupit

Nisur nga ajo që është prezantuar në këtë modul dhe në modulën e mëparshëm, dhe duke pasur parasysh kontekstin lokal në shkollën tuaj, detyra e grupit tuaj është të zhvilloni një draft plan për mënyrën e organizimit të procesit të zhvillimit të shkollës, në nivel shkolle.

Për këtë, mund të konsideroni pyetjet e mëposhtme:

- Kush do të përfshihet?
- Si do të komunikoni me kolegët?
- Ku dhe kur duhet të bëhet planifikimi?
- Çfarë është e nevojshme për të përgatitur procesin?
- Cilat janë elementët që duhet të merren parasysh gjatë procesit?
- Cilat janë rreziqet që duhet të shmangen?

8. Detyrat e shtëpisë: Detyrat deri në Pjesën e dytë të trajnimit. Vlerësimi

Kohëzgjatja dhe vendi në [program](#): 1 orë e 30 min, dita 3, seanca 4 (pasdite).

Objektivat:

- Ofrimi i kushteve për transferimin e të mësuar nga trajnimi në praktikë tek shkollat pjesëmarrëse;
- Vlerësimi i trajnimit.

Burimet e nevojshme:

- Instrumeni për rishikimin e shkollës;
- Udhëzime për rastin studimor;
- Udhëzime për Planin e Zhvillimit të Shkollës.

Përshkrimi i modulit:

Pjesa 1 (40 min): Vazhdim i seancës së mëparshme: prezantimi dhe diskutimi i planeve për të përgatitur Planin e Zhvillimit të Shkollës në çdo shkollë. Raportuesit e caktuar për çdo shkollë në seancën e mëparshme prezantojnë planin për organizimin e procesit të zhvillimit të shkollës. Pjesëmarrës dhe trajnerët tjerë japin informacionin kthyes dhe sugjerimet e tyre. Trajneri prezanton instrumenin për Rishikimin e shkollës dhe njofton pjesëmarrësit se kjo do jetë pjesë e detyrave të shtëpisë, të cilat duhet të realizohen deri në pjesën e dytë të trajnimit.

Pjesa 2 (10 min): Prezantimi i detyrës së dytë që u caktohet pjesëmarrësve si detyrë shtëpie: në mënyrë individuale, çdo pjesëmarrës zgjedh një fëmijë nga klasa e tij/saj dhe bën një studim rasti bazuar në udhëzimet e dhëna. Prezantimi i rastit studimor (në mënyrë që të ruhet anonimiteti i fëmijës) bëhet ditën e parë të trajnimit të dytë.

Pjesa 3 (20 min): Vlerësimi i pjesëmarrësve. Trajneri rishikon shkurtimisht përmbajtjen e trajnimit dhe temat kryesore të adresuara. Pjesëmarrësit marrin formularin e vlerësimit dhe e mbushin në mënyrë individuale. Formulari i vlerësimit përfshin pjesët e mëposhtme:

- Imagjinoni që po shoqëroni drejtorin e shkollës në korridor dhe ai është duke shkuar në një takim me Kryetarin e Komunës. Ju keni vetëm 1 minutë kohë që t'i shpjegoni se çfarë ka ndodhur gjatë trajnimit ("elevator speech")- [shqip përmbledhje e shpejtë]
- Cilat janë 3 gjërat e reja më interesante që mësuar gjatë trajnimit dhe pse?
- Përshkruani një ndryshim konkret në shkollën tuaj, të cilin ju e konsideroni si të nevojshëm që të bëhet si rezultat i trajnimit.

Pjesa 4 (20): Kontrolli i pritshmërive fillestare dhe informacioni kthyes që jepet nga pjesëmarrësit për trajnimin. Trajneri lexon me zë të lartë pritshmëritë e formuluar nga pjesëmarrësit në fillim të trajnimit (të cilat më përpara grupohen në kategori me qëllim që të shmangen përsëritjet e panevojshme). Pritshmëritë më pas kategorizohen sipas pjesëmarrësve (në një diskutim të hapur të të gjithë grupit) në kategoritë e mëposhtme:

- Pritshmëritë që janë përmbushur gjatë trajnimit;
- Pritshmëritë që janë përmbushur pjesërisht gjatë trajnimit, ose që nuk janë përmbushur, por të cilat duhet të trajtohen në seanca të ardhshme të trajnimit;
- Pritshmëritë që nuk janë të rëndësishme edhe më tutje.

Nëpërmjet një ushtrimi interaktiv (në varësi të mundësive që ofron salla e trajnimit), pjesëmarrësit shprehin mendimet e tyre për aspekte të ndryshme të trajnimit, përfshirë:

- Programin;
- Metodën e trajnimit;
- Bashkëpunimin me kolegët;
- Kontributin e tyre;
- Logjikën;
- Projektin në tërësi;

Trajnimi do të përfundojë me një raund me komente përfundimtare: një fjali, lidhur me të cilën, çdo pjesëmarrës duhet të zgjedhë një nga shprehjet e mëposhtme për të filluar:

- Unë do të...
- Unë dua....
- Unë shpresoj...
- Unë kam nevojë...
- Unë

PËRMBAJTJA E TRAJNIMIT PËR PJESËN II

Agjenda e trajnimit të dytë në kuadër të programit të nxitjes së përfshirjes sociale

DITA 1

09:30 Seanca 11 - Shqyrtimi i planeve zhvillimore të shkollës. Informacion kthyes.

10:45 Pauze për kafe

11:00 Seanca 12 - Shqyrtimi i rasteve studimore. Çfarë mund të bëhet? Përshtatja e planit.

12:30 Dreka

14:00 Seanca 13 – Ushtrim mbi të mësuarit bashkëpunues lidhur me situatën e të kthyerve

15:30 Pauzë për kafe

16:00 Seanca 14 - Përdorimi i teknikave bashkëpunuese e të mësuarit në klasë heterogjene

DITA 2

09:00 Sesioni 15 - Vetëdijesimi kulturor, ndërgjegjësimi gjuhësor dhe edukimi ndërkulturor

10:30 Pauzë për kafe

10:45 Seanca 16 – Mentorim dhendërmjetësim mes kolegëve

12:15 Dreka

13:30 Seanca 17 - Bashkëpunimi me prindërit. Roli i ndërmjetësuesve të arsimit

15:00 Pauzë për kafe

15:15 Seanca 18 - Bashkëpunimi me qendrat mësimore dhe strukturat tjera mbështetëse vendore Detyrat e shtëpisë

16:30 Fundi i trajnimit të dytë

11. Hapja e pjesës së dytë të trajnimit dhe rishikimi i Planeve të Zhvillimit të Shkollës

Kohëzgjatja dhe vendi në program: 1orë e 15 min, dita1, seanca 1(paradite).

Objektivat:

- Vendosja e pjesës së dytë të trajnimit në kuadrin e programit dhe në kontekstin e punës së mëparshme;
- Përmbledhja e elementeve kryesore nga trajnimi i mëparshëm;
- Rishikimi i Planeve të Zhvillimit të Shkollës, informacioni kthyes/komente dhe diskutim;
- Sqarimi i strategjive kryesore lidhur me gjithpërfshirjen e fëmijëve romë, ashkalinj, egjiptianë dhe atyre të kthyer.

Burimet e nevojshme:

- Kompjuter, projektor, ekran;
- Prezantime në Power Point - Hapja e PJESËS II;
- Fletë pune mbi Pyetjet Orientuese për planet e shkollës;
- Materiale të përgatitura nga pjesëmarrësit.

Përshkrim i modulit:

Ky sesion ka tri pjesë të veçanta, të cilat mund të moderohen nga trajner të ndryshëm.

Pjesa e parë përfshin fjalën e mirëseardhjes, një aktivitet parapërgatitor (aktivitet ngrohës) dhe një prezantim të programit të trajnimit për Pjesën II, të objektivave të tij, si dhe të elementeve kryesore, mbi të cilat është përqendruar qasja e trajnimit. Pasqyra e përgjithshme e seancave të trajnimit do të prezantohet nëpërmjet përdorimit të prezantimit në Power Point.

Aktiviteti ngrohës i sygjëruar : “Rrethi qarkullues ” (20 min)

Procedura:

Grupi formon një rreth të brendshëm dhe një rreth të jashtëm, pjesëmarrësit qëndrojnë përballë njëri-tjetrit, në çift.

Pjesëmarrësve u kërkohet të diskutojnë formulimet dhe pyetjet e dhëna nga trajneri.

Pas një diskutimi të shkurtër, rrethi i jashtëm lëviz dhe pjesëmarrësit flasin me një person tjetër. Aktiviteti mbyllet kur të gjithë anëtarët e grupit të kenë qarkulluar dhe të kenë folur me njëri-tjetrin.

Lista e deklaratave dhe komenteve:

- Si ndiheni lidhur me kalimin e fundjavës duke u trajnuar?

- A keni hasur në klasën tuaj ndonjë situatë që ju ka bërë të mendonit për trajnimin tonë?
- Si i keni trajtuar ato?
- A ka ndikuar trajnimi ynë në komunikimin tuaj me fëmijët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian?
- A keni provuar të aplikoni ndonjë prej aktiviteteve të manualit? Çfarë përvoja patët?
- Çfarë mbani mend nga trajnimi i parë?
- Çfarë është Plani i Zhvillimit të Shkollës dhe cili është mendimi juaj për këtë koncept?
- A mund të përkufizoni termin “diskriminim strukturor”?
- A mund të jepni disa shembuj, nga përvoja juaj, se si pritshmëritë e mësimdhënësve mund të ndikojnë në performancën e nxënësve?
- A do t’i dërgonit fëmijët tuaj në shkollën ku jepni mësim?

Diskutim i shkurtër në seancë plenare: sqarime, shkëmbim opinionesh (5min)

Pjesa e dytë përqendrohet në shqyrtimin e detyrave të shtëpisë që pjesëmarrësit është dashur të realizojnë:

- Vlerësim i situatës në shkollën e tyre, bazuar në pyetësin e shpërndarë në trajnimin e mëparshëm;
- Hartimi i një drafti për Planin e Zhvillimit të Shkollës, bazuar në kuptimin e qasjes tërëshkollë ndaj gjithpërfshirjes sociale, si dhe adaptimi i këtij koncepti të zhvillimit me kontekstin lokal të çdo shkolle dhe të punës së përditshme të pjesëmarrësve.

Pjesa e tretë ku ekipet e secilës shkolle do të kalojnë nëpër dy fazat e mëposhtme:

Faza 1: Prezantim i shkurtër i gjetjeve të pyetësorit, i pasuar nga pyetje qartësuese të kolegëve dhe trajnerëve;

Faza 2: Prezantim i draftit të Planeve të Zhvillimit të Shkollës dhe marrja e komenteve dhe sugjerimeve nga kolegët dhe trajnerët. Diskutimi rreth planeve do të bëhet mbi bazën e dokumentit Instrumenti për vetëvlerësimin e shkollës.

Pas finalizimit të fazës 2 nga të gjitha shkollat, fillohet me fazat e mëposhtme:

Faza 3: Rishikim i Planeve të Zhvillimit të Shkollave bazuar në informacionin kthyes, sipas ekipeve të shkollave.

Faza 4: Prezantim i ndryshimeve të bëra në plane.

Në këtë mënyrë, secili prej ekipeve mund të përfitojë nga informacioni i drejtpërdrejtë kthyes i dhënë nga kolegët, trajnerët dhe nga dëgjimi i Planeve të propozuara nga shkollat e tjera.

12. Rishikimi i rasteve studimore për fëmijët e sapoardhur në klasë

Kohëzgjatja dhe vendi në program: 45 min, dita 1, seanca 2 (paradite).

Objektivat:

- Reflektim mbi situatën e fëmijëve të sapoardhur, kur ata bëhen pjesë e klasës;
- Identifikimi i nevojave dhe elementeve specifike, si dhe praktikave të menaxhimit të klasës, të cilat mund përmbushin këto nevoja;
- Identifikimi i mundësive për të përdorur vlerat dhe burimet që fëmijët e sapoardhur sjellin në klasë;
- Stimulimi i shkëmbimit të përvojave dhe komunikimi mes mësimdhënësve të shkollave që janë të përfshira në trajnim.

Burimet e nevojshme:

- Fletë vëzhgimi, Lista kontrolluese e fëmijëve të sapoardhur;
- Materiale të përgatitura nga pjesëmarrësit.

Përshkrimi i modulit:

Në grupe të vogla, të përziera me nga 4-5 pjesëmarrës, çdo pjesëmarrës prezanton rastin studimor që ka përgatitur dhe e diskuton atë me anëtarët e tjerë të grupit.

Pasi të kenë mbaruar prezantimin, të gjithë pjesëmarrësit, grupi do të identifikojë:

- Nevojat kryesore specifike të fëmijëve të sapoardhur dhe pengesat që ata hasin;
- Praktika të përshtatura të menaxhimit të klasës, të cilat mund të kontribuojnë për t'iu përgjigjur këtyre nevojave;
- Pikat e forta dhe burimet që sjellin me vete fëmijët e sapoardhur në klasë;
- Metodatat për t'i vënë sa më mirë në përdorim këto burime, në të mirë të të gjithë fëmijëve dhe të kohezionit të klasës.

Një përfaqësues nga çdo grup do të paraqesë rezultatet kryesore dhe, në bazë të këtyre prezantimeve, do të plotësohen dy tabelat e përbashkëta:

Nevojat specifike	Si mund të adresohen?

Pikat e forta	Si mund të përdoren?

Përfundimet e dala duhet të ndërlidhen me :

- ✓ Rëndësinë e vëzhgimit të kujdesshëm nga mësimdhënësi;
- ✓ Nevojën për të ndërmarrë masa, duke mos pritur që të jetë vetëm fëmija ai që do të përshtatet;
- ✓ Faktin që fëmijët gjithmonë sjellin me vete burime të vlefshme dhe jo vetëm pengesa dhe nevoja.

13. Nxitja e gjithpërfshirjes së fëmijëve të riatdhesuar romë, ashkalinj dhe egjiptianë

Kohëzgjatja dhe vendi në program: 1 orë e 30 min, dita 1,seanca 3 (pasdite).

Objektivat:

- Prezantimi i konceptit të përballimit të përvojës traumatike nga këndvështrimi arsimor dhe reflektimi mbi ndikimet që ajo ka në mësimdhënie dhe mësimnxënie;
- Njohja e pjesëmarrësve me të kuptuarit e faktorëve e riskut të lartë dhe faktorëve mbrojtës në zhvillimin e fëmijës;
- Dhënia e informacionit mbi nevojat e fëmijëve të riatdhesuar, i ofruar nga një ekspert i jashtëm i psikologjisë së fëmijëve;
- Kontekstualizimi dhe përshtatja e konceptit të përballimit me realitetet e shkollës;
- Integrimi i këndvështrimit gjithpërfshirës dhe ndërkulturor në Planet e Zhvillimit të Shkollës.

Burimet e nevojshme:

- Kompjuter, projektor, ekran;
- Fletë pune përballimi/resilienca, fletë pune për fëmijët e riatdhesur;
- Prezantim në Power Point - Përballimi/reziliencadhe arsimimi;
- Ekspert i ftuar.

Procesi i punës:

Pjesa 1: Aktivitet biografik “ Zhvillimi personal ” (20min)

- Punë individuale vetëreflektuese:

Pjesëmarrësit marrin një letër dhe vizatojnë linjën e jetës së tyre. Ata ftohen të strukturojnë dhe të japin në formë vizuale procesin e tyre të socializimit.

Shtypsa për reflektim:

- Kushtet e mia në fillim?
- Përvojat e mira dhe të këqija?
- Sfidat me të cilat jam ndeshur?
- Çfarë më ka ndihmuar që t’i përballoj?
- Çfarë lloj mbështetjeje kam marr në situatat e vështira të jetës?
- Çfarë më ka ndihmuar të bëhem ky/kjo që jam sot?
- Prezantime të shkurtra të vëzhgimeve.

Trajneri mund të theksojë rolin e prejardhjes familjare, të marrëdhënieve dhe mbështetjes sociale, si dhe të prezantojë konceptet të faktorëve mbrojtës dhe faktorëve të pafavorshëm.

Pjesa 2: Koncepti i përballimit nga këndvështrimi arsimor

Koncepti i përballimit/resiliencës:

- Prezantim në Power Point nga trajneri (10min)
- Shembuj dhe këndvështrime psikologjike të prezantuara nga një ekspert i jashtëm, nga një organizatë që punon me fëmijët e riatdhesuar, ndërlidhur me diskutim (15 min);
- Ushtrim në grup të vogël bazuar në fletën e punës (20 min);
- Shkolla si hapësirë mbështetëse;
- Prezantim në Power Point nga trajneri (10 min);
- Këshilla nga eksperti i jashtëm dhe diskutim (15 min);

14. Ushtrime për të nxënit bashkëpunues gjatë punës me fëmijët e kthyer

Kohëzgjatja dhe vendi në program: 1orë e 30 min, dita1, seanca 4 (pasdite).

Objektivat:

- Kuptimi i vlerave që kanë metodat e të nxënit bashkëpunues për mësimin, klimën pozitive dhe kohezionin në klasë;
- Eksplorimi i konceptit të përballimit/resilencës dhe konsekuencat për shkollat dhe mësimdhënësit/et ;
- Analiza e karakteristikave të klasave dhe planifikimi i mjediseve pozitive .

Burimet e nevojshme:

- Kompjuter, projektor, ekran;
- Prezantim në Power Point - Të nxënit bashkëpunues;
- Fletë pune: Raste studimore;
- Fletë pune: Fëmijët e cënuar – të kuptohen simptomat e vuajtjeve;
- Fletë: Strategjitë bazë për ofrimin e mbështetjes emocionale.

Përshkrimi i modulit:

Ky modul ka dy dimensione

- **Dimensioni i parë** përqendrohet në kuptimin e nevojave të fëmijëve të kthyer dhe përgjegjësi të shkollës për t'ju përgjigjur kushteve dhe nevojave specifike;
- **Dimensioni i dytë** përqendrohet në kuptimin e përfitimeve dhe sfidave që sjell metodologjia e të nxënit bashkëpunues.

Moduli fillon me një ushtrim bashkëpunues mbi atë se çfarë mund të bëjë shkolla për të mbështetur fëmijët e kthyer dhe vijon më tej me një prezantim, të ndjekur nga diskutim për të nxënit bashkëpunues.

Pjesa 1: Ushtrimi i të nxënit bashkëpunues.

- Pjesëmarrësit ndahen në gjashtë grupe dhe punojnë për 15 min si më poshtë:
- Dy grupe analizojnë rastet studimore dhe simptomat e fëmijëve në gjendjen e vuajtjes psikologjike;
- Dy grupe marrin në shqyrtim strategjitë për ofrimin e mbështetjes emocionale dhe përfshirjes sociale në nivel klase;
- Dy grupe shqyrtojnë mu ndësitë e bashkëpunimit në mes të shkollës dhe prindërve në ofrimin e mbështetjes.

Në grupet e para, mësimdhënësit/et përgatisin kartela për rastet studimore, ku përshkruhet shkurtimisht prejardhja familjare, mosha, sjellja, arritjet dhe problemet e fëmijës. Këto do të

shërbejnë si kartela burimore për hapin e mëtejshëm. Nëse është e nevojshme, do të ofrohen disa prej shembujve nga rastet studimore, për të shpjeguar sesi do të procedohet më tutje. Në të dy grupet e tjera, pjesëmarrësit diskutojnë se cilat nga strategjitë e sugjeruara në fletët e punës korrespondojnë më mirë me kontekstin e shkollave në Kosovë.

- Në grupet e përziera, pjesëmarrësit punojnë për 20 min për të analizuar situata konkrete në klasë dhe për të identifikuar mundësitë për ndërhyrje konkrete, por edhe për të kuptuar se çfarë kufizimesh krijohen në punë për shkak të pabarazive dhe diskriminimit.
- Secili grup merr kartelat e krijuara gjatë hapit të mëparshëm. Çdo anëtar i grupit analizon situatën e fëmijës dhe së bashku përpilojnë sugjerime për mbështetjen arsimore.
- Secili grup ndan me të tjerët rezultatet kryesore dhe hartohet një listë e përbashkët e propozimeve (20 min).

Pjesa 2: Prezantimi i të nxënit bashkëpunues

Trajneri bën prezantimin e të Nxënit bashkëpunues, duke bërë njëherazi lidhjen me atë që pjesëmarrësit sapo kanë provuar (15 min).

Diskutim i përgjithshëm (10 min), i cili përqendrohet në mënyrat se si metodat e të nxënit bashkëpunues mund të përdoren në shkollat e Kosovës me qëllim të:

- Rritjes dhe motivimit për mësim dhe përmirësim të arritjeve në shkollë;
- Lehtësimin e integritit të fëmijëve të sapoardhur;
- Përmirësimin e klimës në klasë dhe marrëdhënieve në mes të fëmijëve të popullatës shumicë dhe atyre të komuniteteve pakicë.

15. Ndërgjegjësimi kulturor, ndërgjegjësimi gjuhësor dhe edukimi ndërkulturor

Kohëzgjatja dhe vendi në program: 1orë e 30 min, dita 2, seanca 1(paradite).

Objektivat:

- Ofrimi i një pasqyre të përgjithshme të qasjeve, kurrikulës dhe metodologjive për edukimin ndërkulturor dhe ndërgjegjësimin gjuhësor;
- Përmirësimi i aftësitë praktike të pjesëmarrësve rreth ndërgjegjësimin gjuhësor dhe kulturor
- Të mësuarit lidhur me edukimin ndërkulturor në nivel klase dhe si një këndvështrim ndërdisiplinor.

Burimet e nevojshme:

- Kompjuter, projektor, ekran;
- Fletë pune 1: Promovimi i ndërgjegjësimin gjuhësor dhe diversitetit kulturor;
- Fletë pune 2: Fëmijët e riatdhesuar dhe nevojat e tyre gjuhësore;
- Fletë pune 3: Edukimi ndërkulturor në tërë kurrikulën;
- Prezantim në Power Point - Ndërgjegjësimi gjuhësor.

Përshkrimi i modulit:

Ky modul synon ofrimin e aftësive praktike për menaxhimin gjithpërfshirës të klasës. Pjesëmarrësit marrin informacion mbi strategjitë kyçe dhe shembujt e praktikave të mira, si dhe trajnim mbi metodat e të nxënimit ndërkulturor aktiv dhe bashkëpunues. Në këtë seancë theksi do të vihet tek hartimi i kurrikulës dhe planifikimi për zbatimin e saj në praktikë. Do të punohet në bazë të temave dhe përmes përgatitjes së njësive të vogla kurrikulare, për të nxitur gjithpërfshirjen sociale dhe të nxënimit ndërkulturor.

Gjatë kësaj seance, pjesëmarrësit ftohen të identifikojnë strategjitë që vlerësojnë përvojat e ndryshme kulturore të fëmijëve migrantë dhe atyre të minoriteteve.

Procesi i punës:

Pjesa e parë: Ndërgjegjësimi gjuhësor (45min)

Pas një prezantimi të shkurtër nga trajneri, ku shpjegohet koncepti i ndërgjegjësimin gjuhësor dhe dallimi në mes tij dhe mësimin të gjuhëve, në grupe prej 4-5 mësimdhënësve nga shkolla të ndryshme, por që punojnë me fëmijët e së njëjtës moshë, pjesëmarrësit:

- Lexojnë dhe përmbledhin dy fletët e para të punës për ndërgjegjësimin dhe nevojat gjuhësore të fëmijëve të kthyer;
- Mbledhin ide mbi vënien në zbatim të aktiviteteve të tilla në klasa dhe lëndë të ndryshme;

- Përgatisin një prezantim vizual të sugjerimeve të tyre praktike.

Secili grup bën prezantimin e sugjerimeve kryesore në lidhje me aktivitetet për ndërgjegjësimin gjuhësor.

Pjesa e dytë : Edukimi ndërkulturor dhe gjith përfshirës në shkollë (45 min)

Trajneri sjell në kujtesë idetë e përmendura në seancën paraprak, se një qasje ndërkulturore transversale është rruga më e përshtatshme për promovimin e gjithpërfshirjes dhe marrëdhënieve pozitive ndërkulturore (si opozitë e aktiviteteve të izoluara ndërkulturore).

Pjesëmarrësve u rikujtohen aktivitetet e prezantuara në trajnimin e parë dhe u shpërndahen materiale që përmbajnë sugjerime për aktivitete të tjera.

Në grupe me nga 3-5 persona, ku përfshihen mësimdhënës nga e njëjta fushë kurrikulare, mësimdhënësit/et reflektojnë për mënyrën se si mund të integrojnë një dimension ndërkulturor në aktivitetet shkollore që lidhen me lëndët që ata realizojnë në shkollat e tyre.

Secili grup përgatit sugjerime për mënyrat se si mund të integrohet qasja ndërkulturore në aktivitetet që lidhen me tema të veçanta kurrikulare nga praktika e tyre.

16. Mentorimi dhe ndërmjetësimi nga bashkëmoshatarët (në mes të nxënësve)

Kohëzgjatja dhe vendi në program: 1orë e 30 min, dita 2, seanca2(paradite).

Objektivat:

- Prezantimi i mentorimit dhe ndërmjetësimit nga bashkëmoshatarët (në mes të nxënësve);
- Zhvillimi i aftësive për krijimin dhe menaxhimin e aftësive të mentorimit dhe ndërmjetësimit nga bashkëmoshatarët (në mes të nxënësve).

Burimet e nevojshme:

- Kmpjuter, projektor, ekran;
- Prezantim në Power Point - Mentorimi nga bashkëmoshatarët (në mes të nxënësve) dhe ndërmjetësimi nga bashkëmoshatarët (në mes të nxënësve).

Përshkrimi i modulit:

Pjesa 1: Prezantim nga trajneri dhe pyetje qartësuese (5 min)

Pjesa 2: Lojë në role (40 min)

- a) Lojë në role lidhur me raportet në **mentorim** nga bashkëmoshatarët (në mes të nxënësve)(20 min).

Në dyshe, për pesë minuta pjesëmarrësit luajnë rolet e dy fëmijëve që janë në një marrëdhënie të mentorimit , dhe pas kësaj, ata këmbejnë pozicionet në rol dhe vazhdojnë sërish lojën e roleve edhe për pesë minuta të tjera.

Në diskutimin me të gjithë grupin trajneri:

- I pyet pjesëmarrësit se si u ndjenë ata në secilin prej roleve dhe nëse të qenit një herë në rolin e mentoruesit dhe herën tjetër në rolin e personit që mentorohet i ndihmoi për ta kuptuar dhe arsyetuar procesin e mentorimit;
- Thekson pikat kryesore në lidhje me atë çka e bën marrëdhënien e mentorimit nga bashkënxënësit që të funksionojë mirë.

- b) Lojë në role për **ndërmjetësimin** nga bashkëmoshatarët (në mes të nxënësve)(20 min).

Në grupe me nga tre veta, sipas udhëzimit të trajnerit, pjesëmarrësit krijojnë një situatë ndërmjetësimi. Pas pesë minutash ata këmbejnë rolet në mënyrë që secili të ketë mundësi që të luajë rolin e ndërmjetësuesit.

Në diskutimin me të gjithë grupin trajneri:

- I pyet pjesëmarrësit se si u ndjenë ata në secilin prej roleve dhe nëse të qenit një herë në rolin e ndërmjetësuesit dhe herën tjetër në rolin e personit që ndërmjetësohet i ndihmoi për ta kuptuar dhe arsyetuar procesin e ndërmjetësimit;
- Thekson pikat kryesore lidhur me atë se çka e bën ndërmjetësimin nga bashkënxënësit të funksionojë mirë.

Pjesa 3: Krijimi dhe menaxhimi i një sistemi për mentorimin dhe ndërmjetësimin nga bashkëmohatarët (në mes të nxënësve) në shkollë.

Pjesëmarrësit ndahen në gjashtë grupe. Tre grupe planifikojnë krijimin e një sistemi për ndërmjetësimin nga bashkënxënësit, ndërsa tre grupe të tjera planifikojnë krijimin e një sistemi të mentorimit nga bashkënxënësit në një shkollë imagjinare në Kosovë(15 min).

Tre grupet e para bëjnë prezantimin. Trajneri nënvizon idetë kryesore nëpërmjet një diskutimi të përgjithshëm. (15 min).

Tre grupet e fundit bëjnë prezantimin. Trajneri nënvizon idetë kryesore nëpërmjet një diskutimi të përgjithshëm. (15 min).

17. Bashkëpunimi me prindërit. Roli i ndërmjetësuesve arsimorë në shkollorë.

Kohëzgjatja dhe vendi në program: 1 orë 30 min, dita 2, seanca 3 (pasdite).

Objektivat:

- Rritja e ndërgjegjësimit për rëndësinë që ka përfshirja e prindërve nga komunitetet e pakicave;
- Kuptimi i rolit dhe përgjegjësive të ndërmjetësuesve arsimorë;
- Përgatitja e masave konkrete për përmirësimin e bashkëpunimit me prindërit me mbështetjen e ndërmjetësuesve arsimorë, në rastet kur ka të tillë të angazhuar.

Burimet e nevojshme:

- Kompjuter, projektor,ekran;
- Prezantim në Power Point - Prindërit dhe ndërmjetësuesit arsimorë;
- Fletë pune: Roli i ndërmjetësuesit arsimorë;
- Burime tjera të mundshme: Udhëzuesi Evropian për Ndërmjetësuesit arsimorë (I disponueshëm në gjuhën lokale); Raporti i studimit të Institutit Pedagogjik të Kosovës ‘*Roli i ndërmjetësuesve arsimorë në integrimin e fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në sistemin arsimor në Kosovë*’(mund të gjendet në faqen zyrtare të IPKsë: <http://www.ipk-rks.net/publikimet.php>).
- Një ndërmjetësues shkollor i ftuar në cilësinë e ekspertit.

Përshkrimi i modulit:

Trajneri prezanton në Power Point për përfshirjen e prindërve dhe rolin e ndërmjetësuesve arsimorë.

Ndërmjetësuesi i ftuar tregon historinë e tij/ të saj dhe sjell shembuj nga përvojat e suksesshme dhe të vështira në punën e tij.

Pjesëmarrësit përfshihen në dialog me ndërmjetësuesin, i cili moderohet nga trajneri.

Trajneri mund të përfshijë në diskutim pyetje të tilla:

- Çfarë presin ndërmjetësuesit nga mësimdhënësit/et për të kryer më mirë rolin e tyre?
- Si mund të ndihmojnë ndërmjetësuesit në rastet e vështira të braktisjes së shkollës, apo të rezultateve të dobëta?
- Çfarë mund të bëhet për të përmirësuar efektshmërinë e bashkëpunimit në mes të ndërmjetësuesve dhe mësimdhënësve?

18. Bashkëpunimi me ndërmjetësuesit dhe qendrat mësimore

Kohëzgjatja dhe vendi në program: 1 orë e 10 min, dita 2, seanca 4 (pasdite).

Objektivat:

- Përgatitja e masave konkrete për përmirësimin e bashkëpunimit me prindërit me mbështetjen e ndërmjetësuesve arsimorë, në rastet kur ka të tillë të angazhuar;
- Planifikimi i një bashkëpunimi më të mirë me qendrën mësimore lokale.

Burimet e nevojshme:

- Flipchart, markera, shirit ngjitës.

Përshkrimi i modulit:

Moduli fillon me prezantimin e një **Dokumentari të shkurtër të nismës së Berlinit** (20 min).

Filmi i shkurtër tregon një shkollë në Berlin, ku ndërmjetësuesit dhe prindërit bashkëpunojnë me mësimdhënësit/et, me qëllim që të ndihmojnë fëmijët romë për t'u integruar në sistemin e gjerman të shkollimit. Prezantimi i videos ndiqet nga një diskutim i shkurtër, që pjesëmarrësit të kuptojnë kontekstin dhe përmbajtjen e aktiviteteve të përshkruara.

Pas kësaj, në grupe sipas shkollave, pjesëmarrësit reflektojnë për rreth 20 min mbi atë se si mund t'i përdorin idetë nga moduli i mëparshëm dhe nga videoja e prezantuar për të përmirësuar bashkëpunimin në mes të shkollës, familjes dhe qendrave mësimore, me mbështetjen e ndërmjetësuesve arsimorë.

Secila shkollë prezanton propozimet e formuluar dhe merr informacionin kthyes nga kolegët dhe trajnerët. Bëhet krahasimi i propozimeve nga shkollat dhe trajneri nënvizon pikat kryesore (30 min).

Mbyllja e seancës 2: Detyrat e shtëpisë dhe vlerësimi

Gjatë 20 minutave të fundit të trajnimit të pjesës së dytë, pjesëmarrësit do të informohen për detyrat e shtëpisë dhe vlerësimin.

Detyrat e shtëpisë që duhet të bëjnë pjesëmarrësit deri në sesionin e ardhshëm të trajnimit përfshijnë:

- a) Bashkëpunimin me kolegët dhe drejtuesin e shkollës për rishikimin e planit të shkollës;
- b) Përgatitjen në mënyrë individuale të një portofoli me aktivitete shkollore dhe strategji të menaxhimit të klasës, të hartuara dhe përshtatura në bazë të shembujve të prezantuar në trajnim, ose të zbatuara në klasat e tyre (aktivitet 3 min për çdo mësimdhënë).

Vlerësimi do të bëhet duke përdorur:

- Një formular vlerësimi, ku përfshihet informacioni kthyes dhe elementet e mësuara (vlerësim me shkrim);
- Një ushtrim i shkurtër ndëraktiv për vlerësimin.

PËRMBAJTJA E TRAJNIMIT PËR PJESËN III

Agjenda e trajnimit të trete në kuadër të programit të nxitjes së përfshirjes sociale

DITA 1

- 09:00 Arritja dhe regjistrimi
- 09:30 Seanca 19 . Shqyrtimi dhe analiza e aktiviteteve të zbatuara në shkolla
- 10:45 Pauz per Kafe
- 11:00 Seanca 20 . Pune ne grupe "Shtëpia e ëndrrës sime"
- 12:30 Dreka
- 14:00 Seanca 21 . Adresimi i çështjeve shpallur nga analiza e veprimtarive shkollore dhe vizitat e shkollave: planet mësimore
- 15:30 Pauz per Kafe
- 16:00 Seanca 21B . Vazhdim
- 18:30 Darka

DITA 2

- 09:00 Seanca 22. Partneritetet Online si mjet për edukimin ndërkulturor dhe përfshirjen sociale
- 10:30 Pauz per Kafe
- 10:45 Seanca 23. Vlersimi I aktiviteteve edukative
- 12:15 Dreka
- 13:30 Seanca 24. Si mund një zhvillim vlerësim mbështetje shkollë pjesëmarrëse. Planifikimi i vlerësimit në nivel shkolle
- 15:00 Pauz per Kafe
- 15:15 Seanca 25 . Vlerësimi i trajnimit dhe konkluzionet bazuar në CoE Key kompetencave për mësimdhënie në lidhje me diversitetin socio-kulturor
- 16:30 Fundi I trajnimit te tret

19. Hapja dhe shqyrtimi i planeve për zhvillim të shkollës dhe aktivitetet në klasë

Kohëzgjatja dhe vendosja në program: 1 orë e 30 min, dita 1, seanca 1(paradite).

Objektivat:

- Vendosja e pjesës së tretë të trajnimit në kornizën e programit dhe në kontekstin e punës së mëparshme;
- Radhitja e elementeve kresore të trajnimit të mëparshëm;
- Shqyrtimi i detyrave pas trajnimit të dytë, komentimi dhe diskutimi;
- Shpjegimi i strategjive kryesore lidhur me gjithpërfshirjen shoqërore të fëmijëve romë, ashkalinj, egjiptianë dhe të kthyerve.

Burimet e nevojshme:

- Kompjuter, projektor, ekran;
- Prezantimet në Power Point - Hapja e trajnimit dhe *Planifikimi i zhvillimit* të shkollës;
- Materialet e përgatitura nga pjesëmarrësit;
- Materialet e trajnimit nga seancat e mëparshme.

Përshkrimi i modulit:

Ky sesion i ka tri pjesë të ndryshme, të cilat mund të moderohen nga trajnerë të ndryshëm.

Pjesa e parë përfshinë adresimin mirëseardhës, aktivitetin ngrohës, dhe po ashtu përfshinë prezantimin e programit të trajnimit për pjesën e 3-të, objektivat e tij, si dhe disa nga elementet kryesore të qasjes së trajnimit. Struktura e sesioneve të trajnimit do të ofrohet përmes prezantimit të sllajdeve.

Aktiviteti i sugjeruar për aktivitet ngrohës: “Barometri” (10 min).

Pjesa e dytë (20 min) është një shqyrtim i shkurtë i disa strategjive kryesore arsimore të prezantuara gjatë dy pjesëve të para të trajnimit.

Kërkohet nga pjesëmarrësit që në grupe të vogla të përziera, të shqyrtojnë qasjet e ndryshme të prezantuara, duke i përfshirë:

- Mundësitë për ndërveprim shoqëror në klasë dhe në shkollë;
- Aktivitetet e punës në grup: aranzhimet bazë dhe përbërja e grupeve;
- Mësimnxënia e bazuar në projekte;
- Integrimi i fëmijëve të kthyer (riatdhesuar);
- Aktivitetet ndërkulturore;

Pas shqyrtimit, pjesëmarrësit do të diskutojnë preferencat e tyre dhe praktikueshmërinë e strategjive të ndryshme në realitetet e shkollave të tyre.

Trajneri mund të theksojë rëndësinë e historisë familjare, marrëdhënieve, mbështetjes shoqërore dhe të paraqesë koncepte të faktorëve mbrojtës dhe atyre pengues.

Pjesa e tretë (1 orë) fokusohet në shqyrtimin e detyrave të shtëpisë, të cilat kanë pasur për detyrë t'i realizojnë pjesëmarrësit ndërmjet pjesës 2 dhe 3 të trajnimit, lidhur me.

- Planin e azhurnuar të zhvillimit të shkollës, bazuar në të kuptuarit e qasjes gjithshkollore në gjithëpërfshirje shoqërore dhe në adaptimin e këtij koncepti zhvillimor në kontekstin lokal specifik të secilës shkollë dhe të punës ditore të pjesëmarrësve.
- Një aktivitet që ka për qëllim përmirësimin e bashkëpunimit me prindërit

Secili ekip i shkollës do të kalojë përmes 2 fazave si më poshtë:

Faza 1: Prezantimi i planeve të azhurnuara për zhvillim e shkollës, si dhe përgatitjet e bëra për zbatim të tyre, si dhe i aktiviteteve që kanë të bëjnë me prindërit dhe të aktiviteteve përkatëse arsimore të zbatuara.

Faza 2: Komentet dhe sugjerimet nga kolegët dhe trajnerët. Diskutimi i planeve do të bëhet në bazë të dokumenteve Pyetësores udhëzuese për vetëvlerësimin e shkollave.

Një diskutimi i përgjithshëm përfundimtar do të përqendrohet në mësimnxënien reciproke dhe në nxjerrjen në pah të konkluzioneve më të rëndësishme, që dalin nga prezantimet dhe në atë që duhet të bëhet për një proces të zhvillimit efektiv dhe të qëndrueshëm të shkollës.

20. Puna e përbashkët: "Shtëpia e ëndrrave të mia"

Kohëzgjatja dhe vendosja në [program](#): 1 orë e 30 min, dita 1.seanca 2 (paradite).

Objektivat:

- Stimulimi i shkëmbimit të përvojave dhe të komunikimit ndërmjet pjesëmarrësve;
- Identifikimi i nevojave specifike dhe i strategjive të komunikimit, të cilat mund të ndihmojnë zgjidhjen e konflikteve;
- Diskutimi i situatave të klasës, ku aktiviteti mund të aplikohet për vendosje të rregullave bazë;
- Të kuptuarit e konceptit të ndërmjetësimit dhe rolit të ndërmjetësve arsimorë;
- Identifikimi i mundësive për bashkëpunim me ndërmjetësit arsimorë.

Burimet e nevojshme:

- Lapsat dhe fletat në madhësi të ndryshme;
- Prezantim: Konflikti, bashkëpunimi , puna ekipore.

Përshkrimi i modulit:

Pjesëmarrësit angazhohen në të tre fazat e ushtrimit "*Shtëpia e ëndrrave të mia*", ashtu siç është përshkruar në pjesën e shtojcës në materialet të trajnimit (1 orë e 10 min.).

Pjesa e mbetur e seancës i dedikohet informimit të nivelit të dytë, që fokusohet në pyetjet e mëposhtme:

- A është ky aktivitet i dobishëm për të reflektuar lidhur me ndërveprimet ndërmjet nxënësve në klasë dhe ndërmjet juve dhe kolegëve tuaj në ekipin e mësimdhënësve?
- Çka mund të nxjerrni nga ky aktivitet për të përmirësuar efikasitetin e bashkëpunimit në ekipin tuaj?
- Si mund ta shfrytëzoni këtë aktivitet me nxënësit tuaj? Jepni disa shembuj.
- Në bazë të ushtrimit dhe të përvojës suaj shkollore, çfarë mundësish për bashkëpunim me ndërmjetësuesit arsimor mund të identifikoni? (mundësi reale në rast se ekzistojnë në lokalitetin tuaj këta ndërmjetësues, në rast se jo, mund të shtroni hipoteza, të paramendonit sikur arat të ishin vërtet të angazhuar).

21. Adresimi i çështjeve të evidentuara nga analiza e aktiviteteve shkollore dhe vizitave nëpër shkolla: Planet mësimore

Kohëzgjatja dhe vendosja në program: 3 orë e ndarë në 2 pjesë, secila nga 1 orë e 30 min , dita 1, seanca 3 (pasdite).

Objektivat:

- Shqyrtimi dhe përmbledhja e strategjive të qarta (explicite) dhe të nënkuptuara (implicite) për gjithpërfshirje shoqërore;
- Kontekstualizimi dhe adaptimi i konceptit për përfshirje shoqërore në realitetet e klasës
- Përmirësimi i cilësisë së planeve mësimore dhe integrimi i një perspektive të qasjes gjithëpërfshirëse në planet mësimore të bazuara në analizën e rasteve studimore

Burimet e nevojshme:

- Kompjuter, projektor, ekran;
- Aktivitetete arsimore;
- Fletë pune: Përfitimet e të nxënit akiv;
- Fletëpune: Përmirësimi i Planit mësimor.

Përshkrimi i seancës:

Pjesa 1: Integrimi i një qasjes gjithëpërfshirëse në planet mësimore.

Përdorimi Fletëve të punës për zhvillimin e modelit të planit mësimor , secili trajner paraqet një shembull të orëve të vëzhguara në shkollat e Kosovës, diskuton këtë me pjesëmarrësit dhe paraqet alternativa për ta adresuar çështjen përkatëse. Kjo lidhet me një prezantim të shkurtë për përfitimet nga strategjitë e mësimnxënies aktive (20 min.).

Në grupet e përziera me nga 4 pjesëmarrës, pjesëmarrësve u jepet një set i planeve mësimore të vëzhguara gjatë vizitave nëpër shkolla dhe një programi mësimor i zbrazët për përmirësim të planit mësimor.

Secili grup e ka detyrën si më poshtë (40 min):

Për secilën nga rastet studimore të prezantuar:

- Ju lutem, lexojini individualisht përshkrimet dhe provoni t'i identifikoni strategjitë pozitive për gjithëpërfshirje;
- Akordohuni me konsensus me kolegët tuaj në grup për një mënyrë alternative për mësimin përkatës, duke i respektuar parimet e arsimimit gjithëpërfshirës dhe ndërkulturor;
- Shënoni përmirësimet në programin mësimor korrespondent.

Secili përmirësim i planit mësimor ndahet dhe diskutohet me tërë grupin. Trajnerët parashetrojnë pyetje, japin komente dhe nxjerrin në pah ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet propozimeve të ndryshme të formuluar nga grupet për planet e analizuar (30 min.)

Një pyetje për ta adresuar është: Ju lutem, mendoni për mundësitë për ndërveprim shoqëror në parakushte jo edhe aq të favorshme (mungesa e hapësirës, klasa të vogla, mungesa e bankave, mungesa e materialeve, kushtet e këqija materiale, etj.).

Pjesa 2: Përgatitja e paketës së strategjive gjithëpërfshirëse të klasave (1 orë e 30 min.)

Kjo pjesë i ka dy hapa, duke i përfshirë mësimdhënësit/et që të punojnë në grupe të fushave kurrikulare:

- a. Reflektimi në strategjitë e veta të mësimdhënie (30 min.)
- b. Zhvillimi i planeve gjithëpërfshirëse mësimore (1 orë)

Trajnerët fillojnë me shpjegimin se askush nuk është perfekt dhe që ne të gjithë kemi situata ku jemi krenar dhe të lumtur me atë që kemi arritur, dhe poashtu nganjëherë kemi edhe situata, ku e kuptojmë se mund të kishim bërë më mirë. Kemi prirje që të mbajmë në mend më mirë sukseset tona, dhe kjo është shumë e mirë, sepse na nxitë dhe ndihmon që të përmirësohemi më tej, por mund të mësojmë edhe nga reflektimi i situatave, ku sikur ta kishim mundësinë ta kthenim kohën prapa, mesiguri se do t'i bënim gjërat ndryshe. Pjesëmarrësit lutën që të reflektojnë individualisht dhe atëherë t'i ndajnë me anëtarët e grupit dy situata nga praktika e tyre, ose nga praktika e një kolegu nga shkolla e njëjtë.

- Një situatë që, sikur të kthenin kohën, do ta adresonin ndryshe;
- Një situatë, për të cilën ndiheni krenarë, dhe të cilën dëshironi ta përsëritni në të ardhmen;

Trajneri duhet ta bëjë këtë të qartë se:

- Secili grup duhet të vendos që të ndajë në plenar vetëm shkurtimisht një shembull: një sukses ose një reagim të përmirësuar ndaj një situatë në të kaluarën;
- Të gjitha gjëra që ndahen mbahen konfidenciale dhe ajo që ndahet do të dakordohet nga të gjithë anëtarët e grupit dhe prezantohet në atë mënyrë që të identifikojë se për cilin anëtar të grupit bëhet fjalë;
- Të gjithë anëtarët e grupit duhet të japin komente pozitive dhe konstruktive, duke i vlerësuar sukseset e ndara nga kolegët dhe aftësinë e tyre për të reflektuar për përmirësime.
- Në grupet e njëjta, pjesëmarrësit i zgjedhin dy mësimet nga praktika e tyre dhe i planifikojnë në bazë të të gjitha reflektimeve të mbajtura gjatë ditës, në atë mënyrë që të inkurajojë gjithëpërfshirje shoqërore dhe kuptim ndërkulturor në klasë. Pastaj, planet mësimore ndahen dhe diskutohen me tërë grupin. Trajnerët mund të japin referenca për situatat e vëzhguara në praktikë në klasë, në rastet studimore ose në vizitat e ndryshme nëpër shkolla.

22. Partneriteti online si mjet për arsimim ndërkulturor dhe gjithpërfshirje shoqërore

Kohëzgjatja dhe vendosja në [program](#): 1 orë e 30 min, dita2, seanca 1 (paradite).

Objektivat:

- Informimi i tërë ekipit të mësimitdhënësve për partneritetin online, i cili i propozohet shkollës së tyre;
- Vetëdijesimi për përfitimet nga partneriteti online dhe nxitja për mbështetje të partneritetit online;
- Mbështetja gjithëpërfshirëse e partneritetit online në Planin e zhvillimit të shkollës.

Burimet e nevojshme:

- Kompjuterë me qasje në internet, projektor, ekran;
- Power Point prezantimi: Partneriteti online;
- Si alternativë, një laptop për secilin grup, ose letër Flipqar dhe markera.

Përshkrimi i seancës:

Trajneri bënë një prezantim të shkurtë të konceptit të partneritetit online, paraqet shembuj të platformave dhe projekteve të përbashkëta, si dhe elemente të përgjithshme për procesin.

Pjesëmarrësit mund të parashtrojnë pyetje për shpjegime.

Pjesa e mbetur e seancës do të jetë një simulim, në të cilin, një trajner është mësimitdhënës nga Kosova, i përfshirë në një partneritet online, kurse trajneri tjetër është mësimitdhënës i klasës partnere dhe se pjesëmarrës janë nxënësit e përfshirë në partneritetin online me klasën në Kosovë.

Simulimi i vijon 12 hapat e procesit. Informimi do të bëhet në dy nivele:

Si pjesëmarrës:

- Ndjenjat gjatë momenteve të ndryshme në proces;
- Vështirësitë që hasen dhe si të tejkalohen ato;

Si mësimitdhënës:

- Si të motivohen fëmijët?
- Si të promovohen ndërveprimet pozitive dhe gjithëpërfshirja shoqërore?
- Si të sigurohen se fëmijët me të vërtetë mësojnë gjatë procesit?
- Si të parandalohen dhe menaxhohen konfliktet dhe rreziqet?

23. Vlerësimi i aktiviteteve arsimore

Kohëzgjatja dhe vendosja në [program](#): 1 orë e 30 min, dita 2, seanca 2 (paradite).

Objektivat:

- Vetëdijesimi për rëndësinë, por edhe për sfidat e vlerësimit të aktiviteteve arsimore të gjithëpërfshirjes shoqërore;
- Prezantimi dhe diskutimi i shembujve të metodave dhe aktiviteteve, të cilat mund të përdoren për vlerësim formues dhe përmbledhës të aktiviteteve arsimore.

Burimet e nevojshme:

- Materiale të shtypura me aktivitete të sugjeruara të vlerësimit

Përshkrimi i sesionit:

Trajneri zgjedhë dy nga metodat e sugjeruara për t'i aplikuar ato me pjesëmarrësit, për ta vlerësuar seancën e mëparshme për partneritetet online. Kjo bëhet në formë të një ushtrimi simulues.

Aktivitetet pasohen me një diskutim informativ dhe të përgjithshëm që fokusohet në:

- Dallimin ndërmjet vlerësimit formues dhe përmbledhës dhe rolin përkatës në procesin e mësimnxënies dhe aspektet e gjithëpërfshirjes shoqërore;
- Aplikimin e këtyre metodave me fëmijë të moshave të ndryshme dhe shqyrtimin e pengesave që hasen në shkollë (klasat e vogla, kërkesat e kurrikulës, etj.);
- Ndarjen e shembujve të ndryshëm të strategjive dhe metodave të vlerësimit, të aplikuara nga pjesëmarrësit, ose idetë që i sjellin në bazë të shembujve të prezantuar;
- Identifikimin e disa elementeve, të cilat u mundësojnë aktiviteteve të vlerësimit të kontribuojnë në qëllimet e gjithëpërfshirjes shoqërore në një klasë të përzier.

24. Si mundet që një vlerësim me pjesëmarrje participuese të mbështesë zhvillimin e shkollës

Kohëzgjatja dhe vendosja në [program](#): 1 orë e 30 min, dita 2, seanca 3 (pasdite).

Objektivat:

- Paraqitja e elementeve kryesore lidhur me vlerësimin participues, si pjesë e procesit për zhvillim të shkollës;
- Përgatitja e ekipeve për të organizuar dhe udhëhequr një proces të vlerësimit në shkollat e tyre në fund të vitit shkollor.

Burimet e nevojshme:

- Kompjuter, projektor, ekran;
- Fletë pune: Udhëzime për moniorim dhe vlerësim.

Përshkrimi i seancës:

Seanca fillon me prezantim nga trajneri të elementeve kyçe lidhur me vlerësimin dhe përparësitë e një vlerësimi participues për mbështetje dhe fuqizim të ekipit në secilën shkollë. (15 min.)

Në ekipe shkollore, duke i përdorur fletat e punës me pyetje udhëzuese për vlerësim, pjesëmarrësit planifikojnë procesin e vlerësimit në shkollën e tyre. (15 min.)

Ata nxiten që t'i referohen listës së kontrollit të përdorur për vlerësim fillestar, si dhe planeve për zhvillim të shkollave të tyre.

Secili grup paraqet planin dhe merr komente nga homologët dhe trajnerët. (30 min.)

Pas marrjes së komenteve, grupet i rishikojnë planet e tyre (10 min.). Secili grup e ndan shkurtimisht planin e rishikuar për vlerësim (20 min.).

25. Vlerësimi i trajnimit dhe konkluzionet

Kohëzgjatja dhe vendosja në [program](#): 1 orë e 30 min, dita 2, seanca 4 (pasdite).

Objektivat:

- Stimulimi i një reflektimi të procesit të trajnimit dhe lidhjes së tij me praktikën e pjesëmarrësve;
- Prezantimi dhe aplikimi i disa metodave ndërvepruese të vlerësimit, të cilat mund të zbatohen edhe për aktivitetet shkollore;
- Marrja e komenteve nga pjesëmarrësit dhe ngritja e vetëdijesimit të tyre për atë që kanë mësuar.

Burimet e nevojshme:

- Letër Flipqar, markera, letra të vogla ngjitëse me ngjyra;
- Korniza e koncepteve kyçe për mësimdhënje lidhur me diversitetin kulturor.

Përshkrimi i seancës:

Aplikimi i disa metodave ndërvepruese, trajnerët vlerësojnë me pjesëmarrësit seancës e tanishme të trajnimit dhe tërë përvojën në tri pjesët e trajnimit.

Metoda e fundit e aplikuar do të bazohet në Kornizën për kompetenca kyçe për mësimdhënie lidhur me diversitetin sociokulturor të elaboruar nga Këshilli i Evropës.

Informimi për secilin aktivitet do të jetë në tri nivele:

- Procesi (si shkoi, si u ndinë pjesëmarrësit, si i kanë kryer detyrat, etj.)
- Përmbajtja (ajo çfarë doli nga vlerësimi)
- Aplikimi i mëtejme (si mund të adaptohet metoda për përdorim në shkollë)

Trajnerët po ashtu paraqesin shkurtimisht metodat e tjera të prezantuara në materialet, si dhe diskutojnë versione të ndryshme dhe adaptojnë mundësi të këtyre metodave.

Sesioni perfundon me vlerësimin final, bazuar në portofolio individuale dhe në fletat e vlerësimit të shkruara.

Hyrje

Kjo pjesë e materialit është një përmbledhje e burimeve të ndryshme në mbështetje të një shkolle më gjithëpërfshirëse dhe më të efektshme në menaxhimin e diversitetit.


Këtu përfshihen dokumentet bazë për konceptet dhe çështjet kyçe, instrumentet e nevojshme për vlerësimin e situatës në shkollën tuaj dhe për angazhimin me kolegët në procesin e qëndrueshëm dhe demokratik të zhvillimit të shkollës, si edhe sugjerime për veprimtari arsimore, të cilat mund të përdoren me nxënës të moshave të ndryshme.

Këto burime nuk duhet të shihen si receta për t'i riprodhuar, por si burime inspiruese për krijimin e materialeve lokale të adaptuara, bazuar në përvojën edhe në nevojat e identifikuar në shkollë.

Disa nga aktivitetet e prezantuara në këtë material përfshijnë pjesë të trajnimit, deri sa tjerat mund të përdoren si pjesë e detyrave të shtëpisë, të cialt jepen pas çdo pjese të trajnimit.




Një nga metodat e planifikuara për vlerësimin e pjesëmarrësve bazohet në portofolion e pjesëmarrësit, i cili reflekton zbatimin e aktiviteteve në shkollë, bazuar në përmbajtjen e trajnimit. Këto burime janë të shfrytëzueshme pra këto dy qasje.

Procesi i zhvillimit të shkollës



Dalin&Rolf (2000), Rolf (1991)

Shkalla e zhvillimit të shkollës:

3.Shkolla e zgjidhjes së problemeve/ Shkolla e të nxënit:	
 <p>Problem-solving School</p>	<ul style="list-style-type: none">✓ Shkollë e zhvilluar plotësisht dhe që evoluon vetë;✓ Modeli i bashkëpunimit në ekip në të gjitha nivelet;✓ Sqarim sistematik i objektivave;✓ Organizim dhe zbatim i programeve;✓ Zhvillim profesional i personelit dhe vetëkontroll
2. Shkolla e projekteve	
 <p>Project School</p>	<ul style="list-style-type: none">✓ Shkollë me ushtrime novatore në formën e projekteve;✓ Marrëdhënie të mira pune;✓ Punë në grup vetëm brenda projekteve;✓ Nuk ka sistem të bashkërenduar objektivash;✓ Marrëdhënie të jashtme sporadike.
1.Shkolla e fragmentarizuar	
 <p>Fragmented School</p>	<ul style="list-style-type: none">✓ Shkollë normale, me drejtues dhe orë mësimore jo të ndërlidhura mirë;✓ Marrëdhënie të mira pune;✓ Pa bashkëpunim në grup të aktiveve të afërta;✓ Nuk ka objektiv të përcaktuar dhe program të njëtrajtshëm

Dalin/Rolff (1990) + Rolff (1991)

Planifikimi shkollor, për një shkollë gjithpërfshirëse dhe ndërkulturore

Informacion

Planifikimi shkollor për një shkollë ndërkulturore mund të përfshihet në punën për Planin e Zhvillimit të Shkollës, që tanimë është duke u bërë. Çdo komunitet shkollor, në faza të ndryshme do të jetë pjesë e procesit të Planit të Zhvillimit të Shkollës dhe do të ketë konceptime të ndryshme, se cila do të jetë mënyra më e mirë për të pasur një shkollë ndërkulturore dhe gjithpërfshirëse.

Këto dallime do të ndikojnë në mënyrën sesi çdo komunitet shkollor angazhohet në procesin e planifikimit. Mendohet se janë katër faza kryesore, të cilat mund të merren në konsideratë nga shkollat:

- Shqyrtimi/vlerësimi i praktikave aktuale;
- Hartimi i planit për zhvillimin e shkollës;
- Plani i zbatimi;
- Vlerësimi

Këto faza përbëjnë një proces ciklik, i cili vazhdimisht shërben për organizimin e punës së shkollës. Ekzistojnë shumë qasje për planifikimin e zhvillimit të shkollës dhe është e rëndësishme që komuniteti shkollor të zgjedhë atë qasje që i përshtatet situatës së tij specifike. Udhëzimet në vijim mund të japin disa ide mbi mënyrën se si shkolla mund t'i qaset planifikimit shkollor nga një këndvështrim ndërkulturor.

Procesi i planifikimit duhet të ndihmojë të gjithë pjesëtarët e komunitetit shkollor që të krijojnë një shkollë gjithpërfshirëse dhe ndërkulturore, që merret me nevojat e gjithë fëmijëve të saj. Në procesin e planifikimit duhet të përfshihet sa vijon:

- Realizimi i një rishikimi/vlerësimi të shkollës, nga përsoektiva gjithpërfshirëse dhe ndërkulturore;
- Hartimi i një misioni, politike dhe plani të veprimi të shkollës;
- Zbatimi i planit të shkollës;
- Monitorimi dhe vlerësimi i planit të veprimit.

Rishikimi/vlerësimi i shkollës

Si hap i parë në procesin e planifikimit të shkollës, është mirë të kryhet një rishikim i pozicionimit aktual, në raport me të qenit gjithpërfshirëse dhe ndërkulturore. Për këtë qëllim, komuniteti i shkollës mund të angazhohet në një rishikim ndërkulturor të shkollës. Pyetëtori për vetëvlerësimin e shkollës mund të shërbente si një instrument mjaft i dobishëm në realizimin e këtij vlerësimi.

Planifikimi i veprimeve

Shkolla mund të zgjedhë t'iu përgjigjet nevojave për krijimin e një kulture shkollore gjithpërfshirëse, duke nisur me një plan veprimi. Përparësitë e përdorimit të planit të veprimit, si një instrument për qasjen gjithshkollore qëndron në atë se ky mundëson përfshirjen e të gjithë pjesëtarëve të komunitetit shkollor në elemente të ndryshme të procesit, se shkolla

mund të punojë në fusha të ndryshme në të njëjtën kohë, pasi grupe të ndryshme mund të punojnë në detyra të ndryshme, dhe sepse plani mund të përqendrohet mbi realizimin e shpejtë të gjërave. Disa shkolla mund të kenë pasur tashmë planin e tyre të veprimit dhe tani kanë mundësinë të jenë gati për një qasje më të gjerë planifikuese.

Disa prej komponentëve kryesorë të planit të veprimit:

- Definimi i roleve dhe përgjegjësive të pjesëtarëve të ndryshëm të personelit në lidhje me veprimet;
- Përcaktimi i përparësive;
- Identifikimi i burimeve të nevojshme;
- Vendosja e objektivave dhe kriterëve të suksesit;
- Specifikimi i afateve kohore;
- Vendosja e procedurave të monitorimit dhe vlerësimit.

Zbatimi i planit të veprimit

Pas hartimit të planit të veprimit, pjesëtarët e komunitetit të shkollës do të angazhohen në procesin e zbatimit të këtij plani. Identifikimi i roleve, objektivave, kriterëve të suksesit dhe afateve kohore, do ta lehtësojë realizimin praktik të politikave në shkollë. Fushat e përparësisë janë ato që do të trajtohen fillimisht, ndërkohë që kultura e shkollës bëhet gjithnjë e më shumë gjithpërfshirëse. Me përparimin e punës në këto fusha dhe fusha të tjera, përqendrimi shkon në fusha të tjera ndërkulturore. Mund të ndodhë, që gjatë zbatimit të planit, të lindin çështje të reja që kërkojnë vëmendje. Për rrjedhojë, zbatimi duhet të jetë elastik karshi ndryshimit të rrethanave, ndërkohë që i përmbahet misionit dhe politikave, që përfshijnë këndvështrimin ndërkulturor të shkollës.

Monitorimi dhe vlerësimi i realizimit të planit të veprimit të shkollës

Plani i veprimit duhet të përfshijë një procedurë për monitorimin, rishikimin dhe vlerësimin në afate të caktuara kohore. Zbatimi me sukses duhet të kontribuojë për:

- Nxitjen e një ndërgjegjësimi më të madh mbi çështjet ndërkulturore dhe të gjithpërfshirjes sociale;
- Nxitjen e një mjedisi të nxënies mbështetës dhe gjithpërfshirës, që do të inkurajojë zhvillimin e vetëvlerësimit të gjithë fëmijët.
- Largimi i stereotipave dhe përshëndetjen e diversitetit.

Duke qenë se procesi i planifikimit të shkollës është ciklik, ky vlerësim do të përbëjë informacione për një fazë të mëtejshme rishikimi, planifikimit dhe zbatimit.

Instrumente për rishikimin e shkollës

Të dhëna për shkollën tonë

Të dhënat demografike (nxënësit dhe mësimdhënësit/et)

- Sa nxënës janë regjistruar në shkollën tuaj?
- Sa prej tyre janë nxënës romë, ashkali apo egjiptian?
- Sa fëmijë të rikthyer janë në shkollën tuaj?
- Sa nxënës romë, ashkali, egjiptas janë në secilën klasë?
- Sa fëmijë të rikthyer janë në secilën klasë?
- Nëse ka një Qendër mësimore për nxënësit Rom, Ashkali dhe Egjiptas, si e vlerësoni bashkëpunimin ndërmjet qendrës dhe shkollës?
- A ka ndryshuar struktura e nxënësve në vitet e fundit për shkak të emigracionit apo riatdhesimit?
- A ka mësimdhënës në shkollën tuaj me prejardhje tjera etnike?

Pjesëmarrja dhe braktisja

- Sa nxënës të rikthyer apo nxënësit Romë, Ashkali apo egjiptas nuk vijnë me rregull mësimin?
- A e dini përafërsisht numrin e nxënësve të moshës shkollore nga komunitetet Rom, Ashkali apo Egjiptas që nuk shkojnë në shkollë?
- Sa nxënës të rikthyer apo nxënësit Romë, Ashkali apo Egjiptianë kanë braktisur shkollën gjatë 4 viteve të fundit?

Rezultatet në shkollë

- Nota mesatare në nivel shkolle;
- Nota mesatare e nxënësve Romë, Ashkalinj dhe Egjiptianë;
- Sa nxënës Romë, Ashkalinj apo Egjiptianë vazhdojnë shkollimin në nivel të mesëm të lartë?

Përfshirja e prindërve

- Sa prindër të nxënësve Egjiptanë, Romë dhe Ashkalinj zakonisht vijnë në takimet e prindërve?
- Sa shpesh mbani takime me prindërit?
- Sa prindërit të nxënësve Egjiptanë, Romë dhe Ashkalinj janë pjesë e Këshillit të Prindërve?

Gjithpërfshirja sociale

- A mund të jepni disa shembuj pozitiv të ndërveprimit mes të nxënësve shqiptarë dhe serbë në nivel klase, apo gjatë aktiviteteve jashtëshkollore?
- A e keni vërejtur ndonjë tension?
- A takohen nxënësit me nxënësit Egjiptanë, Romë dhe Ashkalinj jashtë shkollës?

Trajnimi i MësimdhënësMësimdhënësve

- Sa mësimdhënës në shkollën tuaj janë trajnuar mbi çështjet që kanë të bëjnë me përmirësimin e arsimit për nxënësit Egjiptanë, Romë dhe Ashkalinj?

Instrumenti për vetëvlerësimin e shkollës - Pyetje orientuese

Dokumentet kyç të shkollës dhe komunikimi i tyre	1	Cilat janë elementet në dokumentet kyçe të politikës së shkollës që përfshijnë fokusimin në ndihmën për secilin nxënës, me qëllim që ky i fundit të arrijë potencialin e plotë të tij/të saj, si dhe në zhvillimin e një koncepti pozitiv për vetveten?
	2	Si reflektohen në dokumentet kyçe të politikës së shkollës parimet e barazisë dhe diversitetit, me perspektivë të qartë përfshirëse dhe ndërkulturore?
	3	Si komunikohen tek publiku idetë e mësipërme, në mënyrë që të jenë të kuptueshme dhe të aksesueshme për të gjithë fëmijët dhe prindërit?
Mjedisi fizik	4	Ku përfaqësohen nëpërmjet fotove, shenjave shumëgjuhëshe, njoftimeve dhe elementeve të tjera, kulturat dhe gjuhët e grupeve etnike të Kosovës dhe shkollës, brenda mjedisit fizik të shkollës?
Mjedisi Social	5	Cilat janë rutinat që praktikohen për pritjen e fëmijëve të rinj, për ndihmën që u jepet atyre që të bëhen pjesë e shkollës, si dhe për të siguruar afirmimin e kulturës së tyre në këtë mjedis?
	6	Cilat janë procedurat që sigurojnë njohjen e mundësive dhe nevojave të fëmijëve të rinj?
	7	Cilat janë rrugët që përdoren për të shpjeguar rutinat dhe pritshmëritë në klasë, në mënyrë të tillë që ato të kuptohen nga të gjithë fëmijët?
	8	Cilat janë procedurat që përdoren për të trajtuar diskriminimin dhe dhunën?
	9	Cilat janë masat që përdoren për të parandaluar dhe trajtuar problemin e braktisjes së shkollës?
	10	Si planifikohen aktivitetet e veçanta në mënyrë që të jenë sa më përfshirëse për të gjitha grupet etnike në shkollë?
	11	Si realizohet njohja e festave dhe ditëve të veçanta të të gjitha kulturave në shkollë?
	12	Si afirmohen pozitivisht në lidhje me identitetin e tyre anëtarët e grupeve të minoriteteve?
	13	Në ç' mënyrë i kushtohet vëmendje sigurimit të gjuhës dhe sjelljes së përshtatshme në ndërveprimet mes mësuesve dhe fëmijëve?
	14	Çfarë mjedisi mbështetës krijohet për nxënësit me njohur të kufizuara të gjuhës në të cilën kryhet mësimdhënia?
Aktivitetet dhe burimet edukative	15	Si pasqyrohet qasja ndërkulturore në praktikën e mësimdhënies në lëndë të ndryshme?
	16	Në çfarë aktivitete bashkëpunuese përfshihen fëmijët me qëllim që të njohin dhe të përfitojnë nga pikat e forta të njëri-tjetrit?
	17	Si e mbështet oferta ekstrakurrikulare ndërveprimin dhe bashkëpunimin pozitiv mes nxënësve?
	18	Çfarë metode përdoret për të vlerësuar përshtatshmërinë e imazheve dhe mesazheve që përmbajnë tekstet shkollore dhe burimet e tjera?
Përfshirja e prindërve	19	Cilat janë masat e parashikuara për të siguruar përfshirjen e prindërve, edhe të atyre nga minoritetet, në aktivitetet e shkollës?
Bashkëpunimi	20	Çfarë masash janë planifikuar për bashkëpunimin me ndërmjetësuesit arsimorë, qendrat more, OJQ-të dhe aktorë të tjerë lokalë?

Planifikimi i shkollës për gjithpërfshirje sociale dhe edukim ndërkulturor

Procesi i punës

Faza 1:

Punë individuale:

- Ju lutemi, lexoni pa zë deklaratat në letra;
- Pyetje lidhur me përmbajtjen;
- Veçoni më tej pesë letrat që ju duken më të rëndësishme;
- Pjesa e mbetur e letrave me deklaratat e tyre mund të jenë alternativa;

Punë në grup:

- Organizohuni në grupe të vogla (5-7 pjesëmarrës);
- Diskutoni zgjedhjet tuaja dhe bini dakord, si grup, për pesë letra gjithsej;
- Radhitni në një fletë (Flipqar), ashtu që dy letrat më të rëndësishme (dy deklaratat më të rëndësishme) të jenë në qendër, ndërsa tri të tjerat mund t'i vendosni diku tjetër (përreth) në fletë.

Seanca plenare:

- Prezantoni posterin e grupit tuaj dhe shënoni (potenconi) dyja pohimet kryesore në tabelë.
- Secili pjesëmarrës do të marrë dy letra ngjitëse dhe do të etiketojë (votojë) pohimet më të rëndësishme që keni zgjedhur.

Faza 2: Inventari

Në grupet e vogla vlerësohen **kushtet e shkollës** duke përdorur tabelën e dhënë më poshtë. Tabela duhet të shfaqet si gazetë muri ose në një projektor – në këtë fazë, në ekran duhet paraqitur vetëm dy kolonat e para.

Pikat ku përqendrohemi/përparësitë:

1.Çfarë bëhet tashmë në shkollat tona:	2. Përvojat që kemi pasur me këtë:	3. Objektivat që duam të arrijmë:	4. Hapat tonë të mëtejshme:	5. Bashkëpunimi i mundshëm me partnerët:
Shkolla...	Partnerë kontakti....			

Faza 3: Prezantimi i vlerësimit

Prezantimi në seancë plenare i rezultateve të punës në grup për kolonën 1 dhe 2 në tabelë.

Faza 4: Rezultate

Pas analizës së kolonës 1 dhe 2, vijohet me plotësimin e kolonave 3, 4 dhe 5, gjegjësisht me formulimin e objektivave, hapave konkret dhe personave bartës për aktivitetet e planifikuara.

Faza 5: Shtysa të mundshme

- Kush bën çfarë, kur dhe me kë?
- Kur do të bëhet raporti për punën në grup (mbledhje biznesi, konferenca të përgjithshme dhe mbrëmje me prindërit)?
- Si do të vazhdohet më tutje dhe çfarë duam të arrijmë?
- Për çfarë përkrahje kemi nevojë (p.sh. trajnim avancues)?

Çështje lidhur me “Gjithpërfshirjen sociale dhe edukimin ndërkulturor në shkollat tona”

Mësimdhënia përputhet me objektivat individuale të të nxënësve	Shkolla jonë do të donte që të gjithë fëmijët të kenë shanse të barabarta hyrëse.	Ne marrim në konsideratë gjendjen e fëmijëve të paprivileguar dhe përpiqemi t'i mbështesim ata.	Ne mbajmë lidhje të rregullta me prindërit.
Personeli mësimdhënës vlerëson dhe respekton aftësitë gjuhësore që fëmijët sjellin në shkollë	Krahasimet gjuhësore kanë një vend të pandryshueshëm në mësimdhënien e shkollës	Elementet e kulturave dhe gjuhëve familjare janë të dukshme dhe të dëgjueshme në shkollë.	Mësimi i gjuhëve të pakicave lidhet ngushtë me mësimdhënien e zakonshme (letërsi, festivale, besim fetar...)
Ne nxisim bashkëpunimin midis fëmijëve me prejardhje të ndryshme etnike.	Shkolla jonë merr pjesë në programet evropiane të partneritetit dhe i shfrytëzon ato për të nxënërit ndërkulturor.	Shkolla është e hapur për rrethin dhe qytetin. Ajo përdor krijimin e rrjeteve me institucione të tjera për zhvillimin e cilësisë.	Përparimi individual gjatë të nxënësve vëzhgohet, dokumentohet dhe merret shumë parasysh si referencë për “normën”.
Për nxënësit “e rinj” me historik migracioni dhe që kanë ende njohuri të kufizuara të gjuhës së mësimdhënies, është ngritur një sistem mbështetës.	Prindërit me historik migracioni do të përfshihen vazhdimisht në çështjet pedagogjike, me shprehjet e tyre ndërkulturore dhe gjuhësore.	Shkolla jonë njihet si vendi i edukimit ndërkulturor.	Orientimi ndërkulturor i shkollës sonë është një vulë cilësie dhe do të bëhet i njohur nëpërmjet punës publike.
Baza e zhvillimit të shkollës sonë është një proces përmirësimi i vazhdueshëm, ku është i përfshirë i gjithë komuniteti i shkollës.	Zhvillimi ndërkulturor i shkollës sonë kërkon formim të mëtejshëm.	Në shkollën tonë ka një dialog të hapur dhe kulturë debati, ku vlerat e përbashkëta janë ato të cilat synojmë e ku lejohen opinionet kritike.	Kontaktet ndërkombëtare mundësojnë shkëmbimin e pikëpamjeve dhe përfaqësojnë themelet e zhvillimit tonë shkollor.
Hapja ndërkulturore nënkupton pikësëpari mendjen e hapur dhe aftësitë kritike në raportin me të tjerët.	Formimi i përvojës ndërkulturore forcon fëmijët/personelin mësimdhënës/prindërit dhe nxit empatinë dhe ndryshimin e këndvështrimeve.	Analiza kritike e rutinës dhe traditave tona, në bashkëpunim me fëmijët dhe prindërit e pakicave etnike dhe shtresave të paprivileguara,	Konsultimi i jashtëm është thelbësor për zhvillimin e shkollës.

		kanë përparësi në shkollën tonë.	
Shkolla është e mirëpozicionuar sa u përket lidhjeve me grupe dhe institucione të tjera ndërkulturore komunale/rajonale.	Në shkollën tonë ka një koncept mbështetjeje gjithëpërfshirëse, që kërkon të rrisë fuqizimin e fëmijëve.	Vëzhgimi dhe mbështetja e zhvillimit të të nxëniet individual të secilit fëmijë është baza e punës sonë pedagogjike.	Ne i konsiderojmë prindërit dhe fëmijët me prejardhje nga pakicat si individë, jo si përfaqësime stereotipike të kulturës së tyre.
Fëmijët e kthyer marrin vëmendje e mbështetje të posaçme.	Ne kemi politika demokratike që janë të njohura për nxënësit, personelin dhe prindërit.	Ne inkurajojmë në mënyrë aktive fëmijët romë, ashkalin dhe egjiptianë.	Gjuha rome mund të flitet në shkollën tonë.
Nuk diskutohet për prindërit me historik migracioni, por me ta.	Është e nevojshme që të gjithë të jenë të aftë për veprim, me qëllim që të merremi me diversitetin.	Shpesh, ne pasurohemi përmes mënyrave të ndryshme të jetesës, kulturave, besimeve fetare dhe gjuhëve.	Të merresh me diversitetin nuk është gjithnjë e lehtë dhe, ndonjë herë çon në konflikte, të cilat duhet t'i parandalojmë.
Larmia gjuhësore dhe kulturore është diçka normale në shkollën tonë.	Ne synojmë t'i trajtojmë konfliktet apo përplasjet e interesave në rrugë jo të dhunshme.	Ne përballemi me orientime të ndryshme kulturore me kureshtje, mendjehapur dhe me mirëkuptim.	Edukimi ndërkulturor është detyrë themelore e shkollës sonë. Ai synon të përfshijë të gjithë fëmijët, prindërit dhe familjet njëgjuhëshe.
Partnerët dhe organizatat jashtë shkollës kontribuojnë për zhvillimin e suksesshëm gjuhësor.	Zhvillimi i suksesshëm gjuhësor kërkon bashkëpunim të ngushtë dhe të orientuar nga objektivat me sistemin parashkollor.	Një proces i qetë kalimi në shkollën pritëse është i rëndësishëm për pasur sukses në shkollë.	Në organizatën tonë, prindërit, përfshi ata me historik migracioni, janë partnerë të rëndësishëm dhe do të përfshihen vazhdimisht.
Konfliktet nuk shtypen, por diskutohen e trajtohen mjaft hapur.	Gjithkush ka paragjykimë, frikëra dhe sjellje të fituara. Ne jemi të vetëdijshëm dhe kritikë ndaj tyre.	Zhvillimi gjuhësor i fëmijëve dygjuhësh është pjesë përbërëse dhe përfshin faza me orientim dhe pa orientim.	Zhvillimi gjuhësor i fëmijëve dygjuhësh kërkon përfshirjen e prindërve.

Principet e gjithpërfshirjes sociale në arsimim

- Arsimi është për të gjithë fëmijët, pavarësisht nga prejardhja e tyre etnike. Duke qenë se bota po bëhet gjithnjë e më shumë e larmishme, na duhet t'i përgatisim fëmijët për këtë aspekt. Edukimi ndërkulturor është një pjesë e rëndësishme e përvojës arsimore të fëmijës, pavarësisht nëse fëmija frekuenton një shkollë që karakterizohet nga diversiteti etnik, apo një shkollë kryesisht monoetnike, apo nëse fëmija vjen nga kultura dominuese, apo e pakicës.
- Përfshirja sociale u takon të gjithë fëmijëve, pavarësisht nga mosha. Njohja e diversitetit, si diçka normale e njerëzore është e përshtatshme për të gjitha moshat. Shumë prej aftësive, qëndrimeve dhe kapaciteteve që do të jenë thelbësore për fëmijën më vonë në jetë, do të fillojnë të ndërtohen që në një moshë të vogël.
- Gjuha dhe kultura identifikohen si komponentë thelbësorë të edukimit ndërkulturor. Edhe pse është me rëndësi që fëmijës t'i jepet informacion i saktë dhe të sfidohen stereotipat dhe idetë e gabuara, zhvillimi i kapacitetit ndërkulturor të fëmijës është më efektiv, në rast se bëhet nëpërmjet komunikimit me fëmijën rreth mendimeve të tij/saj, në vend që thjesht t'i thuhet se cila është "e mira dhe e keqja" e situatës.
- Edukimi vjen natyrshëm nëpërmjet "kurrikulës së fshehtë" të botës sociale e pamore ku jeton fëmija. Edhe pse është e mundur dhe e nevojshme që idetë ndërkulturore të përfshihen në "formatin e programit arsimor" që mësohet, pamjet dhe rrethanat që e rrethojnë fëmijën janë po aq thelbësore. Kur eksplorohet programi mësimor i fshehtë, është me rëndësi të kihet parasysh se ajo çka mundon mund të jetë po aq e rëndësishme sa ajo që është e pranishme.
- Edukimi lidhet me etnicitetin dhe kulturën, jo thjesht me ngjyrën e lëkurës. Edhe pse ngjyra e lëkurës mund të përbëjë shpesh bazë për diskriminim, edukimi duhet të merret po aq edhe me diskriminimin ndaj të gjitha grupeve etnike.

Deklaratat mbi përfshirjen sociale

Edukimi për gjithëpërfshirje sociale synon:

- Nxitjen e kushteve që çojnë në pluralizëm në shoqëri;
- Rritjen e ndërgjegjësimit të fëmijëve për kulturën e tyre dhe pajtimin me faktin se ka mënyra të tjera sjelljeje dhe të tjera sisteme vlerash;
- Krijimin e respektit për mënyra të ndryshme të jetesës, me qëllim që fëmijët të kuptojnë dhe vlerësojnë njëri-tjetri;
- Nxitjen e angazhimit për barazi;
- Dhënien e mundësisë që fëmijët të bëjnë zgjedhje të informuara dhe të ndërmarrin veprime mbi çështjet e paragjykitimit dhe diskriminimit;
- Vlerësimin dhe marrjen në konsideratë të ngjashmërive dhe dallimeve;
- Dhënien e mundësisë për fëmijët që të flasin për veten dhe të shprehen për kulturat dhe historitë e tyre.

Dhjetë udhëzime për gjithpërfshirjen sociale dhe edukimin ndërkulturor

1. Arsimimi është për të gjithë fëmijët;
2. Edukimi ndërkulturor gjendet i ngulitur në dije dhe mirëkuptim, aftësitë dhe kapacitete, qëndrime dhe vlera;
3. Edukimi ndërkulturor dhe gjithpërfshirja sociale janë të integruar në të gjitha lëndët dhe jetën e përgjithshme në shkollë;
4. Edukimi ndërkulturor kërkon përqendrim në botën reale;
5. Gjuha është thelbësore për zhvillimin e kompetencave ndërkulturore;
6. Procesi i gjithpërfshirjes sociale kërkon kohë;
7. Konteksti shkollor është i rëndësishëm për lehtësimin e nxënies dhe integrimi;
8. Shkollat duhet të pasqyrojnë diversitetin e nxënësve të tyre;
9. Të gjithë fëmijët duhet të trajtohen me respekt;
10. Bashkëpunimi midis shollave lokale dhe komunitetit të gjerë mund të zvogëlojë hendeqet midis shkollave dhe prindërve nga pakicat;

Diskutoni kuptimin dhe efektet e këtyre udhëzimeve. Cilat nga ato janë më sfidueset?

Listëkontroll: Çfarë informacioni duhet të merret për një fëmijë të sapoardhur në shkollë?

- Si thirret fëmija nga prindërit dhe shokët?
- Çfarë shprehish gjuhësore ka fëmija dhe cili është niveli i tij/saj në secilën gjuhë (të kuptuarit, komunikimi, shkrimi)?
- Si mund t'i themi disa fraza kyçe në gjuhën e parë të fëmijës, si përsëritje, "të lutem/faleminderit," "bashkohu me ne," "ndal," "e ke bërë mirë/shumë mirë," etj.?
- Cili është besimi fetar i fëmijës, si praktikohet dhe a ka ndikime ai në planifikimin e klasës dhe të shkollës?
- A ka praktika kulturore që mund të ndikojnë në ndërveprimin në klasë? A ka veprime që konsiderohen të papërshtatshme apo të pasjellshme në kulturën e fëmijës, por që nuk shkaktojnë fyerje të anëtarët e grupit etnik mbizotërues apo anasjelltas?
- Cilat elemente të historikut të fëmijës përfaqësojnë vlera të rëndësishme dhe mund të përdoren për të nxënit e mëtejshëm (p.sh., aktivitete jashtëshkollore të kryera në vendin pritës, aftësia për t'i rënë një instrumenti muzikor, vendet që ka vizituar, aftësitë në TIK, etj.)?

Fletë vëzhgimi për mësimdhënësit/et : Vëzhgimi nga afër i fëmijës së sapoardhur

Shkruani një rast studimor për një fëmijë të sapoardhur në mjediset e shkollës suaj. Informacioni duhet të përfshijë:

- Të dhëna mbi historikun e fëmijës për të nxënit dhe përvojat e mëparshme
- Informacion për ato që ka bërë/arritur fëmija dhe ecurinë e tij
- Informacion mbi disa prej pengesave të hasura nga fëmija dhe si ai/ajo po i kapërcen ato
- Këndvështrimin e vetë fëmijës
- Fushat/qasjet e sugjeruara për ndërhyrje të mëtejshme, për të mbështetur integrimin dhe arritjet e fëmijës

Roli i shkollave dhe mësimdhënësve në përsëritjen e pabarazive

1. Shkolla përsërit pabarazitë sociale

Imazhi që shkolla dëshiron të ketë për veten është: një vend barazie që ofron mundësi të barabarta dhe krijon për të gjithë fëmijët mundësi për një jetë të mirë, të bazuar në merita personale.

Në të vërtetë, sikurse del nga statistikat, shpesh shkolla është: një vend ku pabarazitë sociale përsëriten dhe ndonjëherë shtohen, ku fëmijëve nga grupet në pozitë të pafavorshme u ofrohen më pak mundësi se bashkëmoshatarëve të tyre.

Në shumicën e rasteve, mekanizmat e këtij fenomeni janë të vështira për t'u vënë në dukje, por njëkohësisht nuk është e drejtë që t'i vihet faji shkollës për pabarazitë sociale ekzistuese. Gjithsesi, duke promovuar përfshirjen dhe duke u kushtuar vëmendje të posaçme fëmijëve nga familje të pafavorizuara, shkollat mund të kontribuojnë në ofrimin e shanseve më të mira për të gjithë fëmijët.

2. Ndikimi i pavullnetshëm i mësimdhënësve

Disa studime kanë vënë në dukje se, pa dashje dhe pa qenë të vetëdijshëm për këtë, sjellja dhe qëndrimet e mësimdhënësve kanë një ndikim të madh në rezultatet e shkollës, por edhe në mënyrën se si fëmijët dhe të rinjtë e perceptojnë veten dhe jetën e tyre në të ardhmen.

2.1. Shpërndarja e vëmendjes

Një faktor që luan një rol kyç në këtë kontekst është mënyra se si mësimdhënësit/et e shpërndajnë vëmendjen e tyre në drejtim të fëmijëve gjatë procesit të mësimdhënies. Mësimdhënësit/et e pyetur për këtë kanë thënë se u kushtojnë pak a shumë të njëjtën shkallë të vëmendjes të gjithë fëmijëve, por analiza e mikro-sjelljes së tyre gjatë mësimdhënies në procesin e mësimdhënies tregon të kundërtën: të dhënat e studimit tregojnë se mësimdhënësit/et janë të prirë t'u kushtojnë më shumë vëmendje (kontakte me sy, bashkëbisedim, përdorimi i emrave, bërja e pyetjeve, etj.) atyre fëmijëve që ata i konsiderojnë se janë "nxënës të mirë". Nga ana tjetër, fëmijëve që konsiderohen se nuk i bëjnë mirë detyrat e tyre, u kushtojnë më pak vëmendje.

Fëmijëve që u kushtohet vëmendje, inkurajohen dhe stimulohen që t'i bëjnë mirë detyrat e tyre, duke i mbështetur në këtë mënyrë të kenë rezultate të mira (rreth virtuoze), ndërsa fëmijët që nuk u kushtohet vëmendje nga mësimdhënësit/et, shpesh fillojnë dhe mendojnë për veten se nuk janë të rëndësishëm, se janë inferiorë, dhe krijojnë një vlerësim të ulët për veten (rreth i keq).

2.2. Pritshmëritë ndikojnë te arritjet: efekti Pigmalion dhe Golem

Pritshmëria rreth arritjeve është një faktor tjetër i rëndësishëm që ndikon në rezultatet e shkollës. Fëmijët për të cilët Mësimdhënësit/et tregojnë pritshmëri për rezultate të mira, i bëjnë më mirë detyrat e tyre krahasuar me fëmijët në të njëjtat rrethana, por të cilëve Mësimdhënësit/et u tregojnë se presin rezultate më të ulëta.

Efekti Pigmalion: pritshmëria e lartë shpie në rezultate më të mira (studimi tregon se nëse Mësimdhënësit/et do të mësoheshin të prisnin rezultate më të mira nga fëmijët, atëherë, rezultatet e tyre do të ishin më të mira).

Efekti Golem: pritshmëri më të pakta shpjen në rezultate më të dobëta nga një individ.

2.3. Pasoja e kategorizimit dhe etiketimit

Ndonjëherë Mësimdhënësit/et i ndajnë nxënësit në grupe, bazuar në ecurinë e tyre. Ata e bëjnë këtë me qëllime të mira, për të qenë në gjendje t'u përgjigjen më mirë nevojave të nxënësve: nxënësit e grupit me rezultate të larta, mund të përparojnë më shpejt dhe të futen më thellë në lëndën përkatëse dhe nuk kanë përse të presin për të tjerët, ndërsa ata që kanë ecuri më të dobët, mund të marrin aktivitete mësimore në nivelin e tyre dhe mbështetje shtesë për të ecur përpara. Megjithatë, kjo strategji pedagogjike ka pasoja të padëshirueshme negative të fëmijët e etiketuar si nxënës me rezultate të dobëta. Në vend që të mobilizojë përpjekjet e tyre për të kapur dhe arritur nivelin e bashkëmoshatarëve të tyre me rezultate më të mira, shpesh ata kanë tendencën ta bëjnë të tyre idenë se nuk janë të zotët të arrijnë rezultate të mira dhe kështu demotivohen.

2.4. Kërcënimi i stereotipisë

Studimi ka treguar se njerëzit që i përkasin një grupi me stereotipa negativë, sidomos në një situatë vlerësimi, bëhen të ankthshëm në lidhje me ecurinë e tyre dhe ndihen të rrezikuar se mos konfirmojnë stereotipat që ekzistojnë në lidhje me grupin e tyre social. Për shembull, nëse stereotipi i një grupi të pakicës përfshin përfytyrimin se ata kanë rezultate më të dobëta në shkollë se sa fëmijët e shumicës, atëherë, nëse fëmijëve të pakicës në një provim u kujtohet se i përkasin atij grupi, në gjë e tillë do të rezultonte në rezultate më të dobëta.

2.5. Çfarë mund të bëhet?

- Mësimdhënësit/et duhet të bëhen të vetëdijshëm për risqet e pasojave të padëshiruara të sjelljeve dhe qëndrimeve të tyre.
- Mësimdhënësit/et duhet të shmangin:
 - ✓ Shpërndarjen e pabarabartë të vëmendjes midis fëmijëve;
 - ✓ Transmetimin e pritshmërive të ulta, kategorizimin dhe etiketimin e fëmijëve si fëmijë me rezultate të dobëta;
 - ✓ Theksimin e përkatësisë së grupit të fëmijët e pakicës në një situatë provimi.
- Mësimdhënësit/et mund të kenë një ndikim pozitiv në zhvillimin dhe ecurinë në shkollë të fëmijëve që u përkasin pakicave në pozita të pafavorshme duke:
 - ✓ Treguar vëmendje të veçantë për fëmijët me vetëvlerësim të ulët
 - ✓ Krijuar situata në të cilat cilësitë (e vërteta) të fëmijëve të pakicave të njihen publikisht dhe në të cilat ata të ndihen të vlerësuar dhe të çmuar

- ✓ Transmetuar pritshmëri të larta dhe duke besuar në kapacitetin e të gjithë fëmijëve për t'ia dalë mbanë edhe kur ata dështojnë ua bën të qartë se me përpjekje dhe mbështetjen e duhur, mund t'ia dalin në krye
- ✓ Përdorur metoda me anë të të cilave fëmijët me aftësi, zotësi dhe preferenca të ndryshme të punojnë së bashku dhe të mësojnë nga njeri tjetri
- ✓ Theksuar ngjashmëritë dhe potencialin e të gjithë fëmijëve për të marrë rezultate të mira në kushte provimi.

Racizmi dhe “magjupizmi” si target për racizëm dhe diskriminimi

Askush nuk është racist, por racizmi ekziston

Në përgjithësi, njerëzit janë të prirë të pëlqejnë dhe trajtojnë në mënyrë më të favorshme ata që i përkasin të njëjtit grup me ta dhe të mos pëlqejnë dhe të trajtojnë në mënyrë më pak të favorshme ata që u përkasin grupeve të tjerë.

Qasja klasike e kupton racizmin si besimin se një racë apo grup etnik i caktuar është superior ose inferior ndaj një tjetri, se tiparet sociale dhe morale të një personi janë të paracaktuara nga karakteristikat e tij apo të saj të lindura biologjike.

Normat e përgjithshme të shoqërisë, të bazuara në njohjen e barazisë së të drejtave dhe potencialit të të gjithë qenieve njerëzore, e hedhin poshtë këtë lloj racizmi të hapur.

Gjithsesi, studimet e bëra gjatë disa dekadave të fundit tregojnë se ka forma të tjera racizmi që manifestohen në mënyra më të padukshme, edhe në shoqëritë demokratike.

Këto forma të padukshme të racizmit shfaqen te njerëzit që e hedhin poshtë racizmin e llojit të vjetër dhe që besojnë në parimet e barazisë, por që vazhdojnë ende të shprehin paragjykime në mënyrë të tërthortë, përmes:

- Kundërshtimit të politikave që ndihmojnë pakicat në pozita të pafavorshme;
- Mendimit se pakicat në pozitë të pafavorshme kanë kërkesa të padrejta ose marrin tepër shumë burime;
- Mospëlqimet personale ndaj njerëzve që u përkasin pakicave dhe shmangieve të kontakteve të drejtpërdrejta me anëtarët e grupeve të pakicave, objekt i racizmit.

Racizmi ndaj “Magjupëve”

Në gjuhë të ndryshme ka fjalë që përshkruajnë Romët, Ashkalijët dhe Egjiptjanët si dhe grupet e ngjashme me ta (grupe të cilat, pavarësisht nga dallimet midis tyre, shihen të lidhur me tipare të ngjashme stereotipie) në mënyrë përçmuese. Fjalë e tillë përfshin “gjipsi”, “cigan”, “zingaro”, “zigeuner” dhe, në kontekstin e Kosovës, “magjup”. Paragjykimet e forta negative kundër këtyre grupeve kanë rrënjë të thella në shoqëritë evropiane qysh nga fillimi i Mesjetës. Ky lloj specifik, i fortë dhe shumë dëmtues racizmi është vënë në dukje nga studimi në mbarë Evropën dhe është dënuar në dokumente të ndryshme të shtjelluara me hollësi nga Këshilli i Evropës dhe institucionet e Bashkimit Evropian.

Për shembull, dokumenti i Këshillit të Evropës thotë se “anti-gjipsizmi/anti-tsiganisme është një formë specifike racizmi, një ideologji e ngritur mbi superioritetin racor, një formë dehumanizimi dhe racizmi institucional, i ushqyer nga diskriminimi historik, i cili shprehet, ndër të tjera, me dhunë, gjuhë urrejtjeje, shfrytëzim, stigmatizim, dhe me formën më të dukshme të diskriminimitë [...]Anti-gjipsizmi është një formë racizmi veçanërisht këmbëngulëse, e dhunshme, e përsëritur dhe e zakonshme” dhe për ta luftuar atë nevojiten të ndërmerren

veprime. Këshilli i Evropës gjithashtu përmend se synimi i këtij lloj racizmi janë “jo vetëm Romët, por edhe Sinti, Kali, Ashkali, Egjiptianë, Manouche” dhe grupe të tjera.

Materiale në gjuhë të ndryshme, duke përfshirë dokumente, materiale në video, filma vizatimorë, etj., për këtë temë gjenden në www.dosta.org, uebsajti i një fushate të Këshillit të Evropës.

Diskriminimi i drejtpërdrejtë, i tërthortë dhe i strukturuar

Diskriminim i drejtpërdrejtë do të thotë të trajtosh dikë në mënyrë të pafavorshme për shkak se i përket një grupi të caktuar. Diskriminimi i drejtpërdrejtë etnik ndodh kur anëtarët e një grupi etnik specifik trajtohen më keq se grupet e tjera, ose u ndalohe apo kufizohet mundësia për të përfituar ato që gëzojnë edhe grupet e tjera.

Diskriminimi i tërthortë u referohet masave, politikave, rregullave, etj, që duhet të zbatohen në të njëjtën mënyrë për të gjithë njerëzit, por që janë formuluar në mënyrë të tillë që vënë në pozitë të pabarabartë anëtarët e grupeve specifike. Për shembull, po t’u kërkohet nxënësve të bëjnë detyrat e shtëpisë në kompjuter, nxënësit që nuk kanë mundësi të përdorin kompjuter, do të vihen kështu në pozitë të pafavorshme.

Një lloj i tretë diskriminimi është diskriminimi strukturor, që ndonjëherë përmendet si diskriminim sistematik. Ai përfshin një grup kompleks rregullash dhe praktikash, të cilat i vënë në pozitë të pafavorshme grupet më pak të fuqizuara, duke shërbyer njëkohësisht për të favorizuar grupet sunduese. Pra, ka modele ndërveprimi midis grupeve në shoqëri, shpesh të vështira për t’i vënë në dukje, të cilat prodhojnë ose ruajnë përjashtimin ose një status inferior në shoqëri të grupeve të caktuara në lidhje me të tjerët.

Politikat, rregullat dhe praktikat shkollore duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të ndalojnë dhe parandalojnë diskriminimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë dhe të kontribuojnë në pakësimin e diskriminimit strukturor.

Të mësuarit e bazuar në projekte

Korniza e Re Kurrikulare për Arsimin Parauniversitar në Kosovë fokusohet në zhvillimin e kompetencave dhe bazohet në disa parime, të tilla si nxitja e gjithëpërfshirjes, mësimdhënia dhe mësimnxënia e integruar dhe koherente dhe qasja me të nxënësit në qendër. Puna me projekte, ose të mësuarit përmes projekteve, përmendet si një nga metodat e rekomanduara të mësimdhënies dhe theksohet se është e vetmja metodë, e cila, në të njëjtën kohë kontribuon në përfundimin e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve. Gjithashtu, ajo është mjaft e përshtatshme për një qasje ndër-programore dhe për trajtimin e çështjeve të ndërthurura të përcaktuara në Kornizën Kurrikulare.

Të mësuarit e bazuar në projekte, zakonisht strukturoret në bazë të një sekuencë hapash, të shpërndara në disa javë:

1. Zgjedhja e një teme studimi, ose e një pyetjeje të hapur dhe planifikim i punës;
2. Mbledhja e informacionit, organizimi i informacionit të mbledhur dhe marrja e vendimeve;
3. Realizimi i një produkti;
4. Prezantimi i produktit;
5. Reflektimi për përvojën e të mësuarit.

Këto hapa mund të ndërmerren nga nxënësit në bazë individuale, por procesi është shumë më efikas në rast se nxënësit punojnë bashkë, si klasë ose në grupe të vogla. Në këtë rast, pavarësisht nga tema e zgjedhur, dhe përveç marrjes së njohurive dhe aftësive për temën përkatëse, nxënësit do të zhvillojnë:

- Aftësi intelektuale dhe kritike të të menduarit (të lidhura me të kuptuarit, përpunimin dhe organizimin e informacionit);
- Aftësi bashkëpunimi;
- Aftësi komunikimi (verbal, me shkrim, të folur në publik, etj.)

Në shumë raste, procesi zgjeron shprehjen artistike, aftësitë e përdorimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit dhe zotësinë gjuhësore.

Roli i mësimdhënësit/es në një proces të të nxënësit në bazë projekti është shumë i ndryshëm nga roli i një mësimdhënësi në metodat e të mësuarit tradicional. Mësimdhënësi nuk është ai që ka një mori njohurish, të cilat duhet t'i përçojë te nxënësit, por është një lehtësues i procesit të të mësuarit. Nxënësit ndjekin udhëzimet e dhëna nga mësimdhënësi për hapat që duhen ndërmarrë, por në lidhje me përmbajtjen, vendimet duhet të merren kryesisht nga nxënësit. Instrumenti kryesor i mësimdhënësit/es është pyetja, jo përgjigja. Mësimdhënësi duhet t'i stimulojë nxënësit të bashkëpunojnë, të mbështetin njëri tjetrin, t'i shprehin njëri tjetrit mendime dhe të reflektojnë për atë që duhet të zbulojnë, si edhe për ndërveprimet e tyre.

Mënyra se si do të zbatohen shembujt më poshtë mund të ndryshojë në varësi të nivelit të moshës dhe preferencave të studentëve, si edhe nga konteksti lokal.

Shembulli 1: Uji

1.Tema: përcaktoni këndvështrimet e ndryshme që mund të ketë për ujin dhe planifikoni hapat e mposhtëm

Shembuj:

- Uji siç e sheh shkenca (kimia, fizika, matematika, gjeografia, etj.);
- Uji në literaturë dhe histori ;
- Mundësia për të pasur ujë të pastër si një e drejtë e njeriut.

2.Mbledhja dhe organizimi i informacionit:

- Me grupe, nxënësit kanë mundësi të shfrytëzojnë burime të ndryshme informacioni (libra, internet, ekspertë lokalë, shërbime të furnizimit me ujë, etj.);
- Së bashku, nxënësit zgjedhin dhe kategorizojnë informacionin e mbledhur.

3.Realizimi i një produkti: një ekspozitë në shkollë, ose në një vend publik në komunitet me rastin e Ditës Botërore të Ujit (detyra që u jepen fëmijëve bazuar në aftësitë dhe preferencat e tyre).

4. Paraqitja e produktit: organizohet një ngjarje për ta hapur dhe bërë publike ekspozitën Reflektim për përvojën e të mësuarit: kur kthehen në klasë, nxënësit reflektojnë së bashku për të gjithë procesin dhe për atë që ata kanë mësuar në situata të ndryshme, për njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet që kanë zhvilluar.

Shembulli 2: Trajtimi i një çështje të komunitetit lokal

1.Tema: Bisedë me të rritur, diskutime midis studentëve dhe analizë e medias për të identifikuar një çështje të komunitetit lokal që duhet diskutuar.

2.Mbledhja dhe organizimi i informacionit:

- Me grupe, nxënësit kanë mundësi të sigurojnë burime të ndryshme informacioni (anëtarët e komunitetit lokal që preken nga çështja, institucionet vendore, libra, internet, ekspertë vendorë, organizata të shoqërisë civile, etj.).
- Së bashku, nxënësit zgjedhin dhe kategorizojnë informacionin e mbledhur dhe bien dakord për zgjidhjen që sugjerojnë për çështjen përkatëse.

3. Realizimi i një produkti: Krijimi i një portofoli dhe një paraqitje elektronike me strukturën e mëposhtme:

- Përshkrimi i çështjes, përse është e rëndësishme, kush preket prej saj, kush është përgjegjës;
- Analizë e 2-3 zgjidhjeve të mundshme;
- Përshkrimi i zgjidhjes së propozuar nga klasa ;
- Plan avokues për mënyrën se si të ndikohen autoritetet përgjegjëse për të përqafuar zgjidhjen e propozuar nga klasa.

4. Paraqitja e produktit: Një paraqitje publike e organizuar nga nxënësit me të ftuar të rritur për të paraqitur propozimin e tyre.

5. Reflektim për përvojën e të nxënit: Pasi kthehen në klasë, nxënësit reflektojnë së bashku rreth të gjithë procesit dhe për atë që kanë mësuar në situata të ndryshme, për njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet që kanë zhvilluar.

Strategjitë e zhvillimit të shkollës për gjithpërfshirjen sociale

Koha që investohet në hartimin e strategjive të mira për përfshirjen sociale është, pothuajse gjithmonë, kohë e shpenzuar mirë, pasi shërben për parashikimin dhe parandalimin e problemeve të mëvonshme. Shkollat duhet të mbajnë parasysh këto strategji premtuese për përfshirjen sociale:

- Sigurohet informimi i të gjithë stafit përkatës për ardhjen e një nxënës të ri;
- Sigurohet intervestimi i çdo fëmije, me qëllim që të vlerësohen përvojat e mëparshme shkollore dhe ato të ardhshme, regjistrimi me saktësi i këtij, si dhe paraqitja e tij pranë të gjithë stafit mësimdhënës dhe atij mbështetës;
- Sigurohet vizita njohëse në shkollë për prindërit/kujdestarët dhe diskutimi i praktikave të shkollës me ta;
- Sigurohet, sa herë që është e mundur, prania e një përkthyesi apo vendosja në një klasë dygjuhëshe në momentin kur fëmija fillon shkollën;
- Ofrohet trajnim dhe informacion për të gjithë stafin e përfshirë të shkollës në lidhje me formimin dhe historikun e fëmijëve;
- Sigurohet rivlerësimi i progresit të nxënësit pas një periudhe të caktuar, për shembull, pas një gjysëm semestri, si dhe ekzistenca e procedurave të përcaktuara për monitorimin;
- Sigurohet mundësia për mbështetje nëpërmjet mentorimit për nxënësit që nuk po e përballojnë mirëprocesin;
- Sigurohet përkthimi i informacionit esencial dhe klasat dygjuhëshe;
- Sigurohet prania e asistentëve ose përkthyesve gjatë intervistave për pranimin në shkollë, vlerësimeve, takimeve dhe mbrëmjeve me prindërit;
- Organizimi i aktiviteteve sociale, si për shembull, kafe e mëngjesit për prindërit/kujdestarët që janë të rinj në lokalitet (kafenetë e prindërve);
- Ftohen prindërit/kujdestarët që të ndihmojnë në aktivitetet e shkollës - shumë prej tyre kanë aftësi të cilat mund të përdoren në mënyrë të dobishme në shkollë;
- Rekrutimi i stafit, si për shembull i **ndërmjetësuesve romë**, ose i mësimdhënësve nga komunitetet e pakicës. Ky lloj stafi ndërkulturor mund të ndahet mes shkollave që janë pranë njëra-tjetrës dhe që kanë vetëm pak nxënës azilkërkues ose refugjatë;
- Të gjitha shkollat duhet të kenë një anëtar të stafit të tyre të ngarkuar me përgjegjësinë mbrojtjes së fëmijëve në përgjithësi. Është thelbësore që ata të jenë të vetëdijshëm për nevojat e fëmijëve nga minoritetet.
- Meqenëse shumë familje të riatdhesuara përballen me nevoja të shumëfishta sociale, shkollat duhet të krijojnë lidhje të mira me organizatat në komunitet dhe agjensi të tjera.

Riadheshimi në Kosovë – disa përkufizime dhe fakte

Terminologjia: riadheshimi vullnetar përkundrejt kthimit të detyruar

Termi “kthim i detyruar” përdoret për të përshkruar “kthimin e personave, që nuk kanë dhënë pëlqimin e tyre dhe që mund t’i nënshtrohen përdorimit të forcës gjatë kthimit”.

Termi “kthim vullnetar” përdoret për të përshkruar kthimin e refugjatëve dhe personave të cilët kanë një leje të përkohshme apo të përhershme qëndrimi dhe, që pas shqyrtimit të të gjithë informacionit të disponueshëm mbi kushtet në vendin e tyre të origjinës, vendosin të largohen nga vendi pritës dhe të kthehen në shtëpi.

Nocioni “kthim vullnetar”, megjithatë, është paksa çorientues. Ndërkohë që ka persona që duan vërtet të kthehen, shumica e kthimeve vullnetare nuk janë “vullnetare” në kuptimin e mirëfilltë të kësaj fjale, pra të “veprimit sipas vullnetit të lirë”. Në shumicën e rasteve, familjet përballen me zgjedhjen e kthimit “vullnetar” (me premtimin e një asistence riintegruese), ose të presin që të kapen nga forcat e policisë në mes të natës, t’u jepet një orë kohë për të paketuar sendet e tyre, të hipen në një avion dhe të dëbohen me forcë.

Familjet apo individët e riadheshuar janë kthyer në Kosovë nga vendet e tjera me forcë ose në mënyrë vullnetare.

Romët, Ashkalinët dhe Egjiptianët në Kosovë dhe jashtë saj

Mes komuniteteve të ndryshme të Kosovës, romët, ashkalinjet dhe egjiptianët janë grupet më të cënueshme dhe më të përjashtuara, që vuajnë disavantazhe të ndryshme, krahasuar me grupet e tjera etnike në Kosovë. Numri i anëtarëve të këtyre komuniteteve që jetojnë në Kosovë vlerësohet të jetë rreth 35.000.

70.000 deri 100.000 romë, ashkalinj dhe egjiptianë jetojnë jashtë vendit, pas largimit nga vendi në fillim të viteve '90 ose për shkak të konfliktit të armatosur në 1999. Shumica e refugjatëve janë larguar drejt Gjermanisë, ku numri i azilkërkuesve të regjistruar dhe të refuzuar është 35.000; numri i refugjatëve të regjistruar në vende të tjera të Evropës Perëndimore arrin në 15.000-20.000 persona.

Raste studimore të fëmijëve dhe familjeve të kthyer

Familja Mujolli

Familja e Florim dhe Feride Mujollit nga Fushë-Kosova është riatdhesuar me forcë në Kosovë, pasi kishin jetuar për rreth 20 vite në Gjermani. Ata kanë gjashtë fëmijë: më i madhi është 18 vjeç, ndërsa më i vogli 2 vjç. Familja Mujolli kishte një jetë normale në Gjermani, dhe respektonte ligjet e këtij vendi; ata ishin të punësuar dhe fëmijët e tyre ndiqnin shkolla gjermane.

Jeta e tyre rridhte normalisht deri më 17 mars 2010, kur policia gjermane hyri në shtëpinë e tyre në orën 6:00 të mëngjesit dhe u kërkoi të largoheshin menjëherë. Sipas vajzës së madhe, Hamidesë, policia i futi forcërisht nëpër makina, teksa ata ishin ende të veshur me pizhama. E gjitha kjo ndodhi kur Florimi ishte në punë. Pas tri javësh ai vendosi të kthehej vullnetarisht dhe të bashkohej me familjen e tij në Kosovë.

Para se të migronte në Gjermani, familja Mujolli kishte jetuar në fshatin Maxhunaj të Vushtrrisë, ku kishin pasur në pronësi tokë dhe banesa, por tashmë prona e tyre ishte shkatërruar. Familja Mujolli ishte e detyruar të merrte me qera një banesë në Fushë-Kosovë, në një kohë që nuk kishin as të ardhura, as mundësi punësimi. Për më tepër, familja Mujolli nuk mund t'i regjistrojë fëmijët në Kosovë për shkak se u mungon dokumentacioni i duhur: fëmijët e tyre kanë lindur në Gjermani. Për këtë arsye asnjë prej fëmijëve nuk ndjek shkollën në Kosovë.

Intervistë e kryer nga RADC më 21 shtator 2010, Fushë Kosovë

Familja Berisha

Pasi kishin jetuar për afro njëzet vjet në Gjermani, familja Berisha u riatdhesua me forcë në Kosovë në dhjetor 2009. Që prej asaj kohe, për shkak të mungesës së dokumentacionit shkollor, pesë nga fëmijët e tyre nuk mund të ndjekin shkollat publike në Kosovë. Fëmijët, gjithashtu, përballen me vështirësi gjuhësore pasi ata kanë lindur dhe janë rritur në një mjedis gjermanishtfolës. Shumë familjetë riatdhesuara ankohen për mungesë dokumentesh, të cilat nuk kanë pasur mundësi t'i marrin në Gjermani para një riatdhesimi të padëshiruar apo të papritur.

Raste studimore të mbledhura nga mësime të ndërmjetshme/et

Fëmija 1 është një djalë dhjetëvjeçar, ashkali, që konsiderohej tepër i madh për moshën. Ai kishte ndjekur shkollën që në moshën pesëvjeçare, megjithëse frekuentimi kishte qenë me hope, veçanërisht gjatë vitit të fundit. Nuk ka dëshirë të përfshihet në shumë prej aspekteve të jetës në shkollë, veçanërisht në ato që kanë të bëjnë me leximin dhe shkrimin. Duket si i izoluar nga shoqëria në klasë dhe ka pak shokë. Shpesh prish orët e mësimit dhe shpërqëndron fëmijët e tjerë që punojnë në të njëjtën tavolinë me të. Njihet si fëmijë që shfaq agresivitet verbal ndaj stafit dhe nxënësve të tjerë, ndonëse forcën e përdor rrallëherë.

Fëmija 2 është një pesëvjeçar rom, i sapoardhur në shkollë. Ai po shkakton shqetësim për shkak të asaj që duket si paaftësi për t'u përqendruar dhe fokusuar në çfarëdo lloj detyre. Ai ndërpret shpesh aktivitetet në orën e mësimit, nuk reagon ndaj udhëzimeve dhe shpesh akuzohet nga nxënësit e tjerë se i ka rrahur. Niveli i njohjes së gjuhës në të cilën kryhet mësime është i kufizuar. Pavarësisht dy përpjekjeve të ndërmarra, prindërit e fëmijës nuk u janë përgjigjur kërkesave të shkollës për takim.

Fëmija 3 është një djalë ashkali, nëntëvjeçar, i cili është kthyer nga Gjermania, së bashku me familjen e tij. Ai ka tre muaj në shkollë. Deri në këtë moment ai nuk duket se ka bërë ndonjë shok dhe është shumë i heshtur në mësime. Rrallëherë reagon ndaj udhëzimeve dhe e kalon shumicën e kohës duke vizatuar apo ëndërruar. Nuk ka dëshirë të flasë për përvojat e mëparshme apo për jetën e tij, megjithëse në një rast shkolla ka sjellë edhe një përkthyes.

Fëmija 4 është një tetëvjeçar rom, e cila shfaq një sjellje që synon të tërheqë vëmendje, duke ndërprerë shpesh orët e mësimit dhe duke kërkuar vëmendje individuale. Ajo duket se është e integruar mirë në klasë dhe ka rreth të gjerë shokësh. Megjithatë, duket sikur parapëlqen shoqërinë e të rriturve, pasi nuk dëshiron të qëndrojë larg mësime të ndërmjetshme/et .

Fëmija 5 është një tetëvjeçar rom, që është në një fazë të parë të mësimit të gjuhës së mësime të ndërmjetshme, megjithëse ka dy vjet në shkollë. Ndonëse ka mësuar shpejt gjuhën sociale dhe është i integruar mirë në fushën e lojës, ai shfaqet më hezitues kur vjen puna tek përpjekjet për të vënë në përdorim aftësitë e reja gjuhësore në kontekstin e klasës. Shpesh preferon të punojë në gjuhën e tij me folësin tjetër në klasë. Kohët e fundit, gjithnjë e më shumë gjen justifikime dhe shprehet se nuk ka interes të mësojë gjuhën e shkollës apo që të dalë mirë në shkollë.

Fëmija 6 është një vajzë tetëvjeçare rom, e cila ka ardhur në shkollë dy vjet më parë. Frekuentimi i saj është përgjithësisht shumë i mirë dhe të dy prindërit vijnë rregullisht në takimet në shkollë dhe flasin me mësime të ndërmjetshme të saj. Ndërkohë që sjellja e saj në klasë është përgjithësisht e mirë, vajza ka shpesh probleme gjatë pushimeve mes orëve apo në pushimin e drekës, dhe kjo lidhet kryesisht me një grup të vogël prej tri vajzash jorome. Këto probleme mund të çojnë në shpërthime agresive dhe ndikojnë tek situata në klasë.

Përfshirja sociale dhe arsimimi i fëmijëve të riatdhesuar

Integrimi i të rinjve dhe fëmijëve të riatdhesuar romë, ashkali dhe egjiptianë në sistemin e përgjithshëm arsimor mbetet një prej vështirësive më të mëdhapër arsimin publik në Kosovë. Në një raport të fundit të UNICEF-it shkruhet se “megjithëse shumica e fëmijëve kanë ndjekur rregullisht shkollën në Gjermani, pas kthimit në Kosovë, tri të katërtat e tyre e braktisin shkollën, kryesisht për shkak të varfërisë, pengesave gjuhësore dhe mungesës së vërtetimeve nga shkollat në Gjermani. Në këto kushte të vështira të situatës për arsimimin e tyre, ekziston rreziku që shumë prej fëmijëve dhe të rinjve të deportuar të përpiqen të kthehen në vendin e tyre pritës, duke përdorur rrjetet e krimit të organizuar, ku e vetmja perspektivë që i pret është statusi i “të paligjshmit”.

Gjatë procesit të riatdhesimit të detyruar, anëtarët e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë janë të ekspozuar ndaj shkeljeve të ndryshme të të drejtave të njeriut, ku përfshihet presioni psikologjik për t’u larguar nga vendi pritës, njoftimi i shkurtër paraprak për largimin nga vendi, sjellja që tregon mungesë respekti nga ana e policisë, mbështetja dhe asistenca e pamjaftueshme pas kthimit në Kosovë. Për shembull, në Gjermani, familjet romë, ashkali dhe egjiptiane përjetojnë probleme edhe para riatdhesimit të detyruar, ku përfshihen vështirësitë për të marrë ndihmë sociale, për të përfituar nga shërbimet shëndetësore, për të ndjekur shkollat dhe për të gjetur punë.

Ashtu siç thuhet edhe në raportin e UNICEF-it, “interesi më i mirë i [këtyre] fëmijëve, derimëtimi, nuk është konsideruar si prioritet, pavarësisht faktit se [...] thujse dy të tretat [e tyre] kanë lindur dhe janë rritur në Gjermani”. Megjithëse shumica e fëmijëve të riatdhesuar mbërrijnë në Kosovë me njërin ose të dy prindërit e tyre, për disa nuk është kështu. Ata mund të vijnë me miq apo të afërmosë si fëmijë të pashoqëruar dhe merren në përkujdesje nga institucionet e kujdestarisë.

Pas kthimit në Kosovë, të kthyerit me forcë nga komunitetet romë, ashkali dhe egjiptiane përballen me një fazë të re vështirësish, si pasojë e mungesës së hapësirave dhe burimeve, ndërkohë që kthimi i vazhdueshëm i refugjatëve romë, ashkali dhe egjiptianë rrit numrin e personave në varësi të skemës së ndihmës sociale, e cila që tani është shumë e lartë në komunitetet romë, ashkali dhe egjiptiane të Kosovës.

Në lidhje me këtë, mund të hamendësohet se afërsisht 50,000 refugjatë të konsideruar si të riatdhesuar, do të përfshihen në skemën e ndihmës sociale, me një mbështetje mujore 35€ dhe 65€ për familje, pavarësisht nga numri i fëmijëve. Pranohet gjerësisht se një familje, qoftë kjo edhe në Kosovë, nuk mund të jetojë me të ardhura kaq të ulëta. Këto rrethana të vështira i shtojnë të kthyerit romë, egjiptianë dhe ashkali dhe komunitetet e tyre drejt një rrethi vicioz varfërie dhe marginalizimi të mëtejshëm, ndërkohë që grupet e disavantazuara, si për shembull gratë dhe fëmijët, e gjejnë veten të zënë në kurthin e punës apo martesave të detyruara ose trafikimit. Integrimi i fëmijëve dhe të rinjve të riatdhesuar romë, ashkali dhe egjiptianë në sistemin e përgjithshëm arsimor mbetet një nga vështirësitë më të mëdha për arsimin publik në Kosovë.

Në një raport të fundit të UNICEF-it shkruhet se “megjithëse shumica e fëmijëve kanë ndjekur rregullisht shkollën në Gjermani, pas kthimit në Kosovë tri të katërtat e tyre e braktisin shkollën, kryesisht për shkak të varfërisë, pengesave gjuhësore dhe mungesës së vërtetimeve nga shkollat në Gjermani. Në këto kushte të vështira të situatës për arsimimin e tyre, ekziston rreziku që shumë prej fëmijëve dhe të rinjve të deportuar të përpiqen të kthehen në vendin e tyre pritëse duke përdorur rrjetet e krimit të organizuar, ku e vetmja perspektivë që i pret është statusi i “emigrantit të paligjshëm”.

Kuptimi i situatës dhe nevojave të fëmijëve të sapoardhur

Lista e formulimeve

- Nxënësit e kthyer/ të riatdhesuar mund të vijnë nga vende të ndryshme, si për shembull
- Ata mund të kenë një nevoja arsimore dhe sociale të llojeve të ndryshme për shkak se disa prej tyre
- Mund të kenë pasur shkollim me ndërprerje në vendet pritëse;
- Disa mund të kenë pasur përvoja negative në vendet pritëse gjatë procesit të kthimit të detyruar për në Kosovë;
- Tek disa prej tyre, kjo gjë ndikon në aftësinë për të mësuar dhe për të rindërtuar jetën e tyre;
- Kanë përjetuar një rënie të standardit të jetës dhe ndryshime të tjera madhore në jetën e tyre; mund të kenë prindër që po përjetojnë ankth emocional apo social;
- Flasin pak ose aspak shqip/serbisht në momentin e mbërritjes në Kosovë.

Punoni në dyshe:

- Ju lutem, krahasoni përvojat tuaja personale me përvojat dhe kushtet që përshkruhen në listën e mësipërme.
- A keni ndonjë sugjerim se si mund të mbështeten këta fëmijë në shkolla?
- Ku i shihni ju mundësitë për mbështetje dhe ku janë kufijtë?

Ofrimi i një mjedisi mirëpritës në shkollë

Është shumë e dëshirueshme, që fëmijët e riadhesuar të regjistrohen menjëherë në shkollë dhe ta ndjekin atë rregullisht, ku vëmendje e posaçme u duhet kushtuar fëmijëve nga komunitetet e pakicave. Fëmijëve u duhet ofruar një vend në shkollë, sa më shpejt pas kthimit të tyre, edhe nëse ata kanë mangësi në dokumentet e tyre zyrtare.

Disa fëmijë vijnë nga vende, ku sistemi arsimor është i ndryshëm nga i yni. Shkollat mund të kenë qenë të organizuara ndryshe dhe metodat e mësimdhënies mund të kenë qenë më ndërvepruese dhe bashkëpunuese. Edhe gama e lëndëve që nxënësi i ka mësuar në vendin e migrit mund të ketë qenë ndryshe nga ajo në shkollën ku kthehet.

Pas ofrimit të një vendi në shkollë për fëmijën, takimi i parë dhe intervista me prindërit/kujdestarët dhe fëmijët e tyre është momenti ku mund të krijohet një marrëdhënie e mirë. Prindërit/kujdestarët duhet të marrin përshtypjen se mund të kenë besim tek shkolla dhe ata duhet të jenë në të gatshëm që të japin informacione thelbësore lidhur me edukimin e fëmijës. Është e arsyeshme që prindërit/kujdestarët të pyeten lidhur me gjuhët që përdorin për të komunikuar në shtëpi, shkollimin e mëparshëm, si dhe raportin që ata kanë me fëmijën. Familja mund të pyetet, gjithashtu, edhe nëse marrin përfitime apo ndihmë sociale.

Detyrat e grupeve të punës:

- Krijoni një hartë të shkollës suaj për fëmijët dhe prindërit e rinj;
- Hartoni një listë pyetjesh për takimin e parë me prindërit;
- Krijoni një klasë miqësore së bashku me nxënësit tuaj, ku të ketë elemente në gjuhë të ndryshme, piktura, etj;
- Përgatisni me nxënësit tuaj një kënd ku vendosen elemente të historisë nga komuniteti, fshati juaj, etj;

Koncepti i përballimit nga këndvështrimi arsimor

Përballimi është një koncept psikologjik që përshkruan aftësinë e individëve për të kapërcyer përvojat traumatike, siç mund të jenë dhuna, abuzimi, ikja nga një vend apo humbja e një njeriu të dashur, etj. Pas një përvoje të tillë traumatike, si shpërngulja apo humbja e stabilitetit, është normale që të shfaqen reagime të forta emocionale, të cilat zakonisht zbuten me kalimin e kohës. Reagimet e fëmijëve ndaj këtyre ngjarjeve ndyshojnë shumë, si në periudhën afatshkurtër, ashtu edhe në atë afatgjatë. Disa fëmijë e rifitojnë forcën relativisht shpejt, ndërsa të tjerët nuk janë të fortë sa duhet për ta përballuar.

Ka shumë faktorë që ndikojnë në mirëqenien psikologjike. Kohëzgjatja dhe intensiteti i traumës, moshë e fëmijës, personaliteti dhe karakteri i fëmijës, cilësia e përkujdesjes ndaj fëmijëve dhe përvojat në vendin e ri; të gjitha këto ndikojnë në mënyrën se si fëmijët do të përshtaten me të qenit azilkërkues apo refugjat. Disa faktorë të pafavorshëm apo faktorë rrisin më shumë gjasat për shfaqjen e problemeve. Faktorë të tjerë mbrojtës ndihmojnë që fëmija të ruhet nga shqetësimet afatgjata psikologjike.

Është e dobishme që mësimitdhënësit/et të kenë parasysh këta faktorë të pafavorshëm dhe mbrojtës gjatë punës me fëmijët e riatdhesuar. Shkollat dhe mësimitdhënësit/et që duan të promovojnë mirëqenien, duhet të përqipen të maksimizojnë faktorët mbrojtës në jetën e fëmijës dhe të minimizojnë faktorët e pafavorshëm, për sa ata mundën që t'i mbajnë këta faktorë nën kontroll, duke ndihmuar, kështu, në uljen e gjasave që fëmijë të vuajë mjerim psikologjik afatgjatë.

Përmbledhja e mëposhtme identifikon faktorët më të rëndësishëm mbrojtës që mund të kontribuojnë në rimëkëmbjen emocionale dhe përballimin e situatës traumatike. Këto kushte mbështetëse, të ofruara nga familjet dhe shkollat, mund të plotësojnë njëri-tjetrin. Nëse kushtet në familje mbeten të pafavorshme, atëherë roli i shkollave, si mjedis mbështetës, shfaqet tejte i rëndësishëm.

Faktorët mbrojtës përfshijnë:

- Prindër/kujdestarë dhe/ ose një rrjet familjesh që u japin fëmijëve të tyre vëmendje dhe përkujdesje të një cilësie të mirë;
- Qasja ndaj njerëzve të tjerë, veçanërisht nga komuniteti i tyre, të cilët ofrojnë miqësi dhe mbështetje;
- Të kuptuarit e arsyeve të largimit nga vendi i tyre. Është e kuptueshme që fëmijët më të vegjël nuk i kuptojnë plotësisht përvojat e tilla stresuese dhe mund të jenë më të cënueshëm. Fëmijët që janë në gjendje të integrojnë përvojat e tyre, kanë më pak mundësi të vuajnë nga shqetësimet psikologjike afatgjata, ndërkohë që ata që kanë një vetëvlerësim më të lartë kanë më shumë mundësi për të kapërcyer ngjarjet traumatike;
- Mundësia për të ruajtur disa lidhje me vendin e mëparshëm pritës;

- Kujtimi i gjërave të mira nga jeta në vendin e tyre të mëparshëm;
- Të qenit i kënaqur në shkollën e re, miqësitë e reja dhe mundësia për të arritur rezultate në shkollë;
- Të qenit optimist për të ardhmen dhe për arritjen e progresit në shkollë janë faktorë të rëndësishëm mbrojtës;
- Të qenit në gjendje për të folur rreth ngjarjeve stresuese, duke arritur, kështu, t'i vësh ato nën kontroll;
- Të qenit në gjendje për të kërkuar ndihmë kur gjërat nuk shkojnë mirë;
- Pasja e një hobi apo interesi;
- Pasja e planeve për të ardhmen.
-

Faktorët mbrojtës	
FAMILJA	Arsimimi
1. Përkujdesje fizike e mjaftueshme 2. Siguria e mjedisit fizik të drejtpërdrejtë 3. Atmosferë e ngrohtë 4. Strukturë mbështetëse dhe fleksibël për rritjen e fëmijës 5. Shembuj të përshtatshëm nga prindërit 6. Interesi 7. Stabiliteti	1. Siguria e mjedisit fizik më të gjerë 2. Respekti 3. Rrjeti social 4. Shkollim cilësor 5. Miqësitë dhe kontaktet me bashkëmoshatarët 6. Shembuj të përshtatshëm nga shoqëria 7. Stabiliteti i rrethanave të jetës 8. Perspektiva e një të ardhmeje të mirë

Fëmijët e cënueshëm: të kuptuarit e simptomave të dëshpërimit

Fëmijët që kthehen në Kosovë, me një ndërprerje të shkollimit të mëparshëm, përbëjnë një grup shumë të cënueshëm, të rrezikuar nga depresioni, rezultatet e ulëta dhe braktisja e hershme e shkollës. Përveç se jetojnë në një mjedis të panjohur për ta, fëmijët qëu është ndërprerë shkollimi, mund të ndihen të frustruar apo jo në nivelin e duhur, për shkak të paaftësisë për të lexuar, shkruar, ose përmbushur disa detyra, pamundësisë për të ndjekur mësimet dhe mosnjohjes së mjediseve të shkollës dhe pajisjeve të klasës.

Një grup tjetër i cënueshëm formohet nga fëmijët me përvoja të shpërnguljes apo deprivimit, të cilat i pengojnë për t'u stabilizuar. Këta fëmijë mund të shfaqin një sjellje të shqetësuar. Është e rëndësishme që të njihen disa prej përvojave të fëmijëve të riatdhesuar nga minoritetet.

Këto përvoja mund të përfshijnë:

- Humbjen e një mjedisi shkollor të njohur, të objekteve materiale, apo të kushteve me të cilën fëmija është i familjarizuar;
- Incidente negative me autoritetet lokale apo policinë e kufirit;
- Armiqësia në vendin e ri;
- Kushtet materiale deprivuese në shtëpitë e tyre të reja;
- Të qenit me njerëz që nuk i kuptojnë ose nuk janë të informuar për përvojat e tyre

Ankthi me të cilin përballen mund të manifestohet në mënyra të ndryshme, ku përfshihen:

- Shfaqja e jashtme (ncxjerrja jasht) e ngjarjeve apo problemeve stresuese, nëpërmjet mendimeve ose lojërave dhe vizatimeve. Shfaqja e jashtme e këtyre ngjarjeve u bën atyre të mundur që t'i kuptojnë më mirë ato dhe që të arrijnë të kontrollojnë këto emocione të vështira. Shfaqja e jashtme nga ana e fëmijëve e ngjarjeve të dhunshme apo traumatike tregon se ata nuk kanë mundur ta kapërcejnë përvojën e kaluar;
- Simptoma fizike;
- Makthe dhe gjumë i shqetësuar;
- Të qarët dhe ndjesia e trishtimit mbytës;
- Nervozizmi apo frika nga gjëra të caktuara, si për shembull zhurmat e larta;
- Paaftësia për të krijuar marrëdhënie me fëmijë të tjerë, ndoshta të qenit tepër i trishtuar apo i tërhequr për të marrë pjesë në lojëra, paaftësia për të pasur besim tek fëmijët e tjerë. Këta fëmijë mund të jenë të izoluar për shkak të refuzimit nga fëmijët e tjerë, që i shohin si të ndryshëm për shkak të sjelljes së tyre të shqetësuar;
- Vështirësitë për të krijuar raporte me të rriturit, si pasojë e mosbesimit. Ndonjëherë fëmijët u qëndrojnë larg të rriturve pasi i frikësohen humbjes: ata hezitojnë të shfaqin dashuri ndaj një të rrituri të rëndësishëm për ta, pasi ai mund të largohet prej tyre.

Strategjitë bazë për ofrimin e mbështetjes emocionale dhe mbështetjes sociale në nivel klasë

Kompetencat e mësimitdhënësit/es duhet të përfshijnë njohuri dhe kuptim të zhvillimit të fëmijës, vetëdije për nevojat e fëmijës, si dhe njohuri bazë për strategjitë e ndërhyrjes.

Më poshtë mund të gjeni të renditura disa nga strategjitë kryesore pedagogjike për ndërhyrje:

Ndërgjegjësimi për simptomat. Ekipi i mësimitdhënësve të shkollës duhet të marrë në shqyrtim të gjitha politikat që ndjek shkolla për përkujdesjen ndaj fëmijëve që kanë probleme psikologjike. Ofrimi i mbështetjes emocionale për këta fëmijë është pjesë integrale e politikës së çdo shkolle, dhe nuk mund të shihet i ndarë nga çështje të tilla, si ofrimi i një mjedisi mirëpritës, marrëdhënia dhe mbështetja e mirë mes familjeve dhe shkollës. Është e rëndësishme që mësimitdhënësit/et të jenë të vëmendshëm dhe të kuptojnë kur fëmijët janë në gjendje të shtresit dhe dëshpërimit. Vetëm në këtë mënyrë mund të ofrohet mbështetja e duhur. Manifestimi i sjelljeve të mëposhtme mund të jetë tregues së një fëmijë mund të ndihet thellësisht i dëshpëruar:

- Humbja e interesimit dhe energjisë ose të qenit tepër i tërhequr, si dhe interesimi i mangët për gjërat që e rrethojnë;
- Të qenit agresiv apo shumë i zemëruar. Fëmijët mund të shfaqin sjellje agresive për arsye të ndryshme. Disa fëmijë kopjojnë dhunën që kanë parë rreth vetes. Fëmijët e vegjël mund të mos jenë në gjendje që t'i shprehin ndjenjat me fjalë, kështu që përdorin dhunën, si një formë shprehjeje. Po kështu, edhe përvojat traumatike mund t'i bëjnë fëmijët të tensionuar dhe nervozë dhe ata mund të nevikosen shpejt;
- Humbja e përqendrimit dhe të qenit i shqetësuar. Fëmijët që janë të shqetësuar apo të mërziur shpesh e kanë të vështirë të përqendrohen tek detyrat e tyre. Ata mund të ëndërrojnë, mund të shfaqen të tërhequr ose të papërqendruar;
- Të qenit shumë nervozë.

Trajnimi. Trajnimi i vazhduar në shërbim (gjatë punës) duhet të synojë të rrisë njohuritë e mësimitdhënësve mbi prapavinë (sfondin) e formimit të fëmijëve dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre të dëgjimit dhe komunikimit. Organizata të specializuara, si për shembull Terre des Hommes ofrojnë trajnim të vazhduar. Disa mësimitdhënës mund të marrin në konsideratë edhe mundësinë e kurseve të certifikuara të këshillimit.

Këshillimi. Një numër i vogël i fëmijëve të riatdhesuar mund të kenë nevojë për më shumë ndërhyrje. Disa shkolla ofrojnë këshillim individual, apo në grup për fëmijët që kanë përjetuar abuzime apo përvoja stresuese, të cilat zakonisht drejtohen nga mësimitdhënës/se që janë të kualifikuar siç duhet për të ofruar këshillim, ose nga profesionistë të tjerë. Megjithatë, jo të gjitha shoqëritë kanë qasje të njëjtë ndaj shërbimeve të këshillimit dhe

mund të ketë familje që e shohin këshillimin si të papërshtatshëm.

Bisedat me fëmijët. Shumë shkolla kanë strategji të mirë planifikuara përfshirë ,dhe një nga gjërat më të rëndësishme që mësimitdhënësi mund të bëjë është të flasë me fëmijët që ndihen të dëshpëruar, të dëgjojë atë që ata thonë dhe ta marrë seriozisht komunikimin mes tyre. Për ta arritur këtë, mësimitdhënësi/ja apo mentori duhet që të caktojë një orar të rregullt kur ai është i lirë.

Loja. Ata që punojnë me fëmijët më të vegjël mund të përdorin lojërat me individë apo grupe fëmijësh me qëllim që të arrijnë të kuptojnë përvojat e tyre, të zbulojnë probleme të tilla, si frika dhe besimi dhe të ndihmojnë fëmijët e sapoardhur për t'u stabilizuar.

Shkrimi autobiografik dhe krijues. Fëmijët mund të nxiten që të shkruajnë për vetveten, vendin e tyre dhe rrethanat aktuale, të mbajnë ditar, të krijojnë libërth me copëza ose album nga jeta e tyre. Këto teknika autobiografike përdoren shpesh me fëmijët e azilkërkuesve apo refugjatëve dhe ndihmojnë për të arritur një kuptim më të mirë të ngjarjeve dhe ndjenjave komplekse. Fëmijët më të vegjël mund të përdorin bojëra dhe ngjyra për të bërë vizatime rreth vetvetes, dhe të punojnë me një të rritur për të shkruar diçiturat e vizatimeve të tyre.

Arti dhe drama mund të përdoren në të njëjtën mënyrë si shkrimi krijues dhe lojërat: për të ndihmuar fëmijët të shprehin vetveten dhe për të zhvilluar një kuptim më të mirë të ngjarjeve dhe ndjenjave komplekse. Mësimitdhënësit/et e shkollave filllore, mësimitdhënësit/et e artit dhe punonjësit e përkujdesjes mund të trajnohen mbi përdorimin e artit me fëmijët nëgjendje mjerimi apo ata vulnerable, në mënyrëqë t'i ndihmojnë në stabilizimin e tyre.

Teknika të tjera të vlefshme përfshijnë:

- Autoportretet;
- Krijimin e maskave dhe diskutimi i tipareve të fytyrës dhe ndjenjave;
- Ishulli i Shkretë– fëmijët ndahen në grupe me katër ose pesë vetë dhe punojnë me një letër në format të madh; atyre u kërkohet që të vizatojnë sendet që do të donin të merrnin me vete, nëse do t'u duhej të qëndronin së bashku në një ishull të shkretë. Ka vend për të vizatuar sendet personale, si dhe hapësirë të përbashkët, ku fëmijët mund të pikturojnë së bashku. Ky aktivitet shërben si bazë e mirë për të nisur bisedën.

Pika për diskutim:

- Çfarë mund të përdorni në punën tuaj?
- Si do të përpiqeshit të ndihmonit një fëmijë nëgjendje mjerimi psikologjik?
- Jepni shembuj të ndërhyrjeve sipas klasave dhe grupmoshave të ndryshme

Bashkëpunimi mes shkollës dhe prindërve për të ofruar mbështetje

Strategjitë bazë për punën me prindërit. Nëse një fëmijë ka vështirësi në shkollë, është thelbësore që të vendoset një komunikim i mirë me prindërit dhe kujdestarët e tjerë të rëndësishëm. Ndonjëherë, problemet e prindërve dhe ato të fëmijëve mund të jenë të ndërlidhura ngushtë. Largimi nga vendi, shpesh herë mund të ndikojë në prishjen e lidhjeve familjare: fëmijët mund të humbin prindërit ose kujdestarët e rëndësishëm për ta. Më shpesh, fëmijët humbasin vëmendjen e prindërve të tyre, të cilët mund të jenë aq të preokupuar me sigurimin e mbijetesës bazë ose me problemet e tyre, sa nuk arrijnë t'u japin fëmijëve vëmendjen, për të cilën ata kanë nevojë. Atje ku prindërit nuk janë emocionalisht të pranishëm, është e rëndësishme të sigurohet që fëmijët të marrin mbështetje sociale.

Sigurimi i qasjes ndaj **mbështetjes sociale dhe të komunitetit** për fëmijët dhe familjet. Për shumë fëmijë, izolimi dhe mungesa e mbështetjes janë faktorë të rëndësishëm risku. Nëse fëmijët përballen me vështirësi në shkollë, mësimmhendësitet/et duhet të verifikojnë nëse ata dhe familjet e tyre marrin mbështetje nga grupet e komunitetit, nga klubet pas orarit të mësimit, nëse kanë akses në këndet e lojrave, nëse përfitojnë nga skemat për socializimin apo orët e mësimit të gjuhës.

Të nxënit bashkëpunues

Është një mënyrë e të nxënit në grup. Të nxënit bashkëpunues është mësimmhendënie që konsiston në punën e nxënësve të ndarë në skuadra, për të arritur një objektiv të përbashkët, në kushte ku përfshihen elementet e mëposhtme:

1. Ndërvarësi pozitive. Anëtarët e grupeve janë të detyruar të mbështeten tek njëri-tjetri për të arritur objektivin. Nëse njëri prej anëtarëve të skuadrës nuk arrin të bëjë pjesën e vet të detyrës, pasojat i vuajnë të gjithë.
2. Përgjegjësi individuale dhe në grup. Të gjithë nxënësit e një grupi kanë përgjegjësi për pjesën e vet të punës, por edhe për zotërimin e të gjithë materialit që duhet të mësojnë.
3. Ndërveprim pozitiv ballë për ballë. Ndonëse një pjesë e punës në grup mund të ndahet dhe të kryhet individualisht, pjesa tjetër duhet të realizohet në formë bashkëpunuese, ku anëtarët e grupit ofrojnë komente për njëri-tjetrin, sfidojnë arsyetimin dhe përfundimet dhe, ajo çka është më e rëndësishme, mësojnë dhe inkurajojnë njëri-tjetrin.
4. Përdorimi i përshtatshëm i aftësive bashkëpunuese. Nxënësit nxiten dhe ndihmohen që të zhvillojnë dhe praktikojnë ndërtimin e besimit, lidhshirësinë, vendimmarrjen, komunikimin dhe aftësitë për zgjidhjen e konflikteve.
5. Përpunimi në grup. Anëtarët e skuadrës përcaktojnë objektivat për grupin, vlerësojnë periodikisht atë çka po bëjnë mirë si skuadër si dhe identifikojnë ndryshimet që duhet të bëjnë për të funksionuar në mënyrë më të efektshme në të ardhmen.

Vetëm ato aktivitete që përfshijnë të pestë elementet e mësipërme plotësojnë kushtet për t'u klasifikuar tek të nxënit bashkëpunues.

Të nxënit bashkëpunues është punë në grup, por jo çdo punë në grup klasifikohet domosdoshmërisht tek të nxënit bashkëpunues. Ai dallon nga puna në grup në disa aspekte:

- ✓ Grupet janë heterogjene;
- ✓ Të gjithë pjesëmarrësit përfshihen mënyrë aktive;
- ✓ Përgjegjësia individuale është e garantuar;
- ✓ ndërveprimi ballë për ballë (të gjithë anëtarët e grupit mund ta shohin dhe dëgjojnë njëri-tjetrin);
- ✓ Zhvillim i qëllimshëm i aftësive sociale;
- ✓ Vlerësim i procesit dhe rezultatit.

Të nxënit bashkëpunues kërkon plotësimin e të gjithë këtyre parimeve.

Bashkëpunimi përmirëson cilësinë e marrëdhënieve sociale, aftësinë për t'u përshtatur në grup, lehtëson zhvillimin social dhe intelektual të personalitetit. Detyrat e të nxënit bashkëpunues nuk kanë si synim vetëm rezultatin e punës, por edhe procesin dhe aftësitë sociale që stimulohen nëpërmjet edukimit akademik. Duke pasur parasysh se të nxënit bashkëpunues zhvillon njësoj si aftësitë sociale, ashtu edhe ato akademike, mund të arrihet në përfundimin se ai kontribuon në zhvillimin social dhe kognitiv të individit.

Mësimdhënësi që aplikon të nxënin bashkëpunues krijon një mjedis edukues që çon në zhvillimin e aftësive bashkëpunuese, shprehive për të përmbledhur dhe analizuar informacionin, aftësive për të parashtruar dhe provuar hipoteza, si dhe për të vlerësuar procesin dhe rezultatin e punës personale dhe të anëtarëve të tjerë të grupit. Gjatë organizimit dhe menaxhimit të grupit bashkëpunues roli i mësimdhënësit/et ndryshon. Mësimdhënësi nuk është më vetmi burim informacioni. Kjo përgjegjësi ndahet me nxënësit. Mësimdhënësi mëson të mos ndërhyjë në punën e grupit, nëse kjo nuk është e nevojshme, por vëzhgon procesin në mënyrë aktive dhe organizon vlerësimin e tij.

Gjatë përdorimit të të nxënit bashkëpunues mësimdhënësi është përgjegjës për punën e grupit në tre nivele:

- ✓ Zgjidhja e problemeve;
- ✓ Menaxhimi i grupit e management;
- ✓ Përpunimi i marrëdhënieve.

Të nxënit bashkëpunues u jep nxënësve mundësinë të jenë krijuar dhe të zhvillojnë aftësitë e mendimit kritik, të jenë tolerantë dhe të pranojnë dallimet. Për më tepër, të nxënit nëpërmjet bashkëpunimit rrit vetëvlerësimin e nxënësve dhe krijon qëndrime pozitive ndaj vetes, shokëve, mësimdhënësve, shkollës dhe arsimit.

Të nxënit bashkëpunues mund të përdoret me sukses me nxënës të moshave të ndryshme, duke nisur që nga arsimi parashkollor deri tek arsimi për të rriturit. Niveli i vështirësisë së

detyrës dhe çështjet që merren në studim varen nga mosha dhe interesat e nxënësve, ndërkohë që metoda e të nxënësve mbetet, në thelb, e njëjtë.

Të nxënësve bashkëpunues është në harmoni me politikën aktuale të arsimit në Kosovë dhe qëllimin e saj për formimin e personalitetit të plotë, zhvillimin e socializimit dhe edukimin e qytetarëve të aftë për të jetuar dhe punuar në një shoqëri demokratike. Të nxënësve bashkëpunues po përdoret gjithnjë e më tepër në institucione të ndryshme arsimore, siç janë ato të përgjithshme, profesionale, në kurset e formimit parësor, ato të formimit të vazhduar, si dhe në kurset e rikualifikimit.

Përdorimi i të nxënësve bashkëpunues sjell disa përfitime si për procesin e tënxënësve, ashtu edhe për klimën në klasë. Disa prej këtyre përfitimeve janë:

- Motivim më i madh dhe përfshirje aktive e nxënësve në procesin e tënxënësve. Secili anëtar ka mundësi të kontribuojë në grupe të vogla. Nxënësit priren të kenë zotërim më të mirë të materialit të tyre dhe të mendojnë në mënyrë kritike për çështje që lidhen me të kur punojnë si skuadër;
- Më shumë mundësi për informacion kthyes në rrafsh personal. Për shkak të shkëmbimeve më të shumta mes nxënësve në grupet të vogla, nxënësit marrin më shumë feedback/komente personale mbi idetë dhe përgjigjet e tyre. Ky feedback shpesh nuk është i mundshëm në mësimdhënien në grupe të mëdha, gjatë së cilës një ose dy nxënës shkëmbejnë ide, ndërsa pjesa tjetër e klasës dëgjon.
- Njohja e dallimeve individuale. Kur bëhen pyetje, nxënës të ndryshëm mund të kenë përgjigje të ndryshme. Secila prej tyre mund të ndihmojë grupin për të krijuar një produkt që pasqyron një larmi të gjerë këndvështrimesh dhe, që rrjedhimisht, është më i plotë.
- Qëndrim pozitiv ndaj diversitetit. Nxënësit mësohen të punojnë me të gjitha tipet e njerëzve. Gjatë ndërveprimeve në grupe të vogla ata gjejnë mundësinë për të reflektuar dhe reaguar ndaj përgjigjeve të ndryshme që bashkënxënësit japin për pyetjet e ngritura. Grupet e vogla u lejojnë nxënësve që të shtojnë këndvështrimin e tyre mbi një problem të caktuar, bazuar në dallimet e tyre kulturore. Ky shkëmbim, në mënyrë të pashmangshme, i ndihmon nxënësit që të kuptojnë më mirë kulturat dhe këndvështrimet e tjera.
- Përmirësim të marrëdhënieve ndërpersonale dhe atyre në grup. Nxënësit mësojnë të vendosin raporte me bashkëmoshatarët e tyre dhe nxënësit e tjerë gjatë punës së përbashkët në ndërmarrjet në grup. Kjo mund të jetë veçanërisht e dobishme për nxënësit që shfaqin vështirësi në aftësitë sociale, për nxënësit e porsardhur ose për ata që u përkasin minoriteteve. Ata mund të përfitojnë nga ndërveprimet e strukturuar me të tjerët, ndërsa të tjerët mund të kapërcejnë paragjykimet e tyre gjatë këtij procesi.

Gjatë përpilimit dhe vënies në zbatim të aktiviteteve të tënxënësve bashkëpunues, duhet të merren parasysh edhe disa rreziqe:

- *“Nxënësit e mirë bëjnë punën dhe “nxënësit e dobët” në realitet nuk mësojnë;*
- *“Nxënësit e mirë” humbin kohë në pritje “të nxënësve të dobët”, ndërkohë që mund të kishin avancuar më shpejt;*
- Puna në grup i përjashton apo demotivon nxënësit e minoriteteve, nxënësit e turpshëm, apo ata që kanë shprehur gjuhësore të një niveli më të ulët;
- Dështimi apo rezultatet e ulëta të grupit mund të përkeqësojnë marrëdhëniet ndërpersonale dhe mes grupeve në një klasë të përzier.

Rrugët për të shmangur rreziqe janë:

- Përcaktohen qartë detyrat dhe shpjegohet se krahas rezultatit, edhe puna e përbashkët është një nga elementet që do të merret në konsideratë për vlerësimin e secilit nxënës;
- Shmanget etiketimi i nxënësve dhe stimulohet fryma e skuadrës në klasë;
- Tregohet kujdes me ndarjen në grupe. Grupet heterogjene funksionojnë mirë për shumicën e detyrave, nëse ka një ndarja të qartë dhe të balancuar të roleve në grup, bazuar në anët e forta të secilit anëtar (ndarja e pikave të forta). Megjithatë, për disa detyra mund të merren në konsideratë grupet homogjene, por duhet të jeni të qartë se në këtë rast nuk kemi të nxënës bashkëpunues;
- Mbikqyret grupi dhe ofrohet mbështetje sa herë që është e nevojshme;
- Sigurohet që në rastet e rrezikut për dështim, grupi të rikthehet në rrugën e duhur dhe që të gjithë anëtarët japin kontributin e tyre;
- Ruhet numri i anëtarëve në grupe nga 3 deri në 5 persona.

Promovimi i vetëdijes për gjuhën dhe diversitetin kulturor

Metoda kyçe për të gjitha moshat e shkollimit

Fëmijët duhet të nxiten që të nderojnë gjuhën e tyre amtare, duhet të ketë shenja dhe etiketa në gjuhët përkatëse. Njohuritë që u jepen të gjithë fëmijëve për gjuhët e ndryshme të anëtarëve të grupit ndihmojnë për të vlerësuar më shumë multilingualizmin:

- Lejohen fëmijët që t'i mësojnë stafit disa fjalë në gjuhë të ndryshme, përfshirë atë rome, fjalë që mësohen edhe nga fëmijët e tjerë;
- Realizimi i etiketave dhe shenjave në gjuhët përkatëse;
- Mësimi i disa fjalëve në gjuhët e tjera, veçanërisht i përshëndetjeve;
- Inkurajimi i prindërve për të qenë të pranishëm dhe për t'u lexuar histori apo mësuar këngë;
- Inkurajimi i komunikimit, si fjalët përshëndetëse të mirëseardhjes dhe ndarjes.
- tregimi i përrallave nga folklori i vendeve të ndryshme dhe grupeve të ndryshme etnike
- kremtimi i festave të ndryshme, myslimane, të krishtera, hebreje dhe rome;

Shprehje krijuese:

Aktivitetet e mëposhtme mund të jenë të dobishme:

- Për inkurajimin e kësaj loje mund të përdoret një shportë thesari që përmban materiale me përbërje të ndryshme, apo me objekte që bëjnë zhurma të ndryshme. Mund të vlejnjë edhe lodra të vogla, figura apo objekte të tjera, të cilat lehtësojnë tregimin e historive, si dhe kukulla, mbështetëse dhe veshje për të luajtur role;
- Dramatizimet, përfshirë miniaturat dhe krijimin e maskave, të cilat u mundësojnë fëmijëve që të aktrojnë ndjenjat dhe 'konfliktet';
- Mundësitë për lojë të lirë, çka u lejon fëmijëve të përdorin lojën për të interpretuar ngjarjet stresuese që kanë pasur gjatë jetës së tyre;
- Përdorimi i historive/tregimeve, që pasohen nga diskutimet, aktrimi dhe dramatizimi.

Fëmijët e riatdhesuar dhe nevojat e tyre gjuhësore

Disa nga nxënësit e ardhur në Kosovë flasin pak ose aspak shqip ose serbisht. Mësimi i shpejtë i gjuhës së dytë është element kyç për integrimin e tyre të suksesshëm në sistemin shkollor dhe komunitetin e gjerë.

Formimi gjuhësor i këtyre fëmijëve mund të jetë i ndryshëm. Disa flasin gjuhën rome dhe kanë pasur pak ose aspak kontakt me gjuhën shqipe apo atë serbe. Disa mund të kenë marrë pak ose aspak arsim të mëparshëm dhe mund të mos dinë të lexojnë as në gjuhën e tyre.

Praktika e mëposhtme është konsideruar si e efektshme për të ndihmuar një fëmijë të mësojë një gjuhë të re:

- Sigurohuni që ata përshëndeten në çdo mësim;
- sigurohuni që nxënësit i dinë emrat e mësimitdhënësve të tyre dhe të stafit mbështetës dhe që ata kanë mundësi të shkruajnë emrat e tyre;
- Uleni nxënësin pranë anëtarëve të shoqërueshëm të klasës, mundësisht pranë atyre që flasin të njëjtën gjuhë dhe që mund të përkthejnë, nëse diçka nuk është kuptuar;
- Fillestarëve u mësohen frazat më të përdorshme bazë;
- Pyeten nxënësit se cilat janë fjalët dhe shprehjet ekuivalentet që ata i përdorin në shtëpi, pra fjalët dhe shprehjet në gjuhët e tyre për fjalët shqip ose serbisht;

Edukimi ndërkulturor i shtrirë në të gjithë kurrikulën

Ky dokument përmban disa sugjerime për aktivitete shkollore që mund të përdoren nga shkollat përgjatë gjithë kurrikulës me qëllim që të rritet ndërgjegjësimi rreth diversitetit kulturor.

Përveç kësaj, kurrikulës bazë mund t'i shtohen projekte të vogla. Orët e arteve, historisë dhe gjuhës ofrojnë shumë mundësi.

Projektet mund të përfshijnë, për shembull, punë me tregime apo dëshmi; shkrimi i historive dhe përshkrimeve për migracionin; intervista dhe prezantime mbi çështje që kanë lidhje me këto tema. Projektet e historisë mund të trajtojnë zhvillimin e Kosovës multietnike; projekte të historisë vendore dhe historitë gojorepër të kthyerit dhe refugjatët.

Në lëndën e Edukatës Qytetare nxënësit mund të zhvillojnë kompetencat e tyre qytetare dhe aftësitë e të folurit dhe dëgjimit nëpërmjet dramatizimeve dhe debateve mbi temat përkatëse, nëpërmjet prezantimit të informacionit dhe negocimit. Nxënësve mund t'u jepen tekste për të lexuar, si për shembull, artikuj gazetash, autobiografi, ditare, letra dhe fletëpalosje.

Mentorimi nga bashkënxënësit

Programi shkollor për mentorimin nga bashkënxënësit është një kornizë e vendosur në shkollë dhe e mbështetur nga shkolla, në të cilën nxënësit, në mënyrë vullnetare ofrojnë ndihmë për kolegët e tyre më të vegjël ose për kolegët që hasin pengesa për të qenë të suksesshëm në shkollë (p.sh: mungesa e mbështetjes nga familja, e kushteve dhe burimeve për të mësuar, probleme gjuhësore, ardhja nga një shkollë tjetër ku kërkesat kanë qenë të ndryshme, etj.)

Përfshirja në mentorim nga bashkënxënësit sjell përfitime si për mentorin, ashtu edhe për personin që merr mbështetje:

Për nxënësit që përfitojnë nga mbështetja e mentorit, efektet mund të përfshijnë:

- Përmirësim të qëndrimeve ndaj shkollës dhe bashkënxënësve;
- Ndjesia e kompetencës dhe vetëefikasitetit;
- Nota më të mira dhe arritje akademike;
- Qëndrime dhe sjellje pro-sociale.
-

Për mentorët janë raportuar përmirësime për sa i takon:

- Lidhjes me shkollës;
- Vetëvlerësimin;
- Ndjeshmërisë dhe arsytimit moral;
- Komunikimit ndërpersonal dhe aftësive për zgjidhjen e konflikteve;
- Marrëdhënive me prindërit .

Mentorimi kryesisht është një marrëdhënie, e cila, gjithsesi, kalon nëpërmjet aktiviteteve konkrete, siç janë mbështetja për detyrat e shtëpisë, vizitat e përbashkëta në vende kulturore ose edukative jashtë shkollës, mbështetje në shkollë, madje edhe gjatë mësimin, etj. Pjesëmarrësve në program mund t'u ofrohen mundësi për t'u angazhuar bashkërisht në aktivitete në grupe (si psh: programe të punës vullnetare në komunitet, organizimi i një aktiviteti në komunitet, etj).

Në programet e efektshme të mentorimit mentorët trajnohen (brenda shkollës - nga një mësimdhënës apo mentor më i vjetër, ose jashtë shkollës – nga njëOJQ r ose qendër formimi), si dhe përfitojnë nga takimet e rregullta për t'i ofruar njëri-tjetrit mbështetje në tejkalimin e sfidave. Zakonisht, rolin e koordinatorit të programit e luan një mësimdhënës.

Në bazë të punës së mentorëve duhet të vendosen rregulla të qarta etike dhe shkolla duhet të jetë transparente dhe e drejtë në procedurat e rekrutimit, trajnimit dhe mbështetjes së mentorëve, si dhe në identifikimin e përfituesve dhe kombinimin e tyre me mentorët.

Rreziqet që duhet të shmangen në programet e mentorimit nga bashkënxënësit:

- Mentorët dhe përfituesit mund të mos i kuptojnë plotësisht rolet e tyre. Përfituesit

mund të mos e kuptojnë se si një mentor mund t'i ndihmojë ata që të arrijnë qëllimet e tyre, mund të ndihen të turpëruar apo të intimiduar për shkak të përfshirjes në program ose mund ta perceptojnë këtë përfshirje si një formë ndëshkimi;


- Mentorët bashkënxënës, ndonjëherë, mund të ofrojnë modele negative. Për këtë arsye rekrutimi i mentorit duhet ta ketë këtë gjë në vëmendje, ndërkohë që monitorimi dhe mbikqyrja e rregullt i ul rreziqet;
- Marrëdhënia e krijuar përmes mentorimit nga bashkënxënësi mund të hasë vështirësi, kapërcimi i të cilave mund të kërkojë ndihmë nga jashtë.

Ndërmjetësimi nga bashkënxënësit

Ndërmjetësimi është një strategji e menaxhimit të konfliktit, e cila mbart karakteristikat e mëposhtme:

-Palët në konflikt kërkojnë ose pranojnë ndërhyrjen e një pale të tretë, ndërmjetësuesit, roli i të cilit është të mbështesë gjetjen e një zgjidhjeje reciprokisht të kënaqshme për mosmarrëveshjet;

-Roli i ndërmjetësuesit nuk është që të propozojë zgjidhje, por të ndihmojë palët që të përfshihen në dialog dhe të arrijnë një marrëveshje.



Procesi i ndërmjetësimit zakonisht përfshin hapat e mëposhtëm:

- Përgatitja e ndërmjetësimit;
- Shpjegimi i rregullave dhe parimeve që duhet të respektohen nga palët dhe ndërmjetësuesi gjatë negociimit, si:
 - ✓ Synohet një zgjidhje e pranueshme nga të dyja palët;
 - ✓ Ndërmjetësuesi është më i paanshëm;
 - ✓ Mundësi dhe kohë e barabartë për të folur;
 - ✓ Ruhet qetësia, nuk përdoren etiketime/sharje;
 - ✓ Nuk ka ndërprerje;
 - ✓ Konfidencialiteti, me përjashtim të rasteve kur ka rrezik për të tjerët ose vetveten ose kur ka forma abuzimi në të tashmen ose të shkuarën.
- U kërkohet palëve të paraqesin qëndrimet, nevojat dhe interesat e tyre;
- Jepet informata kthyesë, bëhen perifrime dhe pyetje për të siguruar qartësinë,
- U kërkohet palëve që të propozojnë zgjidhje realiste;
- Palët mbështeten për të gjetura pikat e përbashkëta nëpërmjet analizimit të zgjidhjeve dhe evidentimit të opsionit më të mirë për të dyja ato;
- Sigurohet që palët e kanë kuptuar se çfarë nënkupton zgjidhjadhe e pranojnë;

- Mbahet shënim marrëveshja;
- Diskutohet vazhdimësia, nëse kjo është e nevojshme.

Në programet e ndërmjetësimit në shkolla, konfliktet dhe mosmarrëveshjet trajtohen me anë të ndërmjetësimit, të cilat kryhet nga ndërmjetësuesit nxënës. Ata janë vullnetarë, trajnohen nga mësuesi përgjegjës për programin dhe respektojnë parimet e ndërmjetësimit (p.sh: propozojnë, por nuk imponojnë ndërhyrjen e tyre, ruajnë paanësinë, etj.)

Për këtë arsye, një program i efektshëm i ndërmjetësimit nga bashkënxënësit duhet të marrë parasysh:

- Rekrutimin dhe trajnimin e nxënësve ndërmjetësues;
- Promovimin e programit në mënyrë që të gjithë nxënësit të njohin mënyrën se si ai funksionon dhe se si mund të përfitojnë;
- Ofrimin e mbështetjes për nxënësit ndërmjetësues në përmbushjen e rolit të tyre;
- Monitorim të mirë dhe sigurimin e cilësisë së procesit.

Të punuarit së bashku: shkolla, prindërit, komuniteti

Përfshirja e prindërve

Vendosja e lidhjeve të forta me prindërit është pjesë thelbësore për mbështetjen e edukimit të nxënësve nga minoritetet. Shkollat më të suksesshme në punën me këta nxënës janë ato që kanë nxitur një nivel të lartë të pjesëmarrjes së prindërve. Një shkollë e tillë zakonisht ka lidhje të mira me iniciativat e komunitetit, qendrat e formimit dhe projektet lokale, përfshirë edhe grupet e komuniteteve minoritare.

Prindërit luajnë rol kyç në edukimin e fëmijëve të tyre. Ata janë edukatori kryesor i fëmijës dhe e njohin këtë të fundit më mirë se kushdo tjetër. Të dhëna të shumta kërkimore dëshmojnë se fëmijët ia dalin më mirë kur ka një partneritet të ngushtë pune mes familjes dhe shkollës. Përfshirja e prindërve dhe marrëdhënia e tyre me shkollën është thelbësore për të përirësuar frekuentimin e shkollës dhe mbarimin e shkollimit.

Përfshirja e prindërve përbën, kështu, një faktor kyç në arritjet e nxënësve dhe kjo vlen për të gjitha grupet etnike.

Studimet kanë identifikuar se:

- Përfshirja e prindërve ka efekt domethënës në arritjet e nxënësve gjatë gjithë viteve të shkollimit;
- Interesi i babait për shkollimin e fëmijës lidhet fort me rezultatet pozitive në shkollë;
- Dështimi në shkollë rritet për shkak të mungesës së interesit të prindërve në shkollim;
- Shumë prindër duan të jenë më të përfshirë në edukimin e fëmijëve të tyre.

Megjithatë, ka prindër që kanë lidhje të pakta me shkollën e fëmijës së tyre. Po kështu, disa shkolla raportojnë se është e vështirë të krijojnë lidhje me familjet e nxënësve. Vlen të ndalemi tek disa nga shkaqet e këtyre problemeve:

- Përvojat e së shkuarës në vendin pritës i bëjnë prindërit dyshues ndaj autoritetit dhe pa besim në kontaktet me shkollën;
- Prindërit mund të mos e njohin sistemin arsimor, kështu që aktivitetet me prindërit/kujdestarët mund të jenë diçka e panjohur;

Një shkollë që ka vendosur lidhje të forta me familjet e minoriteteve dhe ato të riatdhesuara ofron një klimë mirëpritëse që:

- I bën prindërit të ndihen të nevojshëm dhe që mund të luajnë një rol pozitiv;
- U dëshmon prindërve se ata gjithmonë mund t'ia bëjnë të ditura stafit ndjenjat dhe mendimet e tyre, dhe se këto të fundit do të trajtohen me respekt dhe seriozitet;
- Demonstron se gjuha, kultura dhe besimi fetar i prindërve/kujdestarëve vlerësohet dhe respektohet;

- Dëshmon se shkolla është pjesë e komunitetit të cilit i shërben.

Temat kryesore rreth prindërve nga minoritetet etnike (përfshirë të kthyerit)

1. Njohja e diversitetit brenda dhe përtej grupeve etnike

- Një pikënisje e mirë për nxitjen e përfshirjes së prindërve dhe minoritetit është njohja/pranimi i ekzistencës së komuniteteve të ndryshme me përvoja të ndryshme;
- Individët e një komuniteti apo edhe nga të gjitha komunitetet nuk duhen parë në një mënyrë që do të çonte drejt etiketimit apo krijimit të stereotipeve.

2. Sfida ndaj racizmit dhe perceptimeve negative

- Disa punonjës të arsimit mund të bëjnë hamendësime në lidhje me prindërit bazuar në prejardhjen e tyre, të cilat mund të jenë të padrejta dhe paragjyquese
- Duhet të luftohen perceptimet negative

3. Adresimi i pengesave

- Prindërit dhe fëmijët nga minoritetet mund të hasen me një sërë vështirësish ekonomike, sociale si dhe pengesash praktike, çka ua vështirëson përfshirjen në shkollë

4. Fuqizimi i prindërve

- Prindërit nga minoritetet duhet të ftohen që të takojnë mësimdhënësit/et dhe të shohin shkollën.

Ndërtimi i lidhjeve të forta me komunitetin:

Është e rëndësishme që shkollat të krijojnë lidhje të mirë me organizatat e komunitetit pranë tyre. Nëse një shkollë dëshiron të përmirësojë përfshirjen e prindërve nga minoritetet në aktivitetet e saj, ajo mund t'u kërkojë grupeve të komuniteteve përkatëse që t'i përgjigjen kësaj hapjeje. Grupet nga komuniteti rom, ndonjëherë, mund të ofrojnë përkthyes për të ndërmjetësuar një rast urgjent. Ata mund të ftohen që t'u flasin nxënësve ose mund të përfshihen në aktivitete ose projekte për rritjen e ndërgjegjësimit. Shkolla mund të hulumtojë dhe mund të hartojë një listë të organizatave nga komunitetet, apo edhe të personave të kthyer të cilët mund të ftohen për të ndihmuar.

- Disa nga shërbimet që ofrohen nga grupet dhe organizatat e komuniteteve janë:
- Këshillim në lidhje me të drejtat e mirëqenies sociale dhe ato të strehimit;
- Orë për mësimin e gjuhës, trajnim për punësim dhe këshillim karriere;
- Shkolla suplementare për fëmijët, aktivitete edukative dhe kulturore, sporte;
- Aktivitete për të rinjtë;
- Aktivitete për qytetarët e moshuar;
- Grupe për gratë;
- Evenimente kulturore dhe ekskursionet;
- Prodhimi i gazetave dhe informacioni.

Shembuj nga praktika ndërkombëtare

Një nga autoritetet vendore në Gjermani ka mundësuar sigurimin e fondeve statutores për financimin e 10 klasave për *mësimin e gjuhës gjermane për prindërit*. Mësimi bëhet në shkollat ku shkojnë fëmijët e tyre, gjatë orarit të mësimit, gjatë vitit akademik. Shumica e prindërve që ndjekin mësimin janë refugjatë romë.

Në të njëjtat shkolla, mentorët bashkënxënës, nga grupe të ndryshme etnike, bashkëpunojnë në mënyrë individuale me nxënësit më të vegjël. Ata luajnë rolin e tutorëve, i ftojnë përfituesit në aktivitete jashtëshkollore, bëjnë detyrat e shtëpisë së bashku ose i ndihmojnë ata me përkthime.

Një shkollë e mesme e madhe në Suedi, e cila kishte një numër të lartë fëmijësh refugjatë vendosi të promovojë pjesëmarrjen e prindërve në mbrëmjet për prindërit. Kishte rezultuar se vetëm pak prindër turq dhe kurdë merrnin pjesë në këto mbrëmje. Pas kësaj shkolla mori një asistent trigjuhësh në klasë, i cili fliste gjuhën turke dhe atë kurde. Shërbimi i përkthimit nga ana e tij u përdor gjatë mbrëmjeve me prindërit dhe për përkthimin e letrave në shtëpi. Pjesëmarrja e prindërve në aktivitetet e shkollës, e nënave dhe e baballarëve, u rrit si rezultat i kësaj mase.

Një shkollë në Londër, me një numër të madh fëmijësh nga Kosova, ofroi një dhomë ku prindërit mund të takoheshin. Si rezultat i takimeve të prindërve lindi një organizatë e komunitetit dhe një shkollë komunitare, ku ofrohet mësimi i gjuhës shqipe.

Një shkollë gjermane bëri një kafene ku mund të takoheshin nënat/prindërit. Ndërmjetësuesit arsimorë organizuan takime informative, ndërsa persona vullnetarë ofruan kurse për mësimin e shkrimit dhe leximit.

U stabilizua frekuentimi i shkollës nga fëmijët, ndërkohë që fëmijët me nënat e tyre përfitonin nga aktivitetet pas mësimit që organizoheshin në këtë kafene.

Detyra:

Diskutoni në grupe të vogla çështjet e mëposhtme.

1. A mund të zbatohen në shkollat tuaja projekte të ngjashme?
2. Diskutoni projekte të tjera sociale në bashkëpunim me prindërit/edukatorët nga minoritetet.
3. Diskutoni idenë e mentorimit nga bashkënxënësit në shkollat tuaja.

Roli i ndërmjetësuesit shkollor

Ndërmjetësuesit shkollorë për minoritetet etnike kanë një rol thelbësor në shumë shkolla, për të mbështetur e përfshirjes së prindërve, kujdestarëve dhe komuniteteve.


Puna e tyre përfshin:

- Sigurimin e një atmosfere mirëpritëse në shkollë;
- Këshillimin mbi rrugët e ndryshme që sigurojnë dëgjimin dhe konsultimin e prindërve dhe kujdestarëve me prejardhje të ndryshme në lidhje me nevojat e tyre;
- Hartimin e strategjive që sigurojnë kuptimin nga ana e prindërve të qasjes që ka shkolla ndaj mësimdhënies dhe ndaj të nxënit;

Gjithashtu, roli i ndërmjetësuesit lidhet me:

- Nxitjen e prindërve që të mbështesin të nxënit e fëmijës së tyre;
- Identifikimin e mënyrave se si prindërit mund të kontribuojnë në jetën e shkollës;
- Zhvillimin e lidhjeve mes shkollës dhe komunitetit;
- Sigurimin e prindërve që gjuhët amtare luajnë rol të rëndësishëm në të nxënit e fëmijës;
- Sigurimin e vlerësimit nga shkolla të aftësive dygjuhësore.

Pozicioni i dëshirueshëm për ndërmjetësuesin paraqitet në pjesën e poshtme të këtij diagrami. Pjesa e sipërme në diagram paraqet dy keqpërdorime të ndërmjetësuesit, që hasen shpesh në praktikë.



Partneritetet online - vështrim i përgjithshëm

Partneritetet online sjellin një element shtesë të diversitetit në Planin e zhvillimit të shkollës suaj: dimensionin ndërkombëtar. Ato paraqesin një mjet të dobishëm për rritje të cilësisë së mësimnxënies dhe motivimit të fëmijëve për të mësuar. Shumë shkolla në Evropë i kanë përfshirë aktivitetet e tilla në punën e tyre të rregullt dhe posedojnë klasë të ndryshme për angazhim në shkëmbime me partnerët nga pjesë të tjera të botës përmes internetit.

Për t'i shmangur rreziqet e një shkëmbimi sipërfaqësor (që mund të bëhet humbje kohe për mësimdhënësit/et dhe sjellin pak përfitime për fëmijët), është e rëndësishme që të:

- Fokusojnë partneritetin online në mësimnxënie, preferohet që të punohet me diçka tashmë të përfshirë në kurrikulë, ose elemente plotësuese të kurrikulës;
- Lidhet me objektivat dhe aktivitetet në Planin e zhvillimit të shkollës suaj, ose përshtatet planin për të përfshirë elemente shtesë që vijnë nga partneritetet online;
- Ketë mbështetje nga drejtori i shkollës dhe stafi mësimdhënës dhe të pranojë përpjekjet e mësimdhënësve të përfshirë drejtpërdrejt në organizimin e këtyre aktiviteteve.

Partneritetet online mund edhe të jenë efektive në vlerësimin e njohurive dhe potencialit të fëmijëve, të cilët jetojnë jashtë vendit, ose kanë lidhje me anëtarët e familjes ose shokët në vendet e tjera.

Partneritetet online bëhen ndërmjet klasave me moshë të njëjtë. Gjuha e punës është gjuha angleze. Shkëmbimet bëhen në platformë të sigurt, pa pagesë **Taking it Global** (www.tigeg.org). Mbështetje teknike dhe metodologjike u jepet mësimdhënësve të gjuhës angleze, përgjegjës për procesin në secilën shkollë. Kërkohen vetëm shkathtësi bazë të kompjuterit nga mësimdhënësit/et e përfshirë.

Inkurajohet bashkëpunimi me mësimdhënësit/et e lëndëve të tjera në shkollë.

Procesi strukturohet në bazë të 12 takimeve javore por fëmijët punojnë ndërmjet takimeve.

1. Secila klasë ndahet në grupe. Anëtarët e grupit prezantohen;
2. Hyrjet ndahen me partnerët. Diskutimi: kush janë partnerët?
3. Çfarë dimë për temën? Si mund të mësojmë më shumë?
4. Planifikoni mbledhjen e informatave;
5. Organizoni informatat dhe merrni vendime;
6. Përgatitni prezantimin e klasës për temën;
7. Analizoni prezantimin e klasës partnere dhe përgatitni komente/pyetje
8. Rishikoni prezantimin tuaj në bazë të komenteve/pyetjeve të marra;
9. Analizoni prezantimin përfundimtar të klasës tjetër;
10. Reflektimi në përvojën e mësimdhënies dhe vlerësimin përfundimtar.

Ky proces ka për qëllim zhvillimin në të njëjtën kohë:

- ✓ Njohuritë e gjuhës angleze;
- ✓ Njohuritë lidhur me temën e studiuar;
- ✓ Njohuritë për bashkëpunim dhe menaxhim;
- ✓ Njohuritë ndërkulturore.

Temat për t'u studiuar do të përzgjidhen bashkë me mësuesin/et partnerë.

Monitorimi dhe vlerësimi i procesit të zhvillimit të shkollës

Pikat kryesore për monitorim dhe vlerësim: të mësuarit aktiv, përfshirja e prindërve dhe mbështetja e komunitetit

Të nxënit aktiv

Të nxënit aktiv përfshin të mësuarit në bashkëpunim me të tjerët. Të nxënit brenda një komuniteti të nxënësve mundëson fëmijës për të ndërtuar njohuritë e tij/saj, për të shqyrtuar çështjet nga këndvështrime të shumta, dhe më pas për të shqyrtuar dhe reflektuar mbi diskutimet e tij / saj me kolegët. Planprogrami i vë në dukje se, përmes këtij procesi të të nxënit aktiv, fëmijët janë më të prirur për të përvetësuar atë që ata kanë mësuar dhe jenë në gjendje të aplikojnë atë në punën dhe situata të përditëshme. Me fjalë të tjera, mënyra me të cilën fëmija fiton njohuri ndikon në shkallën në të cilën bëhet e dobishme apo jo për te. Kjo e bën të nxënitaktiv të rëndësishm për të mësuar kuptimin e qytetarisë së përgjegjshme.

Të nxënit aktiv:

- ✓ Angazhohet fëmijët fizikisht, në aspektin kognitiv dhe emocionalisht;
- ✓ Promovon veprime që duke mësiar fëmijët njohin kapacitetin e tyre dhe vetë-efikasitetin;
- ✓ Vendos fëmijët në qendër të procesit të të mësuarit përmes të siguar se përmbajtja është e rëndësishme për jetën e tyre dhe është i angazhuar për ta;
- ✓ Kërkon një atmosferë të besimit dhe mbështetjes në mënyrë që të sigurohet që fëmijët të angazhohen dhe të ndjehen të sigurt në shprehjen e pikëpamjeve të tyre si dhe të përpiqen të provojnë aftësi të reja;

Përfshirja e prindërve dhe komunitetit më të gjerë

Përfshirja e prindërve është vendimtare për suksesin e fëmijës në shkollë. Përfshirja e prindërve në edukimin formal të fëmijëve të tyre plotëson dhe njeh rolin e tyre qendror në zhvillimin e fëmijës. Prindërit mund të ngurojnë për t'iu qasur shkollës e fëmijës së tyre. Në veçanti, kjo mund të jetë një çështje për prindërit nga grupet etnike minoritare, ose prindërit, gjuha e parë e të cilëve nuk është e njëjtë me atë që mësohet në shkollë.

Në mënyrë që të përmirësohet kontakti i shkollës me të gjithë prindërit dhe komunitetin më të gjerë, shkolla mund të konsiderojnë:

- Hulumtimin e mënyrave të adresimit të frikës së prindërve dhe shqetësimet mund të fillojë nga rekomandimet e mëposhtme:
 - Sigurimi i mundësive për takime joformale të stafit dhe të prindërve dhe vendosjen e kontakteve prind-mësimdhënës, që ofron mundësi për të diskutuar dhe për të kuptuar pikat e njëri-tjetrit të mendimit;
 - Dhënia e informacionit për prindërit, në një mënyrë që merr parasysh ekzistencën e një shumëllojshmëri të niveleve të shkrim-leximit, si dhe

diversitetin kulturor dhe gjuhësor, për shembull takime prind-mësimdhënës, të ftuarit e prindërve në shkollë për ngjarje të veçanta.

Udhëzime për monitorimin dhe vlerësimi

Zbatimi i një plani të shkollës duhet t'i përfshijë procedurat për monitorim, shqyrtim dhe vlerësim deri në një datë të caktuar.

Procesi i monitorimit dhe vlerësimit duhet të përfshijë:

- Reflektimin individual;
- Ekipin ose sesionet e grupeve;
- Takimet e të gjitha palëve me interes.

Vlerësimi formues duhet të shihet si një mënyrë për ta mbështetur zbatimin efektiv dhe efikas të procesit të zhvillimit të shkollës.

Pasi të jetë zhvilluar një plan i veprimit, anëtarë e komunitetit të shkollës do të angazhohen në procesin e zbatimit.

Zbatimi i suksesshëm duhet të kontribuojë drejt:

- Promovimit të një vetëdijesimi më të madh të përfshirjes shoqërore dhe arsimimit ndërkulturor;
- Ndhmës që u jepet të gjithë fëmijëve për t'i integruar në shkollë;
- Promovimit të një mjedisi mësimor mbështetës dhe gjithëpërfshirës;
- Përfshirjes së prindërve dhe e komunitetit më të gjerë;
- Ndërtimit të koalicioneve ndërmjet mësimdhënësve, nxënësve, prindërve dhe palëve të jashtme me interes për ta reduktuar braktisjen ose arritjet e vogla.

Sqarimi i detyrave, objektivave, faktorëve dhe treguesve të suksesit, dhe një kornizë kohore do ta ndihmojë shkollën që ta transformojë planifikimin gradualisht në praktikë të mirë.

Është me rëndësi që t'i identifikojë fushat me prioritet, të cilat do ta ndihmojnë kulturën shkollërore të bëhet më gjithëpërfshirëse dhe ndërkulturore, pasi që puna në këto fusha po arrin progres.

Pasi që procesi i zhvillimit të shkollës është ciklik, ky proces i vlerësimit do të paraqesë një hap të mëtejshëm të planifikimit dhe zbatimit që mund të ndodhë, pasi që në procesin e zbatimit shfaqen sfida të reja dhe kanë nevojë për vëmendje.

Zbatimi duhet të jetë fleksibil për t'iu përgjigjur çështjeve të reja dhe ndryshimit të rrethanave në të njëjtën kohë duke i mbetur besnik misionit për gjithëpërfshirje shoqërore.

Si të organizohet një proces i vlerësimit pjesëmarrës?

Pas disa muajsh pune është koha për t'u ndalur dhe shikuar prapa në at që është bërë dhe që është arritur, si dhe të shikohet se si është situata e tanishme. Ky është vlerësimi. Kjo është sikur ta shtypësh pullën për kthim mbrapa të ekzekutuesit të videos për ta parë përsëri filmin se çfarë ka ndodhur dhe si të shikosh në pasqyrë për të parë se si dukesh tani (si një grup i palëve me interes).

Ndër palët kyçe me interes për përfshirje mund të konsideroni:

- Të gjithë mësimdhënësit/et që marrin pjesë në trajnim;
- Drejtori i shkollës;
- Përfaqësuesit e prindërve, duke i përfshirë prindërit nga grupet etnike minoritare;
- Përfaqësuesin e Drejtorisë Komunale për Arsim;
- OJQ-n lokale ose qendrën mësimore;
- Ndërmjetësuesin arsimor,

Duke e pasur parasysh kontekstin e punës suaj specifike, mund të vendosni që t'i përfshini vetëm disa nga të lartpërmendurit ose shtoni palë të tjera me interes.

Objektivi i vlerësimit është përmirësimi i punës dhe i bashkëpunimit në të ardhmen.

Qëllimi i vlerësimit

Nuk është ...


- Gjetja se kush ka bërë punë të mirë e kush jo;
- Identifikimi se kush është fajtor për mosarritje të rezultateve të pritura;
- Dëshmimi se gjithçka është perfekt dhe që keni bërë punë të mirë.

Është...

- Shqyrtimi i aktiviteteve dhe identifikimi se çfarë pune u bë mirë dhe çfarë nuk u bë;
- Reflektimi për atë se çfarë është bërë dhe mësimi nga sukseset dhe dështimet;
- Matja e rezultateve të punës dhe vendosja e bazës për planifikim të ciklit të ardhshëm të aktivitetit.

Vlerësimi është një proces që duhet të **planifikohet dhe përgatitet**. Objektivat e tij arrihen më së miri nëse ky është **proces participues** në të cilin palët e ndryshme përkatëse me interes përfshihen aktivisht.

Diagrami më poshtë mund të ndihmojë në strukturimin e planifikimit të vlerësimit. Ai po ashtu tregon se si ky proces mund të gjenerojë fuqizim të ekipit të mësimdhënësve të angazhuar aktivisht në proces dhe t'i motivojë ata që të vazhdojnë me punën.



Duhet të bëni planifikimin e vlerësimit së bashku, si ekip. Mund të dëshironi të organizoni **një takim me disa palë kyçe me interes**, njerëz që e njohin situatën, punën e bërë dhe të cilët janë përfshirë në procesin e planifikimit. Së bashku, duhet t'i gjeni përgjigjet për pyetjet në vijim:

Çfarë do të vlerësohet?

Janë dy elemente për t'i shikuar:

- (a)aktivitetet në Planin e zhvillimit të shkollës, dhe
- (b)ndikimin e këtyre aktiviteteve në shkollë, fëmijët dhe në bashkëpunimin me prindërit.

Mund edhe të dëshironi të shikoni në më shumë çështje specifike, si vijueshmëria e shkollës nga fëmijët romë/ashkalinjë/egjiptianë, bashkëpunimi me qendrën mësimore, aktivitetet ekstrakurrikulare, vijueshmëria e prindërve në aktivitetet shkollore, rezultatet e shkollës së fëmijëve të grupeve etnike minoritare ose të kthyer, marrëdhëniet dhe qëndrimet në shkollë ndërmjet fëmijëve, etj.

Çfarë janë objektivat e vlerësimit?

Këtu duhet ta përkufizoni më saktësisht se çfarë dëshironi nga vlerësimi, në bazë të deklarimeve të përgjithshme, me qëllim të vlerësimit të të lartpërmendurave.

Çfarë metodash dhe instrumentesh do të përdoren për të mbledhur informata?

Do të keni nevojë që të mblidhni fakte (çfarë është bërë), shifra (numra, përqindje, etj.), dhe mendime/perceptime/qëndrime, nga palët e ndryshme me interes në komunitetin dhe institucionin(et). Nga e merr këtë informatë? Si? Kush mund të kontribuojë? Mund të vendosni që t'i përkufizoni disa pyetje, të cilat ua parashtroni prindërve dhe të keni një anëtar të ekipit që të bëjë një vështrim ose përmbledhje të përgjigjeve, etj.

Çfarë normash dhe standardesh duhet të merren parasysh?

Janë disa elemente që duhet t'i merrni parasysh kur ta planifikoni këtë proces, për shembull: kërkesat ligjore, procedurat administrative të sistemit arsimor, kufizimet e qasjes në disa të dhëna personale, etj. Në disa raste, për shembull, për t'iu parashtruar pyetje fëmijëve, keni nevojë për pajtim nga ana e prindërve.

Kush do të përfshihet në procesin e vlerësimit?

Një vendim shumë i rëndësishëm është kë do ta ftoni që të marrë pjesë në takimin e vlerësimit. Është me rëndësi që të mos përfshini tepër njerëz, por të keni një grup që i përfaqëson kategoritë kryesore të palëve me interes.

Kush do të jetë fasilituesi i procesit?

Takimi i vlerësimit ka nevojë për dikë që të veprojë si fasilitues ose moderator, që të sigurohet se secili flet, që asnjëri nuk e monopolizon diskutimin, që qëndrimi është pozitiv dhe konstruktiv, që intervenimet nuk po devijojnë nga lënda, etj. Ky mund të jetë njëri nga anëtarët e ekipit, por ky mund të jetë edhe dikush tjetër që i besoni, mundësisht dikush nga një OJQ me të cilin punoni.

Çfarë burimesh dhe sa kohë do të jetë e nevojshme dhe si mund ta rrisim efikasitetin?

Listo atë që keni nevojë për mbledhje të informatave dhe për takim të vlerësimit (salla, etj.). Vlerëso se sa kohë do t'ju nevojitet që ta përgatitni takimin (mblidhni dhe organizoni informatat) dhe sa duhet të zgjasë takimi.

Çfarë lloji të rezistencës mund të presim dhe si ta tejkalojmë atë?

Duke i njohur njerëzit që i ftoni dhe temën për diskutim, mendoni se çfarë mund të shkojë keq, çfarë kundërshtimi mund të paraqitet në grup dhe si mund ta kundërshtoni këtë.

Sapo të jetë gati plani, duhet të siguroheni se ky do të zbatohet dhe se brenda një kohet të arsyeshme do të keni informata të mbledhura dhe të organizuara dhe se gjithçka të përgatitet për takimin e vlerësimit.

Kur të jenë gati informatat, e thirrni takimin e vlerësimit, sipas planit të përkufizuar gjatë takimit të planifikimit të vlerësimit. Pjesëmarrësit do të jenë njerëzit të cilët kanë marrë pjesë drejtpërdrejt në aktivitete që kanë të bëjnë me planin e zhvillimit të shkollës por edhe të tjerë.

Fasilituesi i takimit do të fillojë duke e specifikuar objektin dhe objektivat e vlerësimit, që të gjitha diskutimet në grup do të mbesin konfidenciale, që pritet nga ta të krijojnë një kuptueshmëri më të mirë dhe një analizë konstruktive të punës së bërë dhe të situatës aktuale, dhe që secili person duhet të fokusohet në fushën e vet të përgjegjësisë dhe jo t'i fajësojë të tjerët. Të gjitha mendimet do të dëgjohen dhe do të konsiderohen të rëndësishme nëse formulohen në mënyrë të respektueshme dhe konstruktive.

Pastaj, grupi i shqyrton dhe diskuton informatat e mbledhura, duke i marr parasysh faktet dhe mendimet. Konkluzionet pastaj do të formulohen, duke nxjerr në pah se çfarë është përmirësuar, çfarë u punua mirë, çfarë nuk u punua mirë dhe cilat janë temat me prioritet për t'u fokusuar në të ardhmen.

Pastaj, grupi do të vendos edhe për atë se çfarë informata nga diskutimet do t'iu komunikohen të tjerëve jashtë grupit. Sapo të vendoset për këtë, grupi do t'i identifikojë mënyrat më të mirë për t'ua komunikuar rezultatet atyre që mund të jenë të interesuar.

Duke e përdorur një qasje të tillë ju, si ekip, do të:

- Fitoni një imazh më të qartë të rezultateve të punës së bërë;
- Merrni mbështetje shtesë brenda shkollës dhe nga institucionet ose OJQ-të partnere.

Njohuritë kyçe për diversitetet dhe gjithëpërshirje shoqërore²

Njohuritë dhe të kuptuarit	Komunikimi dhe marrëdhëniet	Menaxhimi dhe mësimdhënia
Njohuria 1 Njohuritë dhe të kuptuarit e kontekstit politik, ligjor dhe strukturor të diversitetit socio-kulturor	Njohuria 7 Inicimi dhe mbështetja e komunikimit pozitiv me nxënësit, prindërit dhe kolegët nga përkatësitë e ndryshme socio-kulturale	Njohuria 13 Adresimi i diversitetit socio-kulturor në kurrikulë dhe zhvillim institucional
Njohuria 2 Njohuri për kornizat ndërkombëtare dhe të kuptuarit e parimeve kyçe që kanë të bëjnë me arsimimin e diversitetit socio-kulturor	Njohuria 8 Pranimi dhe përgjigja ndaj aspekteve komunikative dhe kulturore të gjuhës(ve) të përdorur në shkollë	Njohuria 14 Krijimi i një mjedisi mësimor participues, gjithëpërfshirës dhe të sigurt
Njohuria 3 Njohuritë për dimensione të ndryshme të diversitetit, p.sh. etnia, gjinia, nevojat e veçanta dhe të kuptuarit e implikimeve të tyre në parametrat e shkollës	Njohuria 9 Krijimi i mendje-hapjes dhe respektit në komunitetin e shkollës	Njohuria 15 Përzgjedhja dhe ndryshimi i metodave të mësimdhënies për nevojat e mësimnxënies së nxënësve
Njohuria 4 Njohuritë e fushëveprimit të qasjeve, metodave dhe materialeve për mësimdhënie që i përgjigjen diversitetit	Njohuria 10 Motivimi dhe stimulimi i të gjithë nxënësve që të angazhohen në mësimnxënie individualisht dhe në bashkëpunim me të tjerët	Njohuria 16 Vlerësimi kritik i diversitetit brenda materialeve për mësimdhënie, p.sh. librat e mësimi, videot, mediet
Njohuria 5 Shkathtësitë për hulumtim në çështje të ndryshme socio-kulturale	Njohuria 11 Përfshirja e të gjithë prindërve në aktivitetet shkollore dhe vendim-marrje kolektive	Njohuria 17 Aplikimi i një llojllojshmërie të qasjeve për mësimdhënie të ndjeshme kulturore dhe vlerësim
Njohuria 6 Reflektimi në identitetin e vet personit dhe trajtimin e diversitetit	Njohuria 12 Trajtimi i konflikteve dhe dhunës për të parandaluar marginalizimin dhe dështimin e shkollës	Njohuria 18 Reflektimi sistematik dhe vlerësimi i vet praktikimit si dhe ndikimi i vet në nxënësit

² Ky dokument është një ekstrakt i publikimit të 3^{të} “Policies and practices for teaching sociocultural diversity- A framework of teacher competences for engaging with diversity” (Politikat dhe praktikatat për mësimdhënie të diversitetit socio-kulturor-Korniza e kompetencave të mësimdhënësve për trajtim të diversitetit) të Këshillit të Evropës.

Veprimtari praktike

1. Prezantimi me pesë gishta

Madhësia e grupit: Çdo lloj madhësie–nxënësit do bëjnë punë individuale në fillim

Koha: 20 minuta–koha do të varet nga numri i pyetjeve që keni vendosur të përdorni

Pajisjet e nevojshme: Fletëshpërnarëset memudhëzimet për grupet

Hapësira e nevojshme: Klasë

Përshkrimi i aktivitetit:

- Çdo person skicon dorën në një letër;
- Mësimdhënësi drejton 5 pyetje, një nga një dhe përgjigjet duhen vendosur mbi secilin gisht, duke e nisur nga i madhi. (Shih listën e pyetjeve të mundshme në aktivitetet e mësipërme);
- Pasi përfundohet, të gjithë nxënësit çohen nga karriget dhe ecin qetësisht në klasë, derisa dëgjojnë një sinjal nga mësimdhënësi;
- Në këtë pikë, nxënësit bëhen dyshe me personin më afër tyre dhe shkëmbejnë informacionin e shënuar në “dorën” e tyre.

Pyetjet e sugjeruara për reflektim:

Përmbajtja (të nxënit kognitiv).

- Çfarë mësuat rreth mikut/partnerit tuaj?
- Cilat ishin gjërat më të përbashkëta nga ato që ndatë?
- Si mund ta përdorim ndryshe organizuesin me pesë gishta?

Shprehi sociale (të nxënit social)

- Pse është me rëndësi të jeni përballë me mikun/partnerin tuaj të skuadrës kur flisni me të?
- Si ju bën të ndiheni kur dikush ju dëgjon?
- Si do të ndiheshit, në rast se do të flisnit dhe personi nuk do ju dëgjonte?

Të nxënit personal

- Si u ndjetë kur u çuat dhe ecët rrotull klasës?
- Përse ka rëndësi të njihni çdo student në klasë?
- Cilat janë aftësitë unike për të cilat jeni krenarë si rezultat i këtij aktiviteti?

2. Ky/kjo jam unë

	<p><u>Emri im është:</u></p> <p><u>Kaq vjërç jam unë:</u></p> <p><u>Kaq i gjatë jam unë:</u></p>
<p><u>Këto gjuhë flas unë:</u></p> <p><u>Këtë mund të bëj unë mirë:</u></p> <p><u>Ky është ushimi im i preferuar:</u></p> <p><u>Kjo më bën mua të lumtur:</u></p> <p><u>Ky është vendi im i preferuar:</u></p> <p><u>Kjo është loja ime e preferuar:</u></p> <p><u>Ky është personazhi im i preferuar vizatimor:</u></p> <p><u>Këtë gjë dua unë të mësoj:</u></p> <p><u>Këtë dëshiroj unë t'ju sjell mësuësve të mi:</u></p> <p><u>Kjo/ Ky dëshiroj unë të bëhem:</u></p> <p><u>Kjo është dëshira ime më e madhe:</u></p>	

3. Njihuni (Të gjitha grupmoshat)

Madhësia e grupit: klasë e çdo madhësie

Koha: 20 minuta

Pajisjet e nevojshme: Flete e formatit “Njihuni” (*Get Acquainted*), laps ose stilolaps

Hapësira e nevojshme: klasë

Përshkrimi i aktivitetit:

Shih Fletën e formatit “Njihuni” për një kampion të fletës së të dhënave. Numri i pyetjeve dhe përmbajtja mund të ndryshohen sipas grupmoshës së studentëve. Për nxënës më të vegjël mund të përdoren foto.

Fleta “Njihuni”

Emrat dhe fytyrat vihen krahas krahas sapo të jeni takuar me shokët e klasës, por ju dini shumë pak për shokët, nëse u dini vetëm emrat.

Zbuloni informacion për shokët e klasës duke plotësuar hapësirat më poshtë me emrat e shokëve. Përpiquni të gjeni një person të ndryshëm për çdo përshkrim.

Gjeni një shok/shoqe klase, i/e cili/a...

- ✓ I ka sytë blu?
- ✓ Ka dy vëllezër?
- ✓ Ka udhëtuar në një vend tjetër?
- ✓ E ka prindin mësimdhënës?
- ✓ I pëlqen të luajë futboll?
- ✓ Preferon të njëjtin program televiziv si ju?
- ✓ Ka më shumë se një kafshë shtëpiake?
- ✓ I pëlqen të lexojë?
- ✓ Do muzikën?
- ✓ I pëlqen pica?
- ✓ Ka vjollcën ngjyrë të preferuar?
- ✓ E ka ditëlindjen në shtator?
- ✓ I pëlqejnë kompjuterët?
- ✓ Jeton më shumë sesa një km larg shkollës?
- ✓ Është fëmija i vetëm në familje?
- ✓ Vjen me autobus në shkollë?
- ✓ Është artist i mirë?
- ✓ Flet një gjuhë tjetër?
- ✓ Ka stërgjyshër?

Krijoni një tjetër përshkrim dhe gjejnë shokë nga klasa që përputhen me të.

Pyetje reflektuese të sugjeruara:

Përmbajtja (të nxënit kognitiv)

- Çfarë zbuluar për shokun tuaj të klasës?
- Pse ka rëndësi të njiheni me nxënësit e tjerë në klasë?

Shprehitë sociale (të nxënit social)

- Nga e dini që të tjerët po dëgjonin kur folët ju?
- Si e ndihmoi ky aktivitet klasën tonë që të njihej më mirë?
- Ç'aftësi përdori grupi juaj për ta zhvilluar aktivitetin me sukses?

Të nxënit personal

- Çfarë ndjetë kur po flisnit ose dëgjonit?
- Çfarë cilësish zbuluat te vetja?
- Çfarë ju pëlqeu më shumë nga ky aktivitet?

4. Historia e emrit tënd (të gjitha grupmoshat)

Madhësia e grupit: e pakufizuar

Koha: 10 minuta

Pajisjet e nevojshme: Fleta "Njihuni" (*Get Acquainted*), laps ose stilolaps

Hapësira e nevojshme: klasa

Përshkrimi i aktivitetit:

Cila është origjina e emrit tënd? Tregoni historinë se nga vjen emri juaj dhe çfarë kuptimi ka. Emri i çdonjërit ka një origjinë çuditërisht interesante. Kjo ndihmon për krijimin e respektit dhe mirëkuptimit ndërkulturor.

Çfarë ka në një emër? Më shumë sesa shpesh mendojmë. Kjo është një mënyrë e re interesante me të cilët njerëzit iu prezantohen të tjerëve, sidomos, në grupe me larmi etnike.

Ju mund të përgatitni mësimin duke i ftuar nxënësit të pyesin prindërit për kuptimin e emrave të tyre dhe arsyen përse e kanë zgjedhur këtë emër.

1. Sigurohuni që të krijoni një atmosferë të përshtatshme në grup, duke bërë që njerëzit të kenë zhvilluar disa aktivitete fillestare për nxehje dhe lojëra me emra.
2. Kërkojuni pjesëmarrësve të kthehen nga partneri dhe t'i shpjegojnë kuptimin e emrit (nëse ka) dhe origjinën.
3. Shumica e njerëzve zbulojnë shumë informacione interesante lidhur me origjinën dhe kuptimin e emrit.
4. Sa më e madhe të jetë larmia etnike dhe kulturore në grup, aq më mirë priret të funksionojë ushtrimi.
5. Mund të përdoret specifikisht për të ndihmuar në ndërtimin e respektit dhe mirëkuptimit ndërkulturor ose, më në përgjithësi, për të ndihmuar në zhvillimin e identitetit vetjak dhe respektin e hapur dhe ndarjen e gjërave.
6. Alternativë: Kërkojini secilit të prezantojë prindërit e tij/saj për të gjithë grupin dhe të shpjegojë çfarë kuptimi ka emri i tij/saj dhe cila është origjina e tij.

Pyetje të sugjeruara për reflektim:

Përmbajtje (të nxënit kognitiv)

- Çfarë zbuluar rreth shokut të klasës?

Shprehje sociale (të nxënit social)

- Si e kuptuat që të tjerët po ju dëgjonin ndërkohë që flisnit?

Të nxënit për veten

- Çfarë ndjetë kur po flisnit ose dëgjonit?
- Çfarë ju pëlqeu nga ky aktivitet?

5. Topa bore (Të gjitha grupmoshat)

Madhësia e grupit: çdo madhësi

Koha: 10 minuta

Pajisjet e nevojshme: Fletë letre, laps ose stilolaps

Hapësira e nevojshme: klasa

Përshkrimi i aktivitetit:

Shpërndajuni të gjithëve nga një fletë të bardhë. Emri i tyre shkruhet në mes të letrës dhe fleta ndahet në tri pjesë. Në seksionin 1 kërkojuni të shkruajnë një gjë për të cilën ndihen entuziastë, në seksionin 2 diçka për të cilën ndihen nervozë dhe, së fundi, në seksionin 3, diçka që do iu pëlqente të mësonin. (Nëse nuk janë në gjendje të shkruajnë, mund të vizatojnë).

Bëjini shuk fletët dhe i thoni gjysmës së klasës të gjuajnë me topat e borës të krijuar. Gjysma tjetër e klasës i kap topat e borës dhe lexon informacionin. Më pas, ata duhet të gjejnë se kujt i përket informacioni. Kjo bën të mundur që të përshëndeten dhe ta diskutojnë informacionin më tej.

Kjo është një mënyrë shumë e mirë që të njohin njëri-tjetrin dhe të shohin se cilat janë frikërat dhe pritshmëritë e vërteta të tyre. Në fund të vitit, kjo është ajo që mbajnë më shumë mend.

Pyetje të sugjeruara për reflektim:

Përmbajtje (të nxënit kognitiv)

- Pse ka rëndësi që anëtarët e skuadrës të ndajnë informacion për veten e tyre?
- A ka pyetje të tjera të mira që mund të drejtojmë?

Shprehi sociale (të nxënit social)

- Si e kuptuat që të tjerët po ju dëgjonin kur flisnit?

Të nxënit për veten

- Çfarë ndjetë kur po flisnit apo po dëgjonit?
- Çfarë ju pëlqeu më shumë nga ky aktivitet?

6. Poezi autobiografike (grupmosha 11 vjeç e lart)

Madhësia e grupit: e çfarëdoshme

Koha: 30 minuta

Pajisjet e nevojshme: letër, laps ose stilolaps, 10 rreshta informacion që duhet përfshirë

Hapësira e nevojshme: klasë

Përshkrimi i aktivitetit: Ditën e parë të shkollës, u thoni nxënësve që detyra e tyre e parë është të shkruajnë një poezi. Kur ta thoni këtë, do dëgjoni psherëtima e ankesa, duke qenë se mund të jetë edhe ora e matematikës. Thuajuni që do të jetë poezia më e thjeshtë që kanë shkruar ndonjëherë, sepse do të jetë mbi ta.

- Vargu i parë është emri i tyre;
- Vargu i dytë ka tri fjalë që përshkruajnë ata vetë;
- Vargu i tretë është tri gjërat që iu pëlqejnë;
- Vargu i katërt është tri gjërat që nuk iu pëlqejnë;
- Vargu i pestë është tri filmat që kanë parë (mund ta bëni edhe për librat që kanë ;
- Lexuar, por për filmat, zakonisht, reagojnë më mirë);
- Vargu i gjashtë ka të bëjë me gjërat që presin me padurim...;
- Vargu i shtatë ka tri gjëra që iu pëlqejnë rreth shkollës;
- Vargu i tetë ka objektivat që kanë;
- Vargu i nëntë është vendi që duan të vizitojnë;
- Vargu i dhjetë është mbiemri i tyre. Ju mund t'i rregulloni këto vargje për t'ia përshtatur klasës.

Kujtojini nxënësit që të ruajnë përmbajtjen. Mblidhini poezitë, Të nesërmen mund t'i lexoni dhe të kërkonte nga nxënësit të gjejnë se me cilin nxënës lidhet poezia. Kur t'i lexoni poezitë me zë të lartë, hiqni vargun e parë e të fundit.

Pyetjet e sugjeruara për reflektim:

Përmbajtja (të nxënës kognitiv)

- Përse ka rëndësi për anëtarët e skuadrës të ndajnë informacion rreth tyre?
- A ka ide të tjera të mira që mund të ishin përfshirë?

Të nxënës për veten

- Çfarë ju pëlqeu më shumë nga ky aktivitet?
- Si u ndjetë kur e ndatë këtë informacion?

7. Çanta e shpinës për t'u kthyer në shkollë (të gjitha grupmoshat)

Madhësia e grupit: çfarëdo

Koha: 10 minuta

Pajisjet e nevojshme: çantë shpine me “gjëra rreth teje”

Hapësira e nevojshme: hapësira e lirë e klasës ose nxënësit në banka

Përshkrimi i aktivitetit:

Prezantohuni përpara klasës duke sjellë njëçantë shpine në shkollë. Në të vendosni disa gjëra që tregojnë diçka për ju: libri i preferuar, një foto të familjes, diçka me vlerë për ju, një pikturë që keni bërë, etj.

Pasi nxënësit të kenë arritur, ulini në dysheme që të njihen me njëri-tjetrin. Fillojeni nga vetja duke nxjerrë objektet një nga një dhe duke thënë se ç’lidhje kanë ato me ju. Sigurohuni që nxënësit janë në gjendje t’i mbajnë objektet, që të mund t’i kaloni nga dora nëdorë. Kur të keni mbaruar filloni edhe njëherë t’i kërkonit secilit nxënës në rreth të ndajë një gjë rreth vetes.

Disa mësimdhënësi e dërgojnëçantën e shpinës çdo ditë në një shtëpi, derisa të gjithë ta kenë pasur ditën e tyre. Nxënësi i zgjedhur për ta marrëçantën e shpinës në shtëpi e kthen me dy ose tre gjëra më shumë dhe i ndan ato me klasën.

Pyetje të sugjeruara për reflektim:

Përmbajtje (të nxënësve kognitiv)

- Përse ka rëndësi për pjesëtarët e skuadrës të ndajnë informacion për veten?
- Çfarë mësuar?
- Çfarë pyetjesh do të donit të më bënit?

Shprehi sociale (të nxënësve social)

- Pse është të dëgjuarit një shprehi e rëndësishme?

Të nxënësve për veten

- Çfarë ju pëlqeu nga ky aktivitet?

8. Rrugëtim përmes shkollës (10 vjeç e lart)

Madhësia e grupit: çfarëdo

Koha: 30 minuta

Pajisjet e nevojshme: fletë e madhe letre (A4, A3), shënjuer

Hapësira e nevojshme: hapësira e lirë e klasës ose nxënësit në banka

Përshkrimi i aktivitetit:

1. Ndani grupet në 4-she.

2. Shpërndajini nga një fletë dhe lapsa ose lapostila secilit prej nxënësve dhe i thoni të vizatojnë një ilustrim pamor me temën, “shkollimi im deri tani” një rrugë me kthesa, kodra e lugina. Përfshi “tabela rrugësh”, “emra vendesh” dhe etiketa ngjarjesh, njerëzish, vendesh e objektesh.

3. Ftoni secilin prej nxënësve të ndajë “Rrugëtimin përmes shkollës” me shokët e tij/saj të skuadrës.

4. Kërkojuni nxënësve të dëgjojnë me respekt dhe në mënyrë aktive secilin prej folësve. Inkurajojini pjesëtarët e ekipës të bëjnë pyetje pas çdo prezantimi, për të mësuar më shumë hollësi dhe të shprehin ndjenjat apo shqetësimet reciproke.

Pyetjet e sugjeruara për reflektim:

Përmbajtje (të nxënësve kognitiv)

- Përse është e rëndësishme të mund të vizatohet një “Hartë jete”?
- Sa të ngjashme ishin hartat në ekipin tuaj?

Shprehje sociale (të nxënësve social)

- Si mund ta dalloni që anëtarët e ekipit ishin dëgjues të mirë kur të tjerët ndanin “Hartën e jetës” që kishin vizatuar?
- Si e ndihmuan anëtarët e ekipit njëri-tjetrin gjatë këtij aktiviteti?

Të nxënësve për veten

- Si u ndjetë gjatë vizatimit të hartës së jetës/kur e ndatë me ekipin tuaj?
- Çfarë mësuar për veten?
- Çfarë ju bën ju një person unik dhe të veçantë?

9. Le të formojmë grupe (të gjitha grupmoshat)

Madhësia e grupit: çfarëdo

Koha: 20 minuta ose sa më shumë kohë që mund të keni

Pajisjet e nevojshme: Projektor me udhëzime për formimin e grupit

Hapësira e nevojshme: klasa

Përshkrimi i aktivitetit:

Kjo është një lojë për formimin dhe riformimin sa më shpejt të grupeve. Mësimdhënësi/ja e udhëzon grupin me anë të një sinjali të formojë grupe më të vogla, në bazë të disa kriterëve që i janë thënë më parë grupit. Objektivi është që sa më shumë njerëz të prezantohen me sa më shumë të tjerë që të jetë e mundur. Loja nuk është e konceptuar për të parë sesa shpejt apo me sukses mund t'i përmbushë grupi udhëzimet e mësimdhënësit/et /ses. Mësimdhënësi/ja duhet t'i japë grupit kohë të mjaftueshme për t'u ndarë në skuadra dhe për t'u prezantuar me njëri tjetrin, nëse e kërkon aktiviteti në skuadër.

Është me rëndësi që aktiviteti të zhvillohet me ritëm të shpejtë. Shembuj:

1. Ndahuni në grupe prej tre vetash dhe prezantohuni;
2. Ndahuni në grupe prej pesë vetash dhe prezantohuni;
3. Ndahuni në një grup prej dy vetash, që kanë bluza me "të njëjtën" ngjyrë dhe prezantohuni;
4. Ndahuni në grupe prej tre vetash që kanë interesa "të njëjta" ose të ngjashme dhe prezantohuni;
5. Ndahuni në grupe me persona emrat e të cilëve kanë të njëjtën zanore të parë në emrin e tyre dhe ndani emrin me ata;
6. Ndahuni në grupe prej katër vetash që keni lindur në të njëjtën stinë (vjeshtë, dimër, pranverë, verë);
7. Në grupin që ka stinën tuaj, organizohuni sipas datëlindjes (dita, muaji);
8. Mendoni për shifrën e fundit të numrit të telefonit dhe bashkohuni në grup me këdo që ka të njëjtën shifër të fundit;
9. Gjeni një person tjetër, i cili jeton në rreth të njëjtën largësi nga shkolla si edhe ju;

Pyetjet e sugjeruara për reflektim:

Përmbajtje (të nxënësve kognitiv)

- Pse është me rëndësi të ndaheni shpejt në grupe?
- Pse është me rëndësi të njiheni me nxënësit e tjerë të klasës?

Shprehjet sociale (të nxënësve social)

- Si e ndihmoi ky aktivitet klasën për t'u njohur më mirë?
- Cilat janë disa nga përfitimet e të punuarit me të tjerë, më shumë se vetëm?

Të nxënësve për veten

- Çfarë ndjetë kur po flisnit ose dëgjoni?
- Çfarë ju pëlqeu më shumë nga ky aktivitet?

10. Rreshtimi sipas alfabetit (të gjitha grupmoshat)

Madhësia e grupit: klasa

Koha: 5-10 minuta

Pajisjet e nevojshme: Asnjë

Hapësira e nevojshme: perimetri i klasës

Përshkrimi i aktivitetit:

1. Fëmijët rreshtohen në mënyrë që emrat/mbiemrat e tyre të bien në rend alfabetik
2. Më pas, ata formojnë grupe rastësore të çfarëdolloj madhësie duke numëruar.

Pyetje për diskutim gjatë kohës që janë të rreshtuar (Përpiquni të hartoni pyetje që janë interesante, lidhen me objektivat e mësimit dhe që nxënësit do t'i "marrin për zemër").

- a) Cili është vendi yt më i preferuar në të gjithë botën? Pse?
- b) Nëse do ju duhej të hiqnit dorë nga një ushqim i preferuar, nga cili do ta kishit më të vështirë?
- c) Cili është ai ushqim që nuk do të donit ta provonit kurrë përsëri?
- d) Nëse do të fitonit një biletë lotarie dhe do të kishit një milion dollarë, çfarë do të bënit me to?
- e) Ju është dhënë mundësia të përdorni makinën e kohës. Nëç'vend dhe kohë do të donit të udhëtonit?
- f) Nëse do të mund të ishit një superhero dhe të kishit superfuqi, cilat do të ishin këto dhe pse?
- g) Çfarëçmimi do të donit të fitonit dhe për cilën arritje?
- h) Nëse mund tëtransportoheni diku në këtë moment, ku do të shkonit dhe pse?
- i) Sipas jush, cila është kafsha më e mirë (ose më e bukur) dhe pse?
- j) Cili është ai objekt që duhet ta hidhni vërtet poshtë, po ka të ngjarë që s'do e bëni kurrë?
- k) Cilat ishin lodrat tuaja të preferuara me të cilat luanit kur ishit i vogël?
- l) _____

Për fëmijët më të vegjël:

1.Si quheni (emër, mbiemër)?	11.Cila është lënda juaj e preferuar në shkollë?
2.Kur e keni ditëlindjen?	12.Cila është pica që ju pëlqen më shumë?
3.Nëç'vend keni lindur?	13.Cili është pasioni juaj i preferuar?
4.Sa motra keni?	14.Cilat janë pushimet tuaja të preferuara?
5.Sa vëllezër keni?	15.Sa gjuhë flisni?
6.Cili është ushqimi juaj i preferuar?	16.Çfarë doni të bëheni kur të rriteni?
7.Cili është sporti ose loja juaj e preferuar?	17.Nëse do të udhëtonit kudo në univers, ku do të donit të shkonit?
8.Cila është kafsha juaj e preferuar?	18.Sa libra lexuat verën e kaluar?
9.Cili është emisioni juaj televiziv i preferuar?	
10.Cili është filmi juaj i preferuar?	

11. Intervista në çift (mosha 10+)

Madhësia e grupit: çfarëdo

Koha: 20 minuta. Koha do të varet nga numri i pyetjeve të intervistës që vendosni të përdorni

Pajisjet e nevojshme: projektor me udhëzimet për formimin e skuadrave

Hapësira e nevojshme: klasa

Përshkrimi i aktivitetit:

Pjesëtarët ndahen në grupe me dy veta dhe intervistojnë njëri-tjetrin. Pyetjet që mund të përdoren:

1. Kush mendoni është personi më i rëndësishëm që ka jetuar gjatë 100 vjetëve të shkuar?
2. Cili është filmi më i bukur që keni parë së fundi?
3. Si e ka titullin libri i fundit që keni lexuar?
4. Nëse do të ishit çdo lloj kafshe në vend të njeriut, cila do të ishit?
5. Nëse do të mund të udhëtonit kudo në botë, ku do të shkonit?
6. Cili është sporti juaj i preferuar?
7. Një mbiemër që më përshkruan është ...
8. Emocioni që e kam më të vështirë ta kontrolloj është ...

Pyetje të sugjeruara për reflektim:

Përmbajtja (të nxënit kognitiv)

- Çfarë zbuluat për shokët e klasës?
- Pse është e vështirë t'u përgjigjesh disa pyetjeve?

Shprehi sociale (të nxënit social)

- Cilat shprehi sociale përdorët ju, si çift, për ta zhvilluar me sukses këtë aktivitet?
- Përse ka rëndësi të dëgjuarit me vëmendje gjatëkëtij aktiviteti?

Të nxënit për veten

- Si u ndjetë që u intervistuat?
- Çfarë mësuar për veten nga ky aktivitet?
- Cilat janë ato cilësi unike për të cilat jeni krenar, si rezultat i këtij aktiviteti?

Puna qarkore si strategji për përmirësim të komunikimit dhe ndërveprimit

12. Puna në rreth (klasa e parë dhe e dytë)

Ulja në një format qarkor nxit komunikimin e mirë dhe reflekton parimet e ndarjes, barazisë, gjithëpërfshirjes, dhe një ndjenjë të kujdesit për njëri-tjetrin. Secili fëmijë e ka mundësinë që të kontribuojë në diskutim dhe inkurajohet që t'i dëgjojë pikëpamjet e të tjerëve. Puna qarkore është e përshtatshme për të gjitha nivelet e klasës. Kjo është më efektive kur bëhet shpesh. Kjo u mundëson fëmijëve që të mësojnë se si të dëgjojnë, dhe se si t'i trajtoni të tjerët pozitivisht.

Puna qarkore në vetvete nxitë në veçanti angazhimin e fëmijëve në mendim kritik. Kjo i mundëson mësimdhënësit/et që të marrë pjesë në dialog me fëmijët dhe t'iu ndihmojë atyre që të gjejnë hipoteza dhe koncepte të ndryshme përmes parashtrimit të pyetjeve të duhura. Në këtë mënyrë fëmijët mund të mësojnë që t'i pastrojnë idetë e tyre, të gjejnë alternativa, dhe t'i bazojnë vendimet në faktorë të tjerë dhe jo në emocione ose në ndonjë qejf momental.

Disa çështje që mund të eksploroohen në punën qarkore janë:

- ✓ Cili është hobi, interesat tuaja?
- ✓ Cilat janë pikat tuaja të forta?
- ✓ Cilat janë talentat dhe interesimet tuaja?
- ✓ Çfarë mendoni për...?
- ✓ Pse mendoni se njerëzit veprojnë në këtë mënyrë?
- ✓ Si ndjeheni kur...?

Aktivitetet e tilla janë të rëndësishme deri në atë masë që

- ✓ Ndërtojnë një mjedis pozitiv, mbështetës në të cilin fëmijët mund të shprehin sinqerisht pa frikë, dhe mund të flasin përmes ideve dhe perceptimeve të tyre;
- ✓ Theksojnë rolin kyç të gjuhës duke iu mundësuar fëmijëve që të ballafaqohen me botën e tyre, si dhe duke zhvilluar një kuptueshmëri të asaj që përjetojnë dhe shohin;
- ✓ Trajtojnë çështjet emocionale në një mënyrë të sigurt dhe të përshtatshme për moshën e tyre;
- ✓ U mundësojnë fëmijëve që të diskutojnë dhe t'iu japin kuptim situatave në jetën reale dhe të zhvillojnë ndjeshmëri për të tjerët.

Shembulli i aktiviteteve rrethor kohor

Fëmijët ulen në një rreth dhe luten me radhë që ta përfundojnë fjalinë, „Unë jam i mirë në...“. Nëse një fëmijë nuk mund të mendojë për diçka, një fëmijë tjetër mund të japë vullnetarisht një sugjerim, ose mësimdhënësi mund të thotë diçka pozitive për fëmijën.

Fëmijët mund t'i shprehin vullnetarisht mendimet e tyre për talentët e tjerë që nuk janë përmendur, për shembull:

„ ... është vërtetë shok/shoqe i/e mirë“.

„ ... është vërtetë i mirë në mbajtjen në mend...“

Të gjithë emrat e fëmijëve vendosen në një kapelë, dhe emri i të cilit kapet, fëmija e përshkruan vetveten duke përdorur deklaratime pozitive. Edhe fëmijët e tjerë duhet të nxiten që të kontribuojnë me deklaratime pozitive, duke u siguruar se nuk jepet asnjë koment lëndues ose negativ.

Secili fëmijë kthehet në bankën e vet dhe i shkruan pesë gjëra pozitive për vetveten. Puna me shkrim mund të sjellët në shtëpi ose të bëhet pjesë e një portfolio.

Sugjerimi për punë individuale dhe grupe: identifikimi dhe përgatitja e 5 temave për punën qarkore të cilat mund t'i përdorini me nxënësit tuaj.

Gjatë përgatitjes, reflekto për pyetjet më poshtë:

1. Cilat tema mund ta zgjerojnë komunikimin ndërmjet fëmijëve nga komuniteti shumicë dhe pakicë?
2. Si të përdoren impulset vizuale, si fotografitë, vizatimet, gjësendet që mund t'i sjellin fëmijët?
3. Cila tema duhet të shmangen dhe pse?
4. Si mund t'i lidhni këto aktivitete qarkore me përmbajtjen tuaj të rregullt të mësimdhënies?
5. Çfarë zgjidhjesh të adaptohen nëse klasa është shumë e vogël?

10. Të punosh së bashku për të sjellë ndryshim

Fusha e programit mësimor	Tema	Objektivat
	Unë dhe bota e gjerë	Zhvillimi i nënshtetësisë
	Zhvillimi i aftësive kognitive nëpërmjet gjuhës	Me shkrim: Sqarimi i mendimeve me shkrim Gjuhë e folur: Zhvillimi i aftësive kognitive nëpërmjet gjuhës së folur

Niveli	Klasat e pesta dhe të gjashta por mund të përdoret me fëmijë të moshës 3-5 vjeçe
Synimet	Të ndihmojmë fëmijët që të njohin dhe kuptojnë rolin e individit dhe grupeve të ndryshme në komunitet
Qasje dhe metodika	Eksplorimi i komunitetit lokal, vendosja për kryerjen e veprimit të duhur, me shkrim. Nëpërmjet angazhimit në praktikë në kërkim për të sjellë ndryshimin, fëmijët vendosen në qendër të procesit të mësimnxënies. Nëpërmjet këtij procesi ata mund të mësojnë shprehitë e aktivizmit të duhur (të shkruash një letër, të dërgosh një peticion, të drejtosh pyetje, etj.) dhe mund të mësojnë se si t'i përballojnë pengesat gjatë rrugës (si shpërfillja nga ata që janë në pushtet), si edhe krijim i një ndjenje të qenit efikas përmes asaj çka arrijnë. Kjo qasje mund të zbatohet për një numër orësh mësimi
Metodika	1. Pyetini fëmijët që të identifikojnë diçka që duan ta ndryshojnë në mjedisin lokal. Diskutojini përgjigjet e tyre me ata, duke iu kërkuar të identifikojnë se cilat mund të ndryshohen realisht dhe cilat kanë përparësi më të madhe për ta. 2. Diskutoni me fëmijët se çfarë duhet ndryshuar saktësisht dhe si ndihen në lidhje me situatën aktuale. Krijoni një gamë fjalori që është e dobishme për ta për të shkruar një letër. 3. Vizatoni një hartë të komunitetit tuaj.
Veprimtari shtesë	Mund të trajtohen ndryshimet pozitive në mjedisin e fëmijëve apo nevoja për ndryshim. Fëmijët mund të eksplorojnë edhe forma të tjera aktivizmi, si të pikturojnë një poster në orën e Arteve apo të eksplorojnë një këngë në orën e Muzikës.

11. Kultura e shtëpisë

Fusha kurrikulare	Tema	Objektivat
	Unë	Vetëidentiteti
	Familja ime dhe unë	Familja ime

Niveli	Klasat e para dhe të dyta/ të gjitha moshat
Qëllimet	Të ndihmohen fëmijët që të vlerësojnë diversitetin kulturor nëpërmjet eksplorimit të objekteve që i përkasin botës së tyre të përditshme
Burimet	Mblidhen një larmi objektesh që përdoren në shtëpitë e fëmijëve: <ul style="list-style-type: none"> • Sendet që lidhen me flokët mund të përfshijnë lloje të ndryshme të furçave apo krehërave, kapëseve, karficave të flokëve, makinave të rrojës. • Objektet që lidhen me ushqimin mund të jenë enët e supës, drithërave ose orizit, pjata, pirunë, shkopinj, një tenxhere ose tigan. • Objektet që lidhen me punën mund të jenë kapele pune, doreza, kravatë, çantë për dokumentet
Metodologjia	1. Zbulohen funksionet e secilit prej sendeve. 2. U kërkohet fëmijëve që të gjejnë se pse ka një larmi kaq të madhe krehërash ose ushqimesh, për shembull. (veglat e ndryshme janë në përshtatje me llojin e flokëve apo lejojnë stile të ndryshme, në vende të ndryshme të botës rriten ushqime të ndryshme, etj.)
Shtrirja e aktiviteteve	Vendosen objekte të ndryshme në këndin e lojërave. Ky mësim mund të përshtatet për të zbuluar edhe aspekte të tjera të diversitetit në komunitetin ku jeton fëmija, si për shembull: <ul style="list-style-type: none"> • diversiteti në tipet e shtëpive • diversiteti në strukturën e familjes • diversiteti në ushqimet e preferuara dhe diversiteti në origjinën e tyre.

12. Gjuha fotografike (klasa e 3-të-6-të)

Fusha e programit mësimor	Tema	Objektivat
Arte pamore	Vizatim	Të shohësh dhe të përgjigjesh

Niveli	Klasa e tretë deri në klasën e gjashtë
Synimi	Të ndihmohen fëmijët të shohin dhe diskutojnë sesi imazhet pamore mund të ndikojnë në mënyrën si ata i shohin njerëzit dhe botën
Qasja dhe metodika	Të shikosh, të përgjigjesh, të diskutosh
Metodika	<p>1.Fëmijët zgjedhin foto nga revistat të njerëzve që janë interesante/mbresëlënëse/të ndryshëm. Shmangni përdorimin e njerëzve të njohur dhe i nxisni të zgjedhin midis një larmie grupmoshash, aktiviteteve, grupesh etnike, situatash, etj. Merrni aq foto sa janë edhe pjesëmarrës dhe nga një laps/stilolaps për çdo pjesëmarrës</p> <p>2. Kërkojuni fëmijëve të ulen në një rreth prej jo më shumë se 10 personash. I thoni fëmijës të zgjedhë një foto dhe të flasë për të.</p> <p>3.Kërkojuni fëmijëve t’i përshkruajnë me hollësi.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Çfarë ka të veçantë kjo foto? • A njihni ndonjë njeri të ngjashëm?

13. Këngë ndërkombëtare - Frère Jacques (ciklit të ultë)

Lënda mësimore	Tema/ora	Objektivat
Muzikë	Interpretim	Këndimi

Niveli	Të gjitha klasat, nga e para tek e gjashta
Synimi	<p>T’u jepet mundësia fëmijëve për të kënduar këngë që janë në një gjuhë tjetër nga ajo e mjedisit mësimor, si edhe këngë me përkthim</p> <p><i>Frère Jacques</i> është në gjuhën franceze dhe angleze dhe këndohet, gjithashtu, në një sërë gjuhësh afrikane dhe gjuhësh të tjera në mbarë botën. Kjo është e dobishme për shfaqjen e një game konceptesh të ndryshme muzikore. Nga një këndvështrim ndërkulturor, këndë si kjo mund t’i ndihmojnë fëmijët të arrijnë të kuptojnë normalitetin e diversitetit</p>
Metodika	1.Mësimdhënësi përgatit një tabelë me fjalët e këngës “ <i>Frère Jacques</i> ”. Duke e filluar me variantet në gjuhën angleze dhe franceze (variantet të cilat ata ka të ngjarë t’i njohin më shumë), mësimdhënësi/ja këndon <i>Frère Jacques</i> për fëmijët. Ata diskutojnë këngën. Mësimdhënësi/ja vendos një tabelë me fjalët. Ata diskutojnë kuptimin e çdo fjale në variantin anglisht të cilën nuk e njohin dhe përcaktojnë se varianti

anglisht është përkthim nga frëngjishtja. Fëmijët më të mëdhenj duhet të jenë në gjendje se cilat fjalë të përkthimit përkojnë me origjinalin.

2.Mësimdhënësi e këndon këngën sërish, ndërkohë që fëmijët dëgjojnë për të parë nëse mund të gjejnë ritmin.

3.Fëmijët këndojnë këngën, duke pasur kujdes për qëndrimin, formën e gojës dhe kontrollin e frymëmarrjes. Përgjatë kësaj, mësimdhënësi/ja mban komunikim me nxënësit. Në një fazë të mëtejshme, variante të tjera të këngës, si ato Xhose ose Zulu, mund të mësohen. Edhe pse fjalët janë të panjohura për fëmijët, njohja e muzikës do t'i ndihmojë.

4.Për të gjithë fëmijët, *Frère Jacques* mund të përdoret për raunde këndimi.

<p>French: Frère Jacques, Frère Jacques, Dormez-vous? Dormez-vous? Sonnez les matines, Sonnez les matines Ding Dang Dong, Ding Dang Dong</p>	<p>Xhosa: Utata uJacob, Utata uJacob Usalele, Usalele Mamela intsimbi iyakhala, Mamela intsimbi iyakhala Dieng dong del, Dieng dong del</p>	<p>English : Are you sleeping? Are you sleeping? Brother John, Brother John? Morning bells are ringing, Morning bells are ringing Ding Ding Dong, Ding Ding Dong</p>
<p>Zulu: Baba Jacob, Baba Jacob Usalela, Usalela Amasilongo esonto ayakhala Amasilongo esonto ayakhala Ding dong del, Ding dong del</p>	<p>Shqip: A po fle? A po fle? Vëlla Xhon, vëlla Xhon? Morning bells are ringing, Morning bells are ringing Ding Ding Dong, Ding Ding Dong</p>	<p>x</p>

14. Tregim / përrallë

Fusha e programit mësimor	Tema	Objektivat
Koha në rreth	Unë dhe bota e gjerë	Në këndvështrime të shumëfishta
Gjuha	Zhvillimi i aftësive kognitive nëpërmjet gjuhës	Gjuha e folur: Zhvillimi i aftësive kognitive nëpërmjet gjuhës së folur

Niveli	Klasa e tretë deri në klasën e gjashtë
Synime	T'iu japë mundësi fëmijëve të diskutojnë një tregim dhe të parashikojnë ngjarje dhe përfundime alternative nga këndvështrimi i personazheve të ndryshme
Qasjet dhe metodikat	<p>T'iu përgjigjesh personazheve të ndryshme të historisë, duke shprehur kundërshtitë e opinioneve, duke argumentuar në mbrojtje të një çështjeje apo pozicioni.</p> <p>Kuptimi, njohja dhe trajtimi i këndvështrimeve dhe anshmërive janë idetë kyçe të edukimit ndërkulturor. Kjo i ndihmon fëmijët të njohin dhe tejkalojnë stereotipimin dhe janë aftësi të rëndësishme për t'u angazhuar në detyra për zgjidhjen e konflikteve, si negocimi i zgjidhjeve dhe krijimi i situatave nga të cilat fitojnë të gjithë. Më në përgjithësi, ato janë pjesë e rëndësishme për zhvillimin e aftësisë së të mendimit kritik.</p>
Metodika	<ol style="list-style-type: none"> 1. Trego historinë e ... 2. Nxiti reagime nga fëmijët, duke zhvilluar aftësitë e kujtesës dhe të menduarit. 3. I lini të tregojnë historinë nga këndvështrimi i një personi tjetër. <ul style="list-style-type: none"> • Fëmijët në të gjitha klasat mund të fillojnë të gjejnë variante të ndryshme të historisë. • Fëmijëve më të rritur mund t'iu kërkohet të gjejnë gjëra për të cilat të dyja palët mund të bien dakord se kanë ndodhur dhe disa gjëra që njëra prej palëve pretendon se nuk kanë ndodhur. Për shembull, xhuxhi mund ta refuzojë se ka kërcënuar dhitë.

Veprimtari edukative për adoleshentë dhe të rritur

“Bëj një hap përpara”

Ky është një aktivitet i përshtatur në kontekstin e Kosovës nga COMPASS – Manuali i Edukimit për të Drejtat e Njeriut për të rinjtë, botuar nga Këshilli i Evropës.

Objektivat:

- Nxitja e empatisë me të tjerët, që janë të ndryshëm dhe përballen me paragjykimin e diskriminimit;
- Rritja e ndërgjegjësimit rreth diskriminimit dhe pabarazisë së mundësive në shoqërië;
- Një kuptim më i madh i pasojave të mundshme personale kur u përket disa pakicave apo grupeve kulturore.

Procedura:

- Aktivitet interaktiv (60 min)

1. Pjesëmarrësit ndahen në grupe me nga 12 persona. Secili grup do ta bëjë aktivitetin ndaras me një trajner.

Çdo pjesëmarrës tërheq një kartë me role në mënyrë rastësore. Pjesëmarrëse u kërkohet që të mos ia tregojnë askujt rolin . Në mënyrë që ta kuptojnë sa më mirë rolin që u ka qëlluar në letrën që e kanë tërhequr, trajneri/fasilituesi lexon pyetjet vijuese duke u dhënë kohë të mjaftueshme pjesëmarrësve që të reflektojnë për rolin:

- Si ka qenë fëmijëria juaj? Në ç’shtëpi jetonit? Çfarë lojërash luanit? Çfarë pune bënin prindërit tuaj?
- Si është jeta juaj e përditshme sot? Ku rrini me shoqëri? Çfarë bëni në mëngjes, pasdite dhe mbrëmje?
- Si është mënyra/stili juaj i jetesës? Ku jetoni? Sa para fitoni në çdo muaj? Çfarë bëni në kohën e lirë? Çfarë bëni për pushime?
- Çfarë ju entuziazmon dhe nga se keni frikë?

2. Më pas, pjesëmarrësve u kërkohet të vendosen pranë njëri-tjetrit (sikur të ishin në vijën e nisjes) dhe trajneri/fasilituesi u shpjegon se kur ai do të lexojë deklaratën përkatëse, pjesëmarrësit duhet të bëjnë vetëm një hap përpara nëse përgjigja është “po”. Në të kundërt, ata duhet të rrinë në vend, pa lëvizur.

3. Deklaratat lexohen një nga një me zë të lartë dhe pjesëmarrësve u lihet kohë që të lëvizin. Në fund, pjesëmarrësit ftohen të shohin pozicionin e tyre përfundimtar dhe u jepen disa minuta që të dalin nga roli, para sesa të kthehen dhe të diskutojnë/reflektojnë në seancë plenare.

4. Diskutimi/reflektimi:

Pjesëmarrësit pyeten mbi atë se çfarë ndodhi dhe se si ndihen ata në lidhje me aktivitetin dhe pastaj diskutohet për çështjet e ngritura dhe për atë se çka kanë mësuar nga kjo.

- Si u ndien ata që bënë një hap përpara?
- Për ata që bënë më shpesh përpara, nëç'pikë filluan të vërenin që të tjerët nuk po lëviznin aq shpejt sa ata?
- A u ndie ndonjeri se kishte momente kur të drejtat e tyre themelore njerëzore po injoroheshin?
- A mund ta gjejnë rolin e njëri-tjetrit? (Ata mund t'i zbulojnë rolet e tyre në këtë pjesë të diskutimit)
- Sa e lehtë apo e vështirë ishte të luaje rol tjetër? Si e imagjinoni personin, rolin e të cilit po e luanit?
- A e pasqyron ushtrimi shoqërinë në një farë mënyre? Si?
- Cilat ishin të drejtat e njeriut që u rrezikuan në secilin rol? A mundet ndokush të thotë se nuk iu respektuan të drejtat e tij njerëzore apo që nuk pati qasje në to ?
- Çfarë hapa të parë do të mund të merreshin për adresimin e pabarazive në shoqëri?

Çështjet kryesore që duhen adresuar gjatë diskutimit: Si mund arsimimi të kunërshtoj jobarazitë strukturore? Çka mund të bëhet për të përkrahur fëmijët e disavantazuar?

- Në fund, çdo pjesëmarrës ftohet të formulojë dhe postojë një sugjerim personal për përmirësimet në shkollën e tij/saj.
- Të gjitha deklaratat e postuara do të organizohen sipas temave kryesore (10 min)

5. Konkluzionet dhe përfundimet (20 min)

Çfarë mund të bëjmë në shkollat tona për të luftuar përjashtimin dhe për të kompensuar disavantazhet?

Letrat me role

Jeni një nënë e pamartuar dhe e papunë	Jeni një 10-vjeçar i kthyer nga Suedia
Jeni vajza e drejtorit të një banke në Prishtinë. Studioni në universitet për ekonomi	Jeni djali i një pronari të restorantit italian që sapo është zhvendosur në Kosovë
Jeni një femër juriste në Kosovë.	Jeni vajza e ambasadorit amerikan në Prishtinë
Jeni një vajzë që jetoni me prindërit, të cilët janë muslimanë të përkushtuar	Jeni një vajzë rome 14-vjeçare e kthyer nga Berlina
Jeni një vajzë 17-vjeçare rome, që nuk e ka përfunduar shkollën fillore	Jeni mësimdhënës/e e shkollës fillore dhe grua e divorcuar, nënë e tre fëmijëve
Jeni një femër ashkalike e pamartuar dhe jeni shtatzënë	Jeni drejtues/e i/e një organizate rome
Jeni një mësimdhënës/e i/e papunë	Jeni futbollist nga një familje egjiptiane e Kosovës

Jeni një burrë kosovar në moshë të mesme, që ka punuar në ndërtim dhe jeni pushuar së fundmi nga puna	Jeni një grua e re me aftësi të kufizuara mendore dhe jetoni në një pavijon të veçantë
Jeni një grua e re ashkaliqe me diplomë të shkollës së mesme	Jeni një Rom 27 vjeçar që nuk ka ku te jetojë
Jeni djali i një profesori në Universitetin e Prishtinës	Jeni djali 19-vjeçar i një fermeri kosovar në një fshat të izoluar malor
Jeni një 18-vjeçar me aftësi të kufizuara dhe në karrocë	Jeni mësimdhënës/e serb në Kosovë

Deklaratat

- Ju nuk keni hasur me asnjë vështirësi serioze financiare.
- Keni një shtëpi/strehim të mirë me linjë telefonike dhe televizor.
- Ju duket se gjuha, besimi fetar dhe kultura juaj respektohen në shoqërinë ku jetoni.
- Ju duket se mendimi juaj mbi çështjet sociale e politike qojnë peshë dhe pikëpamjet tuaja dëgjohen gjithashtu.
- Të tjerët konsultohen me juve për çështje të ndryshme.
- Keni mundësinë të vazhdoni të arsimoheni, në rast se doni.
- Ju keni mbrojtje të mjaftueshme sociale dhe mjekësore për nevojat tuaja.
- Ju duket se roli juaj në shoqëri nuk është inferior ndaj të tjerëve.
- Nuk e keni ndier kurrë diskriminimin për shkak të origjinës suaj.
- Mund të shkoni me pushime njëherë në vit.
- Ju keni një jetë interesante dhe ndiheni pozitiv për të ardhmen tuaj.
- Ju mendoni se mund të studioni e të vazhdoni profesionin e zgjedhur.
- Ju nuk keni frikë se ngacmoheni apo sulmoheni në rrugë ose në media.
- Ju mund të votoni në zgjedhjet e përgjithshme dhe vendore.
- Ju ndiheni se ju janë dhënë të njëjtat mundësi si të tjerëve.
- Ju mund të gjeni punë me lehtësi, në rast se doni.
- Ju nuk trembeni për të ardhmen e fëmijëve tuaj.
- Ju mund të blini veshje të reja, të paktën çdo tre muaj.
- Ju mund të bini në dashuri me personin e zgjedhjes suaj.
- Ju ndiheni se kompetenca juaj vlerësohet dhe respektohet në shoqërinë ku jetoni.

“Tre vullnetarë”

Përshkrim i shkurtër

Ekipi drejtues kërkon që tre pjesëmarrës vullnetarë të largohen nga dhoma. Ata nuk marrin asnjë informacion të mëtejshëm. Pjesëmarrësit tjerë marrin materiale, me të cilat krijojnë një simbol, me të cilin ata definojnë si grup. Ekipi drejtues kërkon që të vendosin elemente të tjera që grupi mund t'i ndajë, për shembull, gjeste të veçanta ose fjalë të koduara. Grupi ulet në karrige, të vendosura në rreth dhe fillon të diskutojë për temën e caktuar. Ata përdorin gjuhën e tyre të koduar. Ekipi drejtues i fton tre vullnetarët të kthehen në sallë dhe u kërkon atyre që të integrohen me pjesën tjetër të grupit. Ushtrimi përfundon pas rreth 20 minutash dhe fillon diskutimi.

Shkurtimisht:

Kategoria:	Interaktive
Mosha:	10vjeç +
Madhësia e grupit:	10-20 nxënës
Hapësira:	Sallë pa kufizime të lëvizjes, rrethi hapur me karriga
Kohëzgjatja:	1 ore e gjysëm -2 orë
Materialet	Materiale creative për të krijuar simbole të grypeve, psh. ngjitës, gërshërë, letër, ngjyra
Qështjet kuçe:	Tolenca, fuqia, diskriminimi, përjashtimi, barazia

Synime:

- Përjetoni si ndiheni kur jeni në pozitën e pakicës brenda një shumicë;
- Kuptoni pasojat që mund të ketë trysnia e grupit mbi sjelljen e një personi;
- Mësoni se si sillen pakicat në situata në të cilat veçohen;
- Krijoni empati për problemet e pakicave;
- Provojeni sa argëtuese është të jesh pjesë e një grupi dhe të përdorësh kode që të tjerët nuk i kuptojnë;
- Ndërgjegjësohuni si duhet të raportoheni me pushtetin;
- Kuptoni varësitë e kundërta në raportet midis shumicës dhe pakicës;
- Njih lidhjen midis diskriminimit real dhe atij të simuluar;
- Kupto që pakicat mendojnë se veçimi është shumë më i dhimbshëm sesa mund ta imagjinojë shumica.

"Shtëpia e ëndrrave të mia"

Objektivat

- Nxitja e shkëmbimit të përvojave dhe të komunikimit ndërmjet pjesëmarrësve;
- Identifikimi i nevojave specifike dhe i strategjive të komunikimit që mund të ndihmojnë zgjidhjen e konflikteve;
- Diskutimi situatat e klasës ku aktiviteti mund të aplikohet për vendosje të rregullave bazë;
- Të kuptuarit e konceptit të ndërmjetësimit dhe rolit të ndërmjetësve të shkollës;
- Identifikimi i mundësive për bashkëpunim me ndërmjetësit arsimorë.

Materialet

- Lapsa dhe letra me madhësi të ndryshme;
- Prezantimi për konflikte dhe ndërmjetësim .

Përshkrimi

Pjesa e I-rë. "Shtëpia e ëndrrave të mia" (15 min.)

Në grupe të vogla të përziera nga 4-5 pjesëmarrës, secili pjesëmarrës ftohet që të pikturojë shtëpinë e tyre ideale dhe ta përdorë tërë letrën për pikturim. Pastaj, në secilin grup pjesëmarrësit ia prezantojnë vizatimet e tyre njëri-tjetrit dhe ua shpjegojnë dëshirat dhe ëndrrat e tyre anëtarëve të tjerë të grupit.

Pjesa e II-të: "Ndarja e burimeve" (25 min.)

Secili grup merr një letër të vogël dhe fasilituesi e lutë secilin grup të bashkëpunojë dhe organizojnë shtëpitë e tyre individuale në këtë vend. Kur pjesëmarrësit të kuptojnë mungesën e hapësirës së mjaftueshme, duhet të bëjnë zgjidhje. Pas 15 minutave i prezantojnë rezultatet e tyre të përbashkëta.

Gjatë informimit fasilituesi do të përqendrohet në çështjet më poshtë:

- Nevojat individuale dhe mënyrat për t'i trajtuar konfliktet;
- Strategjitë për zgjidhje konstruktive të konflikteve;
- Metodatat për shfrytëzim më të mirë të këtyre burimeve për të përfituar të gjithë.

Pjesa e III-të: «Ndërmjetësimi» (30 min.)

Në një hap të ardhshëm fasilituesi i bashkon kuturu dy grupe. Prapë ata marrin një letër dhe ftohen që të bashkohen në këtë vend të vogël. Nga secili grup, një anëtar caktohet që të veprojë si ndërmjetës. Ndërmjetësit supozohet që të punojnë së bashku për t'i mbështetur dy grupet në gjetjen e një zgjidhjeje të kënaqshme për të dy grupet.


Pas përfundimit të detyrës grupet i prezantojnë rezultatet e tyre.

Informimi duhet të lidhet me:

- rëndësinë e konsensusit dhe marrëveshjeve të bazuara në respektim të nevojave bazë,
- proceset e negociatave dhe kompromisit,
- nevojën për të ndërmarrë veprim individual, jo të presë vetëm që të tjerët të adaptohen, dhe
- faktin se komunikimi dhe ndërveprimi janë gjithnjë burime të dobishme për gjetjen e zgjidhjeve.

Konfliktet

Ekzistojnë disa lloje të reagimeve ndaj një situatë konfliktuale:



Shmangia:

Injoroj ose refuzoj të pranoj ekzistimin e konfliktit.

Si rezultat, "Unë humbi - ti humb," sepse nuk mund të bëhet asgjë për këtë.

Akomodimi:

Bëj çfarë ti dëshiron për t'i plotësuar nevojat ose dëshirat e tua.

Si rezultat, "Unë humbi - ti fiton," sepse unë u tërhoqa nga ajo që dëshirova ose kisha nevojë.

Gara:

Ose ti ose unë do të fitoj, por jo të dytë. Kjo është një formë e luftimit. Si rezultat, "Unë fitoj - ti humb," sepse vetëm një mund të fitojë.

Kompromisi:

Të dytë heqim dorë pjesërisht nga ajo që dëshirojmë ose kemi nevojë për të zgjidhur problemin. Si rezultat, "Unë fitoj disa - ti fiton disa," sepse të dytë kemi vullnetin që të japim nga pak.

Bashkëpunimi:

Ti dhe unë punojmë së bashku për të gjetur një zgjidhje të pajtueshme për problemin. Si rezultat, "Unë fitoj - ti fiton," sepse kemi vullnetin që të punojmë së bashku.

Bashkëpunimi është metoda më e mirë për zgjidhje të të gjitha problemeve!

Zgjidhjet fitues-fitues zgjasin më gjatë dhe krijojnë mjedis pozitiv.

Diagrami më poshtë ilustron vendosjen e opsioneve të përshkruara më lartë, duke e pasur parasysh mënyrën se si ata i adresojnë nevojat e palës tjetër dhe të nevojave personale (kompromisi qëndron në mes):

Elementet e dukshme dhe të padukshme në një konflikt

Në çdo konflikt, ekzistojnë elemente të dukshme dhe të padukshme. Ato mund të paraqiten si një ajsberg. Vetëm pozitat shpesh shprehen në mënyrë të dukshme, por prapa tyre ekzistojnë interesat dhe nevojat.

Element kyç i procesit të menaxhimit të konfliktit lidhet me shpërfaqjen e elementeve të padukshme.

Hartimi i konfliktit

Çdo konflikt mund të analizohet duke i përshkruar pozitat e palëve të përfshira dhe duke i hapur frikat, interesat dhe nevojat në secilën anë.



“Tri raste dhe tri qëndrime ...”

Përshkrim i shkurtër

Të gjithë pjesëmarrësit grumbullohen në qendër të sallës. Në tri muret e sallës varen postera në të cilat paraqiten të formuluar tri qëndrime:

1. Diskriminim strukturor dhe/ose i drejtpërdrejtë
2. Asnjë diskriminim
3. I pavendosur

Ekipi drejtues qëndron në faqen e katërt të murit në sallë dhe lexon me zë të lartë raste diskriminimi. Më pas, pjesëmarrësit do të rrinë në këmbë the faqja e murit ku është qëndrimi me të cilin janë personalisht dakord. Pasi pjesëmarrësit janë pozicionuar, ekipi drejtues do të pyes nga një person për çdo anë për arsyet e vendimit të tyre. Të gjithë kanë vetëm një mundësi për të komentuar, me përjashtim të rastit kur ndryshojnë vendim. Atëherë, ata do të kenë mundësi të thonë përse kanë ndryshuar mendje. Në këtë mënyrë, do të paraqiten tri raste të ndryshme. Pas kësaj, do të fillojë vlerësimi.

Shkurtimisht

Kategoria:	Mendim kritik, analizë
Mosha:	14vjeç +
Madhësia e grupit:	10-20 nxënës
Hapësira:	Sallë pa kufizime të lëvizjes, rreth i hapur me karriga
Kohëzgjatja:	1 ore e gjysëm -2 orë e 25 min.
Materialet	3 postera me qëndrime të ndryshme3 shembuj të diskriminimit
Karakteristika:	mund të jenë arranzhime të ndryshme, nuk përdoret si aktivitet hyrës
Qështjet kuçe:	Barazia, diskriminimi, mundësitë

Synime:

- Të eksplorohehen forma diskriminimi dhe jodiskriminimi
- Të kuptohet sa e vështirë është të zbatohet Barazia për të gjithë Njerëzit përpara Ligjit
- Të ketë ndërgjegjësim për mekanizmat e përjashtimit dhe diskriminimit në sistemin arsimor
- Të diskutohen mundësitë për ndryshim
- Të krahasohen zgjidhjet dhe sugjerimet

Analiza e planeve mësimore

Fletë pune: Model për planet mësimore alternative

Modeli i 1-rë: Mësimi i gjuhës angleze	
Tema: interpretimi i një teksti letrar (një poezi)	
Klasa e 8-të: rreth 25 nxënës; grup i përzier	
Klasa: e gjerë; organizime të punëve në grupe	
Detyrat: analizë e tekstit; diskutim i përmbajtjes; shprehja gojore e mendimeve individuale	
Qasja klasike: Mësimdhënësi pyet: kush dëshiron ta lexojë poezinë? Disa nga nxënësit më të mirë paraqiten, një zgjedhet dhe e lexon tërë tekstin. Pastaj, mësimdhënësi parashtron disa pyetje për t'i mbështetur nxënësit për të kuptuar porosinë dhe përmbajtjen e poezisë dhe tani e nxjerrin konkluzionin kryesor të cilin fëmijët duhet ta mbajnë.	Qasja alternative: Secili rresht në poezi lexohet nga një fëmijë tjetër. Mësimdhënësi është i kujdesshëm ndaj të gjithë fëmijëve dhe po ashtu i fton nxënësit e qetë ose nxënësit me aftësi të kufizuara që ta lexojnë; Mësimdhënësi i përmirëson gabimet gjatë shqiptimit dhe i lutë që ta përsërisin kur është e nevojshme por i lavdëron të gjithë fëmijët. Mësimdhënësi i lutë fëmijët që të punojnë në grupe të vogla dhe të ilustron me vizatim rreshtat në poezinë që e pëlqejnë më së shumti. Një anëtarë i secilit grup e përshkruan shkurtimisht vizatimin. Informimi bëhet edhe për mënyrën se si fëmijët të punojnë së bashku në grupe. Vizatimet mund të prezantohen në klasë. Në këtë mënyrë, teksti lidhet me jetën dhe preferencat e fëmijëve dhe gjuhën të cilën po e mësojnë bëhet ndërmjetës për reflektim, individualizim dhe ndarje të pikëpamjeve.

Modeli i 2-të: Mësimi i kimisë	
Tema: Të kuptuarit e formulave dhe proceseve kimike	
Klasa e 9-të: rreth 20 nxënës; grup i përzier,	
Klasa: e gjerë; rreshta	
Qasja klasike: Metodat e mësimdhënies kufizohen në ligjërime nga mësimdhënësi, detyrat për të lexuar nga libri i mësimi dhe pyetjet nga mësimdhënësi për nxënësit	Qasja alternative: Nxënësit angazhohen në procesin e mësimnxënies së vetë-organizuar; shkruajnë formula në tabelë dhe ftojnë shokët/shoqet e klasës që t'u përgjigjen pyetjeve, e kështu me radhë. Gjatë klasës të gjithë nxënësit angazhohen ose në parashtrimin e pyetjeve ose u përgjigjen pyetjeve nga bashkëmoshatarët, dhe shumë shkruajnë në tabelë. Disa nga pyetjet janë të lehta për t'u përgjigjur dhe kështu të gjithë

	fëmijët arrijnë sukses.
Rezultatet: ndërveprimi bëhet vetëm ndërmjet nxënësve individual dhe mësimdhënësve /librit të mësimi. Disa nxënës mësojnë më mirë se të tjerët dhe ata duhet të lavdërohen nga mësimdhënësi. Të tjerët mund të dekurajohen dhe të ndërprejnë së mësuari.	Strategjitë për gjithëpërfshirje shoqërore: shkalla e lartë e pjesëmarrjes; mësimdhënësi është mbështetës dhe stimulues i procesit pa qenë në qendër; mësimdhënësi i lavdëron për përgjigjet. Libri i mësimi është burim në procesin e mësimnxënies por jo qendra e tij. Pjesëmarrja aktive si ndërmjetës për angazhim, bashkëpunimi ndërmjet bashkëmoshatarëve, dhe ndarja e njohurive. Procesi i mësimnxënies me balancim gjinor.

Modeli i 3-të: Mësimi i gjuhës shqipe	
Tema: Poezia 'Himni i Flamurit' nga F. S. Noli	
Klasa e 9-të: rreth 20 nxënës; grup i përzier	
Klasa: e ngushtë dhe e vogël, 3 fëmijë në një bankë normalisht për 2	
Qasja klasike: Detyrat: leximi i poezisë Vijo pyetjet në librin e mësimi.	Qasja alternative: Poezia ofron shumë mundësi për lidhje ndër-kurrikulore, për të reflektuar në diversitetin kulturor dhe promovimin e mirëkuptimit ndërkulturor. Disa shembuj janë tani më poshtë. Biografia e autorit është një shembull i mirë i ndërveprimeve ndërkulturore: ai është shqiptar, ishte prift krishterë ortodoks, jetoi në Bullgari dhe në SHBA, u bë poet, shkrimtar, aktivist dhe më vonë politikan udhëheqës në Shqipëri dhe kontribuoi në ndërtimin e institucional të saj si shtet. Një lidhje mund të bëhet me kosovarët e ditës së sotme të cilët jetojnë në vende të tjera por që akoma janë të lidhur emocionalisht me Kosovën dhe disa mund të zgjedhin të kthehen dhe jetojnë këtu. Poezia dhe puna e poetit në përgjithësi duhet të vendoset në kontekstin shoqëror dhe politik të kohës kur shkruhet. Një diskutim për periudhën e shtetndërtimit dhe romantizmit letrar të shekullit 19 deri në fillim të shekullit 20, që shpiu në krijimin e shtetndërtimeve, duke e zëvendësuar një sistem të bazuar në perandori, do t'iu ndihmojë nxënësve që të kuptojnë disa nga porositë e poezisë. Mund të bëhet një krahasim me poezitë e njëjta nga vendet e tjera por nga periudha e njëjtë (për shembull, himni i Francës 'Marseillaise'). Referencat jepen në disa civilizime në të kaluarën të cilat kanë

	<p>ndikuar në Evropën Jug-Lindore në periudha të ndryshme historike. Po ashtu, referencat jepen në fe të ndryshme dhe tolerancë fetare.</p> <p>Këto mund të përdoren për të bërë lidhje me temat që studiohen në histori dhe gjeografi por edhe me realitetin e tanishëm dhe me gjurmët e së kaluarës dhe elementet e dukshme të diversitetit fetar në të tashmen.</p>
<p>Rezultatet: Memorizimi mekanik, pa e kuptuar në të vërtetë përmbajtjen Ekspozimi ndaj pritjeve që kanë të bëjnë me të menduarit dhe qëndrimet (duhet ta mendosh këtë / duhet ta kesh këtë ose atë qëndrim, etj.)</p>	<p>Rezultatet: Zhvillimi i disa elementeve të njohurive të parapara në Kornizën Kurrikulore, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të menduarit kritik dhe aftësia për të krahasuar dhe kuptuar burimet e informatave; - Të kuptuarit dhe respektimi i diversitetit mes njerëzve; - Vlerësimi i diversitetit dhe demonstrimi i tolerancës, respektit dhe qëndrimet gjithëpërfshirëse; - Të kuptuarit të vetvetes dhe të tjerët; - Respektimi i trashëgimisë kulturore kombëtare

Fletë pune: Rastet studimore që përmirësojnë planet mësimore

Shembulli i 1-rë: Mësimi i gjuhës shqipe
Tema: Përshkrimi i personave
Klasa e 7-të: grup i përzier i rreth 30 fëmijëve (shqiptarë dhe ashkalinjë)
Klasa: e vogël; 5 rreshta me nga 3 banka secili; dy deri në tre fëmijë e ndajnë një bankë, hapësirë e vogël në mes të bankave. Në rreshtat e fundit vetëm një fëmijë
Detyra: mësimdhënësi i lutë nxënësit që të përshkruajnë në një tekst të shkurtë me shkrim një shok/shoqe të klasës dhe lexojnë tekstin pa e treguar emrin. Të tjerët duhet t'ia qëllojnë se për kënd bëhet fjalë.
<p>Strategjitë për gjithëpërfshirje shoqërore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mësimdhënësi është i kujdesshëm ndaj të gjithë fëmijëve dhe po ashtu i fton nxënësit që janë ulur mbrapa që ta lexojnë; - Mësimdhënësi kujdeset për shpërndarje të barabartë të radhëve ndërmjet fëmijëve shqiptarë dhe ashkalinjë. - Mësimdhënësi e shfrytëzon aktivitetin për të stimuluar ndërveprimin dhe shkëmbimin shoqëror ndërmjet fëmijëve me përkatësi të ndryshme etnike. - Sfida: - Fëmijët ashkalinj zgjedhin që t'i përshkruajnë fëmijët ashkalinjë dhe shqiptarë (duke shprehë dëshirë që të pranohen, që të jenë të barabartë), gjersa fëmijët shqiptarë i përshkruajnë vetëm kolegët e tyre shqiptarë (racizëm i keq i pavetëdijshëm).
Qasja alternative ose propozimet për t'i përmirësuar dhe tejkaluar sfidat:

Shembulli i 2-të: Mësimi në anglisht

Lënda: Letër shokut/shoqes letërkëmbëse

Klasa e 8-të: rreth 20 fëmijë, grup i përzier, me disa fëmijë ashkalinjë (rreth çereku i klasës)

Klasa: meqenëse bankat janë të organizuara për mësimdhënie përballë, ka hapësirë të mjaftueshme për organizimet e punës në grup (2 fëmijë kthehen prapa bashkë me fëmijët prapa tyre formojnë një grup prej 4 fëmijësh). Fëmijët duket se janë të familjarizuar me metodat bashkëpunuese të paktën në mësimin e anglishtes. Por, kur hyn në klasë mësimdhënësi, vajzat nga komuniteti ashkali ulen bashkë dhe një djalë nga ky komunitet ulet i vetëm prapa.

Detyra: në grupe të vogla, shkrimi i një letre një shoku/shoqe imagjinare letërkëmbëse, duke e përdorur një program mësimor me një letër model. Një nxënës nga secili grup e lexon letrën e shkruar.

Strategjitë për gjithëpërfshirje shoqërore:

- Mësimdhënësi është i kujdesshëm ndaj të gjithë fëmijëve dhe po ashtu e fton nxënësin që është ulur mbrapa që t'i bashkohet një grupi të përzier;
- Mësimdhënësi i lavdëron për rezultatet e punës në grup. Puna në grup përdoret si mjet për ndërveprim dhe shkëmbim shoqëror.
- Ndarja në grupe bëhet në atë mënyrë që të sigurojë të paktën një nxënës me njohuri shumë të mira të gjuhës angleze në secilin grup dhe udhëzimet e mësimdhënësit/et e nxisin të mësuarit me bashkëmoshatarë
- Mësimdhënësi i përdor elementet e tekstit model për t'i paraqitur elementet që kanë të bëjnë me diversitetin kulturor, vendet e tjera, gjetjen e dallimeve por edhe të ngjashmërive me përkatësinë e nxënësve të tij.

Sfida:

Për shkak se ekziston një dallim i lartë në njohuritë ndërmjet djalit nga komuniteti ashkali i cili zakonisht është i izoluar në fund të klasës dhe kolegëve të tjerë në grupin e tij, ai në të vërtetë nuk përfshihet në shkrimin e letrës, ai është si spektator në punën e grupit, pavarësisht nga qëndrimi pozitiv i bashkëmoshatarëve të tij.

Qasja alternative ose propozimet për t'i përmirësuar dhe tejkaluar sfidat:

Shembulli i 3-të: Mësimi i matematikës
Lënda: Gjeometri; trekëndëshat dhe këndet
Klasa e 8-të: rreth 25 nxënës; grup i përzier,
Klasa: e ngushtë; fëmijët ulen në rreshta, nxënësit ashkalinjë ulen në rreshtat e fundit
Metodat e mësimdhënies: rikrijimi i kapitullit të librit të mësimi; pyetjet dhe përgjigjet;
Sfidat: ekziston një diskutim për llojet e trekëndëshave në bazë të librit të mësimi por pa ilustrime me vizatime në tabelë. Mësimdhënësi fokusohet në nxënësit në rreshtat e parë; nuk është i kujdesshëm ndaj të gjithë fëmijëve dhe nuk i kontrollon nëse nxënësit kanë lapsa, etj. Disa fëmijë duken të jenë të humbur dhe nuk marrin mbështetje. Një vajzë nga komuniteti egjiptian që ulet në rreshtat e mesëm me kolegët shqiptarë por kurrë nuk shprehë dëshirën që t'iu përgjigjet pyetjeve të mësimdhënësit/et dhe kurrë nuk lutet që të japë përgjigje. Një djalë nga komuniteti ashkali i ulur mbrapa në klasë, i vetëm, pa lapsa dhe tërësisht i shkëputur nga procesi. Kah mesi i mësimi mësimdhënësi e kupton atë, e lutë një kolegë që t'ia huazojë atij një laps dhe e lutë atë që t'i përshkruajë në fletoren e tij vizatimet e mësimi nga libri i mësimi. Djali fillon përshkrimin por nuk i pason fëmijët e tjerë se çfarë po bëjnë.
Qasja alternative ose propozimet për t'i përmirësuar dhe tejkaluar sfidat:

Shembulli i 4-të: Mësimi i historisë
Lënda: Kongresi i Vjenës
Klasa e 8-të: rreth 25 nxënës; grup i përzier,
Klasa: e ngushtë; nxënësit ulen në rreshta,
Detyrat: përsëritja e fakteve historike; rikrijimi i kapitullit të librit të mësimi; pyetjet dhe përgjigjet
Strategjitë për gjithëpërfshirje shoqërore: Qëndrimi miqësor i mësimdhënësit/et , mësimdhënësi është i kujdesshëm ndaj të gjithë fëmijëve dhe u kushton vëmendje fëmijëve nga komunitetet pakicë. Mbështetje pozitive dhe lëvdata për arritjet.
Sfidat: Mësimnxënia me mësimdhënësin në qendër, fokusi në njohuritë. Asnjë ndërveprim nuk organizohet ndërmjet nxënësve gjatë mësimi. Mësimnxënia bazohet në përsëritjen e fakteve.
Qasja alternative ose propozimet për t'i përmirësuar dhe tejkaluar sfidat:

Aktivite vlerësuese

Barometri

Procedura

Kërkoni nga pjesëmarrësit që të qëndrojnë në një rreth.

Secili pjesëmarrës lutet që të bëjë një deklaram të shkurtë duke filluar me

“Çfarë dua që ju ta dini, ose: çfarë dua të tregoj...”

Ata të cilët pajtohen me deklaramin (në kuptimin që kjo aplikohet edhe për ta), do të ecin një hap përpara, drejt qendrës së rrethit. Ata të cilët cilët fuqishëm pajtohen do të ecin dy hapa. Pas secilit deklaram, të gjithë pjesëmarrësit kthehen në rrethin fillestar

Fasilituesi mund t'i përdorë deklaramet si barometër për motivim, pengesa, etj.

Informimi i shkurtë në plënar:

- Kërkoni nga pjesëmarrësit se si u ndjenë, nëse ishte e vështirë që të përcaktoheshin për deklaramin, nëse u mahnitën me deklaramet e bashkëmoshatarëve të tyre, etj;
- Lejo hapësirë për shpjegime, duke parashtruar pyetje dhe duke u përgjigjur;
- Falemindero pjesëmarrësit për atë që kanë ndarë, tregoj se po i dëgjon dhe informo se do të merret parasysh kontributi juaj;

Letër vetvetes

Objektivat

- Fuqizimi i përmbajtjes së punëtorisë
- Dalja me ide të reja për aktivitetet e ardhshme
- Inkurajimi i reflektimi javë pas punëtorisë
- Thëllimi i zotimit për ndryshimet e planifikuara

Materialet

- Letra
- Zarfet

Procedura

Fasilituesi i lutë pjesëmarrësit që ta shkruajnë adresën e shtëpisë së tyre në një zarf. Pastaj, fasilituesi e lutë secilin që të shkruajë një letër një shoku/shoqe për përvojat, njohuritë tuaja dhe rezultatet e punëtorisë. Pasi t'i kenë përfunduar letrat e tyre, pjesëmarrësit e vendosin letrën në zarf me adresën e tyre dhe e mbyllin atë. Fasilituesi i dërgon me postë letrat tri deri në pesë javë pas punëtorisë. Letrat janë menduar që të shërbejnë si përkujtues të zotimeve, planeve dhe reflektimeve të tyre.

Këshilla metodologjike

Është mirë, e madje më inkurajuese, kur pjesëmarrësit e tjerë e shfrytëzojnë rastin që të shtojnë përshëndetje personale dhe të japin komente të vonuara. Në atë rast zarfet duhet të mbesin të hapura në një kuti në mes të sallës për shtim të befasive të tilla. Në një kohë të paradakorduar, zarfet duhet të jenë të mbyllura.

Pjesëmarrësit po ashtu mund të ndahen në çifte për t'i diskutuar zotimet që i kanë bërë. Fasilituesi duhet t'i nxisë ata që të flasin për vështirësitë me të cilat presin të ballafaqohen në implementimin e ideve të tyre dhe të konsultohen me njëri-tjetrin se si t'i tejkalojnë ato. Mund të sugjerohet se çiftet pajtohen që ta telefonojnë ose shkruajnë email njëri-tjetrit në ditën që i marrin letrat e tyre. Nëse dëshirojnë, ata mund ta shfrytëzojnë mundësinë që të raportojnë për progresin në realizimin e ideve të tyre. Natyrisht kjo nuk duhet të jetë e obligueshme.

Mirë se vini në Utopi

Objektivat

- Imagjinimi i skenarëve të ardhshëm të cilat ofrojnë zgjidhje të reja për problemet që kanë bëjnë me diskriminimin dhe të cilat krijojnë strategji të pamenduara drejt gjithëpërfshirjes
- Inspirimi i zgjidhjeve kreative të ditës së sotme
- Diskutimi nëse gjithëpërfshirja shoqërore është qëllim i përbashkët për të gjithë pjesëmarrësit
- Eliminimi, në një mënyrë shakatare, i kufizimeve të brendshme të mendimit që nga parandalon që të gjejnë zgjidhje

Procedura

Pjesëmarrësit ndahen në grupe nga katër deri në pesë persona. Fasilituesi e lutë secilin grup që të dizajnojë një Utopi për mënyrën problemi i grupeve të ndryshme shoqërore u trajtua në një të ardhme të largët. Secili grup përgatitë një prezantim për t'ia demonstruar dikujt që nuk është i njohur me Utopinë e tyre se si anëtarët e saj me sukses ndërveprojnë sa i takon pabarazisë.

Pasi grupet e vogla t'i kenë përgatitur prezantimet e tyre, i tërë grupi mblidhet në një rreth për t'i parë skenarët e ndryshme.

Diskutimi përfundimtar duhet të përqendrohet në atë se sa larg kanë shkuar Utopitë e propozuara drejt gjetjes së zgjidhjeve për problemet e tanishme që përfshijnë diskriminimin, pabarazinë dhe fuqinë.

Pyetjet më poshtë mund të jenë të dobishme:

- Brenda grupit të vogël, a ishte e lehtë të dilet me një vizion të përbashkët për një Utopi?
- A ishte e qartë se çfarë barazie mund të nënkuptohej në këtë situatë utopiane?
- Cilat mënyra të reja të shikimit në lidhjet ndërmjet gjuhës, fuqisë dhe pabarazisë u shpalosën?
- A do të krijonin Utopitë pabarazi të reja sikur të realizoheshin?
- A dëshirojmë me të vërtetë të arrijmë barazi në fund?

Në fund të diskutimit, fasilituesi i lutë pjesëmarrësit që t'i shkruajnë zgjidhjet e mundshme për problemet sa i përket shumëllojshmërisë së gjuhës në situatat e përditshme të tyre ose për problemet që mund të paraqiten gjatë punëtorisë. Kështu që secili pjesëmarrës krijon një plan veprimi të synuar personal. Përfundimisht, secili pjesëmarrës e ndanë një pikë të rëndësishme nga plani i tij me tërë grupin.

Këshilla metodologjike

Meqenëse ky ushtrim mund të mbetet në një nivel jopraktik që nuk është i realizueshëm në një afat të shkurtë, pasi aktivitetet në këtë udhëzim tentojnë të bëjnë lidhje specifike ndërmjet këtyre botëve të ëndërruara dhe realitetit të përditshëm. Temat dhe çështjet që ngrihen këtu mund të shfrytëzohen për të planifikuar objektiva dhe veprime konkrete në disa nga këto aktivitetet më poshtë

Ndryshimet në klasën time

Objektivat

- Përkufizimi i objektivave që pjesëmarrësit do të dëshironin t'i arrinin në klasën e tyre
- Zhvillimi i strategjive për t'i arritur këto objektiva

Materialet

- Rastet studimore (për fëmijë)
- Letra të mëdha (gjysma e tabelës lëvizëse)
- Copa të letrave me ngjyra të ndryshme
- Një ngjitës letre për grup

Procedura

Gjatë prezantimit të sesionit, fasilituesi potencon se pjesëmarrësit do të fokusohen në raste reale dhe reflektojnë për ndryshimet që do të dëshironin t'i prezantonin në klasat e tyre. Ata duhet edhe t'i përdorin rastet për të vendosur për masat për t'i realizuar këto ndryshme.

Nëse në grupe të vogla, fasilituesi i përkufizon detyrat e tyre. Ata duhet të vendosin se çfarë do të dëshironin të ndryshonin në situatën e përshkruar në rastet. Për ta realizuar atë ndryshim, ata duhet t'i përkufizojnë jo më shumë se tri objektiva për t'u arritur brenda një viti. Objektivat duhet të jenë specifike të reale.

Fasilituesi duhet t'i lusë që ta zhvillojnë një ose dy strategji për gjithëpërfshirje shoqërore. Secili grup i vogël duhet t'i shkruajë objektivat në letrën e posterit, një objektiv për poster. Rreth pesëmbëdhjetë minuta mund të ndahen për këtë pjesë.

Duke shkuar në shtëpi

Objektivat

- Përgatitja e pjesëmarrësve për kthimin e tyre në klasat e tyre, duke siguruar se ajo për çfarë është mësuar gjatë kësaj punëtorie do të merret me vete.
- Emërimi dhe prioritetizimi i veprimeve specifike për zbatime gjatë gjashtë muajve në vijim deri në një vit

Materialet

- 60 copa letre të gjelbërt;
- 60 afishe të kuqe;
- 60 afishe të verdha.

Procedura

Prezantimi i seseancës, fasilituesi potencon se kz trajnim e ka adresuar fenomenin e pabarazisë dhe përjashtimit. Ne kemi diskutuar shumë ide dhe i kemi mësuar disa metoda për ta korrigjuar këtë pabarazi në klasat tona. Për t'u siguruar se çfarë kemi mësuar këtu të përkthehet në praktikë, secili pjesëmarrës do të përcaktohet se çfarë do të bëjë në klasë, në gjysmën e vitit të ardhshëm për t'i zbatuar strategjitë gjithëpërfshirëse shoqërore.

Secili pjesëmarrës i merr dy ose tri copa të letre të gjelbr për t'i shkruar idetë që ka për qëllim t'i zbatojë. Idetë mund të jenë ato të cilat paraqiten në çdo kohë gjatë punëtorisë. Ose mund të jenë të reja. Çfarë është më e rëndësishme është që ato janë shumë konkrete dhe diçka që ne kemi për qëllim të bëjmë në punën tonë. (Për shembull: Të gjitha materialet për prindërit do të shtypen në gjuhën rome.)

Secila letër përfaqëson një zotim personal për punën tonë të ardhshme.

Kur të gjithë t'i kenë përfunduar shkrimet, ata luten që t'i lexojnë idetë e tyre një nga një dhe pastaj i vendosin në mur një njërin rresht në nivel të syve. Ide të njëjta duhet të postohen afër njëri-tjetrit.

Kur të gjitha idetë të jenë vendosur, fasilituesi ua shpërndan dy afishe të kuqe dhe dy të verdha secilit pjesëmarrës. Grupi i përdor këto afishe për t'i vlerësuar dhe prioritetizuar idetë në mur. Ata i vendosin afishet e kuqe mbi idetë që janë absolutisht të sigurt se do t'i përdorin. Dhe pastaj i vendosin afishet e verdha mbi idetë që mund të provojnë t'i përdorin. Ata e bëjnë këtë papritmas dhe pa diskutim.

Kur të vendosen të gjitha afishet, fasilituesi i lexon me zë idetë të cilat kanë marrë më shumë afishe të kuqe.

Befasoj, kujtoj, mendoj më shumë

Objektivat

- Lidhja e përvojave të kursit me kontekstin e vet personit;
- Lidhja e përvojave me përkatësinë kulturore të vet personit.

Procedura

Në fund të çdo aktiviteti, pjesëmarrësit luten që të marrin shënime në gjuhën e tyre amtare lidhur me tri aspektet:

- Diçka që më ka befasuar;
- Diçka të vlefshme që ia vlen ta kujtoj;
- Diçka për të cilën dua të mendoj më shumë.

Ata ftohen që të ndajnë një ose dy nga aspektet më të rëndësishme.

Zhvillimi personal

Objektivat

- Vizuelizimi i zhvillimeve personale që kanë ndodhur gjatë rrjedhës së punëtorisë;
- Theksimi i dallimeve ndërmjet fillimit dhe fundit të punëtorisë;
- Ndarja me grupin pikat qendrore të ndryshimit personal.

Materialet

- Një litar i gjatë (pothuajse nga njëri mur në tjetrin nëse brenda);

- Një përzgjedhje e gjerë e imazheve vizuale: kartolinat, fotografitë, ilustrimet, etj. Të paktën dy herë aq sa ka pjesëmarrës.

Procedura

Kështu që aktiviteti mund të prezantohet çdo kohë nga mesi i kursit deri në fund. Fasilituesi fillon duke e lidhur litarin dhe duke shpjeguar se njëri fund paraqet fillimin e punëtorisë kurse fundi tjetër paraqet momentin aktual. Pastaj fasilituesi i lutë pjesëmarrësit që të reflektojnë mbi ndryshimet personale që i kanë bërë gjatë zhvillimit të punëtorisë.

Fasilituesi i vendos kartolinat, fotografitë, ilustrimet dhe imazhet e tjera vizuale në ballë të murit në mes të sallës. Pjesëmarrësit pastaj luten që t'i zgjedhin dy kartolina: Njëra që simbolizon ata në fillim të punëtorisë dhe njëra që paraqet gjendjen e tyre aktuale.

Një nga një, pastaj secili pjesëmarrës ia paraqet dy përzgjedhjet pjesës tjetër të grupit, shpjegon se pse ato dy imazhe u përzgjedhën, dhe pastaj e vendos një të "fillim" të litarit dhe tjetrën në "momentin e tanishëm".

Vlerësimi i tërë punëtorisë

Objektivat

- Vlerësimi i punëtorisë në nivele të ndryshme;
- Integrimi i vlerësimit personal dhe grupor;
- Vizuelizimi i vlerësimit përmes vizatimit.

Materialet

- Shkrimi i letrës për të gjithë;
- Stilolapsa ose lapsa për të gjithë;
- Disa markera me ngjyra për secilin grup të vogël.

Procedura

Fasilituesi u paraqet pjesëmarrësve nivele të ndryshme të vlerësimit që do të jenë të rëndësishme:

- Objektivi i gjithëmbarshtëm i punëtorisë;
- Struktura e punëtorisë;
- Aktivitetet specifike;
- Mënyra në të cilën u zhvilluan ushtrimet.

Pjesëmarrësit luten që së pari të reflektojnë individualisht për secilën nga këto nivele dhe t'iu përgjigjen vetë dy pyetjeve në vijim lidhur me secilin nivel. Ata duhet të marrin shënime ashtu siç bëjnë.

- Çfarë të pëlqeu?
- Çfarë do të bënit ndryshe?

Grupi i madh pastaj ndahet në grupe nga katër deri në gjashtë njerëz për grup dhe i shkëmbejnë vlerësimet e tyre. Ata duhet të fokusohen në tri nivelet e para pasi që këto janë baza e vet dizajnit të punëtorisë.

Aktivitetet shpresë

Pasi ka kohë të mjaftueshme për t'i shkëmbyer gojarisht vlerësimet e tyre në grupe të vogla, fasilituesi e udhëzon secilin grup që të vizatojnë një pikturë të grupit, ndoshta duke i përfshirë dizajnet ose simbolet që përfaqësojnë përgjigjet e individëve në pyetjet a) dhe b).

Përfundimisht, i tërë grupi ia prezanton vizatimet e tyre me shpjegimet njëri-tjetrit.

Pyetjet e vlerësimit

Më poshtë është një koleksion pyetjesh që mund të parashtrohen gjatë vlerësimit të një punëtorie për fuqinë e gjuhës. Të gjitha pyetjet mund të përdoren në një pyetësor tradicional për t'iu përgjigjur me shkrim. Disa po ashtu ngelin për t'u përdorur në metodat alternative të vlerësimit të paraqitura më lartë.

- Sa praktike për punën tuaj të përditshme ishin strategjitë që i keni mësuar?
- Sa mirë mendoni se ne, si fasilitues, e kemi kontekstualizuar punëtorinë për ju?
- Sa i përket përshkrimit të kursit, a ndjeni se punëtorja i ka rritur, përmbushur ose tejkaluar pritjet tuaja?
- A ishte adekuat dizajni i gjithëmbarshtëm?
- A ishte dizajni gjithëpërfshirës apo i paqartë? A duhet të ketë qenë njëra apo tjetra?
- A ishte qëllimi afatgjatë që të nxitet gjithëpërfshirja shoqërore transparente dhe e qartë nga fillimi?
- Cilin ushtrim do ta përdorni? Si do t'i përdorni ato?
- Çfarë adaptimesh do të bëni në aktivitetet që i përdorni?

Diskutimi në plenar: Cilat pyetje janë më të rëndësishme që akoma i posedoni?